



Koha

www.koha.mk



Drejtori i
suksesshëm i
Skënderbeut

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3147 • E hënë 14 gusht 2017 15 DEN



Nga Bllata në Bllacë përmes Mavrovës

Shkup, 13 gusht - Rruga e Arbrit, që do të lidh Tiranën me Dibrën, për të vazhduar më tej në Gostivar, Tetovë dhe deri në vendkalimin Bllacë me Kosovën, pritet të përfundojë në fund të vitit 2021. Në Maqedoni pritet që vazhdimi i Rrugës së Arbrit të lidhë Dibrën me Shkupin përmes

Mavrovës dhe jo përmes variantit të mëparshëm, përmes Kërçovës. Këtë e tregojnë edhe planet qeveritare, ku ndërtimi i aksit rrugor nga Ura e Boshkut deri në Izvor të Kërçovës theksohet se paraqet opsion të mundshëm vetëm në rast se gjenden mjete financiare, ndërsa plani-

fikohen mjete për riparimin e aksit rrugor Mavrovë-Dibër. Për ndërtimin e saj kanë lobuar dibranët nga të dyja anët e kufirit shtetëror midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, për shkak se këtë projekt e shohin si jetik për gjallërimin ekonomik të të dy Dibrave. Kryetari i Dibrës...

FAQE 2

Përpunohet emrat për kryetarë të komunave

Figura të forta për zgjedhje lokale



Bujar Osmani, Agim Nuhiu, Nevzat Bejta, Ramiz Merko, Fatmir Dehari, Ruzhdi Lata... janë disa nga emrat që do të prijnë garës për komunat shqiptare nga BDI. Nga ASH, kryetari i LR-PDSH-së, Ziadin Sela dhe sekretari i përgjithshëm, Arbën Taravari, kandidat të mundshëm për në Strugë dhe Gostivar, ndërsa Remzi Memedi në Kërçovë. Shaban Zendeli, Arben Llabunishti dhe Kastriot Rexhepi pritet të kandidojnë në Çair, Strugë dhe Likovë

FAQE 3

Slovenët paguhen tre herë më shumë se maqedonasit



Shkup, 13 gusht - Nga gjashtë vendet e ish-Jugosllavisë, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova jo vetëm që kanë paga më të ulëta në rajon, por njëherësh përbëjnë dhe numrin më të madh të papunëve. Këto janë të dhënat më të fundit të dala nga Agjencia e Statistikave të Komuniteteve Evropiane (EUROSTAT),

sipas të cilës, rroga më e lartë mesatare e paguar në muajin maj në vendet e rajonit, sipas të dhënave zyrtare, është paguar në Sloveni në vlerë të përgjithshme prej 1050 euro, ndërsa rrogë më të ulët mesatare nga vendet e rajonit gjatë muajit maj kanë marrë të punësuarit në Maqedoni në vlerë prej 372 euro ose

22.889 denarë. Njëkohësisht, rroga mestarë në muajin maj në Kroaci ka shënuar vlerën 813 euro, në Mal të Zi 510 euro, në Bosnje 439 euro. Në Serbi, rroga mesatare e paguar në muajin maj ka shënuar vlerën prej 409, ndërsa në Kosovë - rroga mesatare për punonjësit në institucionet publike...

FAQE 4

AKTUALE
Në vend të MASH-it, shkollën e sanojnë mërgimtarët!



Aktivitetet humanitare të mërgimtarëve dibranë nga SHBA-të nuk kanë të ndalur. Grupi tanimë i njohur humanitar nga SHBA-ja, i cili ka edhe përfaqësuesit të tyre në vendlindje, pas sigurimit të tre shtëpive...

FAQE 6

RAJON

Edhe një tentim i Kuvendit

FAQE 16

GLOBI

Merkel nis garën e radhës

FAQE 17

DOSSIER

Petro Janura për zgjidhjen e problemit të gjuhës shqipe...



FAQE 8-9



Rruga e Arbrit përfundon planifikohet të përfundojë në vitin 2021

Nga Bllata në Bllacë përmes Mavrovës

Në Maqedoni pritet që vazhdimi i Rrugës së Arbrit të lidhë Dibrën me Shkupin përmes Mavrovës dhe jo përmes variantit të mëparshëm, përmes Kërçovës. Këtë e tregojnë edhe planet qeveritare, ku ndërtimi i aksit rrugor nga Ura e Boshkut deri në Izvor të Kërçovës theksohet se paraqet opsion të mundshëm vetëm në rast se gjenden mjete financiare, ndërsa planifikohen mjete për riparimin e aksit rrugor Mavrovë-Dibër

Koha | Fisnik PASHOLLI



Shkup, 13 gusht - Rruga e Arbrit, që do të lidhë Tiranën me Dibrën, për të vazhduar më tej në Gostivar, Tetovë dhe deri në vendkalimin Bllacë me Kosovën, pritet të përfundojë në fund të vitit 2021. Në Maqedoni pritet që vazhdimi i Rrugës së Arbrit të lidhë Dibrën me Shkupin përmes Mavrovës dhe jo përmes variantit të mëparshëm, përmes Kërçovës. Këtë e tregojnë edhe planet qeveritare, ku ndërtimi i aksit rrugor nga Ura e Boshkut deri në Izvor të Kërçovës theksohet se paraqet opsion të mundshëm vetëm në rast se gjenden mjete financiare, ndërsa planifikohen mjete për riparimin e aksit rrugor Mavrovë-Dibër.

Për ndërtimin e saj kanë lobuar dibranët nga të dyja anët e kufirit shtetëror midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, për shkak se këtë projekt e shohin si jetik për gjallërimin ekonomik të të dy Dibrave. Kryetari i Dibrës, Ruzhdi Lata, thotë se në Maqedoni pritet që Rruga e Arbrit të lidhë Dibrën me Shkupin përmes Mavrovës dhe jo përmes variantit të mëparshëm përmes Kërçovës.

"Lidhja e ardhshme e Rrugës së Arbrit do të jetë nga vendkalimi kufitar Bllatë deri në Bllacë me Kosovën dhe rruga do të kalojë përmes Mavrovës. Gjithashtu pritet të përfundojë punimet në aksin rrugor Ura e Boshkut deri në Dibër, ndërsa në realizim e sipër është aksi rrugor prej Dibrës deri në vendkalimin Bllatë. Në ndërkohë është parashikuar të realizohen edhe punime të konsiderueshme në riparimin e aksit rrugor Ura e Boshkut deri në Mavrovë", thotë Lata për gazetën KOHA. Se në plan të parë është që lidhja e Dibrës me Shkupin të realizohet përmes Mavrovës dhe jo përmes Kërçovës, konfirmohet edhe nga planet e ekzekutivit të ri për riparimin dhe ndërtimin e rrugëve të ndryshme në periudhën e

RUZHDI LATA

"Lidhja e ardhshme e Rrugës së Arbrit do të jetë nga vendkalimi kufitar Bllatë deri në Bllacë me Kosovën dhe rruga do të kalojë përmes Mavrovës. Gjithashtu pritet të përfundojë punimet në aksin rrugor Ura e Boshkut deri në Dibër, ndërsa në realizim e sipër është aksi rrugor prej Dibrës deri në vendkalimin Bllatë. Në ndërkohë është parashikuar të realizohen edhe punime të konsiderueshme në riparimin e aksit rrugor Ura e Boshkut deri në Mavrovë



ardhshme. Në programin e punës së qeverisë për lidhjen e përfolur të mëparshme nga Ura e Boshkut deri në Izvor të Kërçovës, që do të lidhte Rrugën e Arbrit me autostradën Kërçovë-Ohër, theksohet se ky opsion paraqitet si mundshëm vetëm në rast se gjenden mjete financiare për ndërtimin e saj. "Parashikohet rikonstruim dhe zgjerim i rrugës rajonale Dibër-A4, gjegjësisht të lidhjes së saj përmes Mavrovës me kufirin me Kosovë. Pritet edhe përfundim i ndërtimit dhe rikonstruimit të rrugës shtetërore P2235, apo aksit rrugor prej Haneve të Mavrovës deri në fshatin Mavrovë, gjegjësisht nga Diga e Mavrovës deri te Kanali i Belicicës. Planifikohet edhe bisedime rreth financimit të mundshëm të ndërtimit të rrugës së re rajonale Izvor-Ura

e Garit", thuhet në plan Programin qeveritar 2017-2020. Gjithashtu, planifikohet edhe vendosja e rrjeteve mbrojtëse nga rrëshqitja e dheut dhe paraqitja e gurëve në rrugë në aksin rrugor Ura e Boshkut-Dibër, si dhe vendosja e rrjeteve mbrojtëse edhe në aksin rrugor gjatë rrjedhës së Lumit Radika.

Prej 25 vitesh banorët e Dibrës së Madhe dhe të Vogël kanë pritur ndërtimin e Rrugës së Arbrit, e cila shkurton distancën me Tiranën në më pak se 100 kilometra dhe paraqet shpresë për zhvillimin ekonomik të të dy Dibrave, si dhe rritë perspektivën e zhvillimit të turizmit. Ajo konsiderohet si një arterie e rëndësishme rrugore që forcon lidhjen e Shqipërisë me Maqedoninë dhe me korridoret rajonale të komunikacionit. Rruga e tan-

"Parashikohet rikonstruim dhe zgjerim i rrugës rajonale Dibër-A4, gjegjësisht të lidhjes së saj përmes Mavrovës me kufirin me Kosovë. Pritet edhe përfundim i ndërtimit dhe rikonstruimit të rrugës shtetërore 2235, apo aksit rrugor prej Haneve të Mavrovës deri në fshatin Mavrovë, gjegjësisht nga Diga e Mavrovës deri te Kanali i Belicicës. Planifikohet edhe bisedime rreth financimit të mundshëm të ndërtimit të rrugës së re rajonale Izvor-Ura e Garit", thuhet në plan Programin qeveritar 2017-2020

ishme Tiranë-Maqellarë, ku ndahet në dy drejtime - për në Peshkopi dhe Dibër të Madhe, është e keqmbajtur në mjaft segmente, e lodhshme dhe e gjatë. Me shpejtësi të zakonshme duhen rreth 4 orë për të mbërritur në Dibër të Madhe dhe pak më shumë për të mbërritur në Peshkopi, si edhe anasjelltas në Tiranë. Projekti i Rrugës së Arbrit e shkurton këtë udhëtim në rreth dy orë. Qeveria shqiptare të enjten njoftoi se ga ana tjetër, sipas ofertës së propozuar nga kompania "Gjoka Konstruktion", rruga do të kushtojë 33.6 miliardë lekë, ose rreth 250 milionë euro dhe ndërtimi i saj do të zgjasë 46 muaj. Megjithatë në garën e fortë për ndërtimin e saj pritet të marrin pjesë edhe kompani të huaja me renome nga Turqia si dhe shtete të tjera perëndimore, të cilat në muajin tetor do të fitojnë tenderin për ndërtimin e saj me koncesion. Për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, Qeveria Shqiptare kishte në diskutim tri variante: atë të dhënies me koncesion, të financimit për ndërtimin e

rrugës nga buxheti i shtetit, apo investimin e segmentit alternativ Dibër-Librazhd-Tiranë. Si duket kostoja e lartë e projektit ka orientuar ndërtimin nëpërmjet partneritetit publik-privat. Ndërtimi i saj ka qenë një prej premtimeve më të mëdha në thujt të gjitha fushat që janë zhvilluar pas rënies së komunizmit në Shqipëri, por për arsye të ndryshme, ka mbetur një projekt në sirtar, edhe pse me vite ishte një prej kërkesave kryesore të komunitetit dibran. Ndryshe, Rruga e Arbrit, duhet të lidhë Detin Adriatik dhe Detin e Zi, si dhe të përmirësojë transportin e brendshëm ndërmjet Tiranës dhe Durrësit dhe të gjithë pjesës veriore të Shqipërisë, po ashtu edhe transportin e brendshëm në Maqedoni, Kosovë dhe Bullgari.

"Katimerini" shkrim për kontestin e emrit

Athina i frikësohet aleancës Sofje-Shkup

"Duke e pas parasysh atë se Shkupi veç më ka hedhur poshtë formulë gjeografike, ata tani kanë fituar edhe aleat në Bullgari, e cila deri dje ishte aleate e Greqisë. Kështu, jozyrtarisht u krijua 'front' i Sofjes dhe Shkupit kundër 'vijës së kuqe' të Athinës për emrin e ndërlikuar me përcaktimin gjeografik për të gjitha përdorimet (erga omnes)", shkruan Katimerini

Athinë, 13 gusht - Siç po afrohet vjeshta, si çdo vit, kemi marrë informacione, zakonisht me rrjedhje, në lidhje me emrin e Shkupit, shkruan "Katimerini" në komentim me titull "Sofja, Shkupi dhe emri". Sipas gazetës "deri më tani nuk janë marrë hapat esenciale dhe vetëm janë konfirmuar pozitivet e fuqishme të Shkupit dhe Athinës me përkujtimin se të dyja palët veç më kanë bërë lëshime". "Tani, për herë të parë në vitet e fundit kemi disa të dhëna të reja, të cilat nën kushte të caktuara, mund ta pengojnë procesin, por megjithatë jo para zgjedhjeve lokale në tetor në Shkup", informon "Katimerini". Në tekst përkujtohet se deri në fillim të verës, Greqia "duhej të luftojë kundër Gruesvitit dhe histerisë së tij nacionaliste". "Kjo na u përgjigj dhe na dha argumente që ta pengojmë perspektivën euro-atlantike të vendit", komenton "Katimerini" duke shtuar se lajmi paraprak "ka zgjeruar helm anti-grek në mendimin publik". Lajmi i parë për Greqinë, nga afrimi midis Sofjes dhe Shkupit veç më ka arritur, thekon "Katimerini" duke shtuar se "para se boja të thahet nga nënshkrimi i marrëveshjes për miqësi, ministrja bullgare e Punëve të Jashtme Zaharieva deklaroi se Sofja nuk pajtohet që emri i IRJM-së të përmblajë përcaktim gjeografik, siç është Maqedonia Veriore ose e Poshtme, sepse kjo mund të fsheh aspiratën për 'Maqedoni të Pirinit', pjesa nga Maqedonia e vjetër e cila i ka takuar Bullgarisë". "Duke e pas parasysh atë se Shkupi veç më ka hedhur poshtë formulë gjeografike, ata tani kanë fituar edhe aleat në Bullgari, e cila deri dje ishte aleate e Greqisë. Kështu, jozyrtarisht u krijua 'front' i Sofjes dhe Shkupit kundër 'vijës së kuqe' të Athinës për emrin e ndërlikuar me përcaktimin gjeografik për të gjitha përdorimet (erga omnes)", konkludon gazeta dhe në fund shton se punët edhe më shumë po komplikohen nëse në tërë këtë jepet kundërshtimi kategorik i Kamenos, partneri i SYRIZA-s në Qeverinë greke, i cili nuk pranon që emri ta përmblajë 'fjalën Maqedoni ose derivat të tij'".



Përpunohet emrat për kryetarë të komunave

Figura të forta partiake për zgjedhje lokale

Bujar Osmani, Agim Nuhiu, Nevzat Bejta, Ramiz Merko, Fatmir Dehari, Ruzhdi Lata... janë disa nga emrat që do të prijnë garës për komunat shqiptare nga BDI. Nga ASH, kryetari i LR-PDSH-së, Ziadin Sela dhe sekretari i përgjithshëm, Arbën Taravari, kandidat të mundshëm për në Strugë dhe Gostivar, ndërsa Remzi Memedi në Kërçovë. Shaban Zendeli, Arben Llabunishti dhe Kastriot Rexhepi pritet të kandidojnë në Çair, Strugë dhe Likovë



9 SHTATORI, AFATI I FUNDIT PËR KANDIDATURAT

Komisioni Shtetëror Zgjedhor tashmë ka miratuar kalendarin për zgjedhjet lokale 2017, ndërkohë që fushata fillon më 25 shtator. Shikimi publik i Listës zgjedhore fillon më 21 gusht dhe do të zgjasë deri më 9 shtator, ditën kur partitë do të dorëzojnë listat për kryetar komunash dhe ato për këshilltarë komunal. Afati për mbledhjen e nënshkrimeve për kandidatët e pavarur për këshilltar dhe kryetar komunash është nga 21 gushti deri më 4 shtator, ndërkohë që partitë politike duhet që më vonë deri më 9 shtator të dorëzojnë kandidaturat. Zgjedhjet lokale në vend do të mbahen më 15 tetor, ndërsa rrethi i dytë më 29 tetor.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 8 gusht - Në zgjedhjet lokale të radhës që do të mbahen më 15 tetor pritet një garë e nxehtë mes subjekteve politike shqiptare. Pa u bërë një vit i plotë nga zgjedhjet parlamentare, me BDI dhe ASH në pushtet dhe BESA e PDSH në opozitë, pikërisht zgjedhjet lokale po shihen si test për mbështetjen e tyre në elektoratin shqiptar, por edhe si një mundësi për të treguar performansa të mira në komunat shqiptare në dobi të qytetarit shqiptar. Këto ditë, partitë shqiptare janë në vllugun e punës për të konkretizuar emrat që do të prijnë garës për kryetar komunash, ndërsa jo pa interes do të jenë dhe emrat për bartës të listave për këshilltar komunal. Gazeta KOHA, duke pasur kujdesin që të mos spekulojë me emra, por vetëm atëherë kur burimet e saj brenda këtyre partive janë të gatshëm të ndajnë atë që ia vlen të ndahet me publikun para se vetë partitë të shpallin publikisht kandidatët për kryetar, ka arritur megjithatë të nxjerr disa emra të mundshme nga të tria partitë nëpër disa nga komunat shqiptare. Siç merret vesh KOHA, në këtë rast - të tria subjektet do të garojnë në komuna me eksponentë më të lartë po-

litik, ndërsa lideri i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela me gjasë edhe vetë do të hyjë në garë me pretendime për të fituar sërish Komunën e Strugës. BDI pritet të futet në garë me adutët e saj në Qeveri - zëvendëskryeministrin për çështje evropiane, Bujar Osmani, në Komunën e Çairit, ndërsa zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu, në Komunën e Tearcës, kjo sipas burimeve partiake të afërta me Kryesinë e ngushtë të BDI-së. Referuar këtyre burimeve, është e sigurt se nënkryetari i BDI-së, Nevzat Bejta, do të jetë përsëri kandidat për kryetar të Gostivarit, ndërsa edhe anëtar i Kryesisë qendrore - tani ministër pa resor për investimet, Ramiz Merko, do kthehet në garë për Komunën e Strugës, të cilën e udhëhoqi tetë vite më herët para se Ziadin Sela - atëherë nga PDSH, ta merrte kryesimin e saj. Në Komunën e Sarajit, kandidat më i mundshëm do të jetë ish ministri i Ekologjisë, Bashkim Ahmeti,

ndërsa në Vrapçishtë pritet të jetë një kandidat nga fshati Gradec. Në Kërçovë, BDI këmbëngul përsëri të ketë kandidat kryetar aktual Fatmir Dehari, i cili me gjasë - përveç Lëvizjes BESA, do të mbështetet nga të gjitha partitë tjera shqiptare dhe organizata joqeveritare. Në Tetovë, Teuta Arifi nuk heq dorë edhe nga një mandat, megjithëse kandidatit me më shumë gjasë flitet të jetë Ibrahim Dehari, aktualisht nënkryetar i Degës së BDI-së për Tetovë. Kur jemi tek Likova, ende nuk ka kandidat potencial, ndërsa emrat që përfliten në degën e partisë janë ai ish-ministrit të Pushtetit Lokal, Lirim Shabani, anëtar i Kryesisë së degës së BDI për Likovë, Xhemal Ademi, Jahi Jahiu nga fshati Visthice, si dhe deputeti nga fshati Sllupçan, Rexhail Ismaili. Ndryshe, sipas burimeve anonime - një pjesë e Kryesisë qendrore flitet se i kanë kërkuar ministrin aktual të Ekologjisë, Sadulla Duraku, të kthehet përsëri si kandidat i mundshëm për krye-

tar të Likovës me qëllim që të përfundojë me disa projekte kapitale në këtë rajon. Sa i përket Dibrës, një bastion i BDI-së ndër vite, por që në këto zgjedhje pritet të sfidohet seriozisht nga Lëvizja BESA, pa mos e përkrahur as LSDM-në, në këtë komunë aty do të vazhdojë të jetë kandidat kryetar aktual Ruzhdi Lata. Nga Lëvizja BESA thonë se ditëve në vijim do të shpallin publikisht emrat e kandidatëve për kryetar komunash. "Ditët në vijim do ta bëjmë shpalljen e kandidatëve. Janë një prej zgjedhjeve më të rëndësishme për ne. Po mundohemi të bëjmë të gjitha përgatitjet si në aspekt të kandidatëve, listave për këshilltar komunal, përgatitjen e projekteve të rëndësishme që të dalim me një program të pasur. Lëvizja BESA është në konsultim me të gjithë strukturat e saj, këshillat vendor dhe lokal gjithandej Maqedonisë për emra të mundshëm për kryetar komunash. Deri tani nuk kemi ndonjë emër konkret, por opinioni do të jetë

i njoftuar me kohë edhe për kandidatit e mundshëm por edhe me ekspertët të cilët do të qendrojnë prapa kryetarit të komunës gjatë asaj fushate", tha për gazetën KOHA Faton Fazliu, zëdhënës i Lëvizjes BESA. Megjithatë, gazeta KOHA nga një pjesë e burimeve tjera të afërta me Lëvizjen BESA merr vesh se nënkryetari i kësaj partie, Arben Llabunishti do të jetë kandidat për Komunën e Strugës, deputeti Fadil Zendeli për Komunën e Gostivarit, Shaban Zendeli apo Murtezan Idrizi për Komunën e Likovës, Kastriot Rexhepi dhe Bekim Salju për Komunën e Çairit. Ndryshe, Lëvizja BESA pritet ta sfidojë seriozisht BDI-në në Likovë, Çair, Vrapçishtë, Saraj, Tearcë, Tetovë dhe Strugë. Për të sfiduar seriozisht BDI-në, në Lëvizjen BESA thonë se momentalisht po bëhen konsultime intensive sidomos për komunat e lartpërmendura që të korin fitore të sigurt, ndërsa nuk përjashtojmë edhe emrat jashtë strukturave partiake.

Nga Aleanca për Shqiptarët thonë se ky subjekt do të dalë me kuadrot më të mirë partiak, por janë të hapur edhe për kandidatët nga shoqëria civile. "Jemi të gatshëm në çdo moment të konkurrojmë me kandidatët tonë në zgjedhjet lokale, duke ofruar alternativat dhe potencialin me të mirë kadorvik të subjektit tonë politik. Nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve lokale, jeni fokusuar në debatet e brendshme partiake, për të nominuar kandidatë potencial. Kjo përzgjedhje do të bëhet nga radhët e subjektit tonë politik, por nuk përjashtohet edhe mundësia e autoriteteve që kanë peshë në mjedise të ndryshme, apo nga sektori civil. E rëndësishme është që kandidatët tanë të kenë bagazh profesional dhe të gëzojnë reputacion në komunat ku do të garojnë", theksoi për gazetën

KOHA, Flakron Bexheti, zëdhënës i LR-PDSH-së. Ai nuk pranoi të jap emra konkret, megjithatë gazeta KOHA nga burime tjera të afërta me këtë parti merr vesh se kryetari i LR-PDSH-së, Ziadin Sela, ka ofruar veten të jetë kandidat për Komunën e Strugës, ndërsa sekretari i përgjithshëm Arben Taravari - aktualisht ministër i Shëndetësisë, të jetë kandidat për Komunën e Gostivarit. Megjithatë kandidatura e Arbën Taravarit është e lidhur me kandidimin e kryetarit Sela, ku nëse ky i fundit nuk do të kandidojë për Strugën, as në Gostivar nuk do të kandidojë Taravari. Në Gostivar, përveç Arben Taravarit, kandidat më potencial janë edhe ish-ministri i Arsimit, Sulejman Rushiti dhe Halil Snopçe. Në Kërçovë, Aleanca për Shqiptarët do të konkurrojë me Remzi Memedin, në Dibër me Ibrahim Kollarin, ndërsa në Çair me shumë gjasë ka Bujare Azizin. Në Tetovë, ende nuk ka kandidatura të sigurt, por janë tre persona që pretendojnë kandidaturën: Adnan Azizi anëtar i Kryesisë qendrore, Arif Selami, kryetari Degës për Tetovë dhe Hajrullah Hasani - biznesmen nga kjo komunë.

Edhe nga PDSH thonë se kjo parti do të garojë më kandidat dhe me lista për këshilltar në të gjitha komunat ku jetojnë shqiptarët. Ndërsa sa i përket emrave, zëdhënësi i partisë Bekim Fazliu thotë se janë në fazën e përgatitjeve partiake, pa dhënë ndonjë detaj tjetër. "PDSH do të hyjë në këto zgjedhje me pretendime të mëdha për të korrur fitore në komuna të rëndësishme shqiptare. Çdokund ku ka shqiptarë PDSH do të ketë kandidat për kryetar komunash dhe kandidat për këshilltar komunal. Emra nuk mund të japim njëherë, pa u përmbullur të gjitha përgatitjet partiake", theksoi për gazetën KOHA Bekim Fazliu, zëdhënës i PDSH-së.

Hazbi Lika për REL

Çështja e gjuhës nuk është diçka luksoze, është nevojë



Shkup, 13 gusht - Propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve, i cili pritet të dërgohet për miratim në Parlamentin e Maqedonisë, konsiderohet një rezultat drejt zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit. Hazbi Lika,

zëvendëskryeministër në Qeverinë e Maqedonisë, për dikasterin e sistemit politik, që në fokus ka zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, thotë për Radion Evropë e Lirë se dokumenti kornizë, nëpërmjet së cilit iu dha fund konfliktit të armatosur në vitin 2001, në masë të madhe ka avancuar realizimin e kërkesave të shqiptarëve të Maqedonisë. Megjithatë, Lika konsideron se ka ende punë për t'u bërë. "Me një marrëveshje nuk mund të mbyllet kërkesat për realizimin e të drejtave të një

kombi, populli. Ata duhet në vazhdimësi të kërkojnë, jetësohen, derisa ky shtet (Maqedonia) të jetë i barabart për të gjithë. Kështu, hap pas hapi, politika duhet të fokusohet në prioritetet. Ne kemi prioritetet, për momentin jemi të fokusuar në Ligjin e gjuhëve. Çështja e gjuhës nuk është diçka luksoze përmes së cilës kërkesë partitë politike synojnë të reklamojnë veten, por është një gjë më se e nevojshme, sepse veçanërisht të rinjtë gjithnjë e më pak e mësojnë gjuhën shqipe dhe

për ta është shumë e nevojshme që administrata shtetërore t'u ofrojë shërbime edhe në gjuhën shqipe. Njëkohësisht, edhe përfarë qesimi i drejtë dhe adekuat, është çështje me prioritet për ne", thotë Lika, ish-komandant i UÇK-së gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001. Lika thekson se një nga pikat kryesore të planit të Qeverisë të njohur si Plani 3-6-9- për nxitjen e procesit eurointegruar të Maqedonisë është edhe jetësimi i Marrëveshjes së Ohrit. Pjesa që ka të bëjë me

Marrëveshjen e Ohrit përmban aspektin legjislativ përkatësisht Ligjin e gjuhëve, i cili tashmë është miratuar në qeveri dhe pritet të kalojë edhe në Parlament që të mund të gjejë zbatim edhe në praktikë. Lika thotë se Ligji për gjuhët, qytetarëve shqiptarë u mundëson të përdorin gjuhën shqipe në të gjitha institucionet e pushtetit vendor dhe atij qendror. "Me ligjin e gjuhëve, të propozuar nga Qeveria, nuk mund të them se mbyllet tërësisht kjo kapitlinë e Marrëveshjes së Oh-

rit, por mendoj se qytetarëve shqiptarë me këtë ligj u ofrohet një mundësi e mirë që në administratë të shërbehen edhe në gjuhën shqipe. Kështu që gjuha shqipe gjen zbatim në aspektin vertikal nga mbledhjet e Qeverisë ku gjuha shqipe gjen zbatim në të folur dhe dokumentet e shkruara deri në institucionet më të ulëta. Përderisa në aspektin horizontal, në të gjitha komunat ku shqiptarët përbëjnë 20 për qind (të popullsisë), gjuha shqipe gjen zbatim në të gjitha institucionet", shpreh Lika.



Ekspeditat e munguara arkeologjike

Më shumë se politikë me trashëgiminë

Harta e gërmimeve arkeologjike anashkaloi për vite me radhë të gjitha destinacionet e banuara me shqiptarë, duke lënë pa përgjigje pyetjet se ç'po ndodh me ato zbulime në shumë fshatra, si pllaka varri ilire në Rashçe e Forinë, Gradec... e të tjera, një pjesë prej të cilave aksidentalisht mund të vazhdojnë të ruhen në bodrume, ose thjesht mund të kenë humbur, dëmtuar, apo edhe shitur, nëse potencialet arkeologjike të këtyre zonave janë thjesht mite, apo të vërteta



Koha **Evis HALILI**

Shkup, 13 gusht - Nëse ekspedita në Kalanë e Tetovës dështoi, pa arritur që gjurmimet të përbushnin pritjet për gjetjen e artefakteve nga lashtësia, ajo mund të cilësohet si projekti i parë dhe i vetëm serioz për të hulumtuar në këto zona. Harta e gërmimeve arkeologjike anashkaloi për vite me radhë të gjitha des-

tinacionet e banuara me shqiptarë, duke lënë pa përgjigje pyetjet se ç'po ndodh me ato zbulime në shumë fshatra, si pllaka varri ilire në Rashçe e Forinë, Gradec... e të tjera, një pjesë prej të cilave aksidentalisht mund të vazhdojnë të ruhen në bodrume, ose thjesht mund të kenë humbur, dëmtuar, apo edhe shitur, nëse potencialet arkeologjike të këtyre zonave janë thjesht mite, apo të vërteta. Pak kohë më parë historiani Ekspertë të kësaj fushe, arkeologë e historianë pohojnë se për të hulumtuar, për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë duhet që të tejkalohen barrierat

politike dhe të bëhen marrëveshje mes partnerëve që qeverisin shtetin. Rasti më flagrant është Qendra e Konservimit në Gostivar. E çelur gati dhjetë vjet më parë, me qëllimin për të restauruar, konservuar dhe hulumtuar zonën nuk arriti që të funksionojë sipas të gjitha përcaktimeve. Përveç restaurimeve dhe konservimeve të disa objekteve në qytet, nuk u zhvillua asnjë ekspeditë arkeologjike. Nuk u arrit as të ndërrohej statusi që kufizon gjeografikisht veprimtarinë e saj. Ish drejtori, Adnan Fejzullahu, i cili drejtori këtë institucion deri para pak ditësh, në përfundimin e mandatit

të dytë, thotë se janë penguar për të realizuar ekspedita. "Maqedonia lindore është gjendur në një ekspansion gërmimesh arkeologjike, rrënojat e artefaktet e gjetura mbi dhe nën tokë i kanë shërbyer politikës, ndërsa në pjesën perëndimore, sidomos në vendbanimet shqiptare jo vetëm që nuk janë bërë, por as që janë lejuar. Neve si qendër na janë refuzuar disa projekte radhazi për hulumtime në Gradec. Krijimi i kësaj Qendre ka paraparë gërmimet, por një hendikep ka qenë edhe kufizimi i saj, për të cilin nuk u ndryshua Ligji i Kulturës.

Kam kërkuar që krahas komunës së Gostivarit të përfshihet edhe Vrapçishti, Mavrovë - Rostushë, por po ashtu nuk është aprovuar", thotë ish drejtori, historiani Adnan Fejzullahu. Neglizhenca institucionale, indiferenca e shoqërisë në përgjithësi, por edhe rreziku nga "gërmuesit" e pavarur mund të sjellë dëmtimin e parikuperueshëm të kësaj pjesë të trashëgimisë materiale. Kështu shprehet arkeologja Narena Luma-Veseli, pjesë e ekspeditës arkeologjike në Kalanë e Shkupit. "Pjesa perëndimore e Maqedonisë dhe shume lokalitete të tjera ku ka kultura te ndryshme duke përfshirë dhe ato iliro-dardane që nuk janë aspak të hulumtuara. Mund të përmend Orashën, Rashçen, Forinën, Kërçovën..., ku asnjë institucion nuk ka treguar asnjë pikë interesimi dhe që për fat të keq do të vazhdojnë të ngelin në harresë. Më e keqja në këtë situatë vjen fillimisht nga ato që gjithmonë ekzistojnë në arkeologji - gërmuesit e egër, të cilët i keqpërdorin artefaktet dhe gjetjet arkeologjike. Trashëgiminë po e rrezikon edhe më shumë mosinteresimi i shoqërisë dhe institucioneve, mungesa e kuadrove, që ndoshta mund të rrezikojë

seriozisht edhe zhdukjen e asaj pjese kulture dhe historie që na takon neve si shqiptarë. Dhe prandaj abuzimi me faktet dhe shtrembërimin e historisë tonë do të vazhdojë ashtu si më parë", thotë Luma. Dëshmi sesi mund të keqpërdoren dhe keqinterpretohen artefaktet e gjetura arkeologjike është Kalaja e Shkupit. Të paktën kështu konstatojnë arkeologë e historianë arti maqedonas për interpretimet dhe ekspeditat e kryera pas viteve 50-të. Në fund të vitit të kaluar, ish drejtuesi i ekspeditës arkeologjike si pjesë e megaprojektit për revitalizimin e Kalasë gjatë periudhës 2007-2012, Dragi Mitrevski, në një botim të titulluar "Fortesa e Shkupit Kalaja" jep versionin e ri për ekspeditat e mëparshme dhe për gjetjet e reja. Sipas këtij libri në tentativa për të dhënë përgjigje shkencore, për shumë vjet me radhë në këtë zonë janë bërë masakra arkeologjike dhe janë dhënë shpjegime naive dhe antishkencore për të. Konstatimet e përmbledhura në këtë libër nuk janë komentuar deri tani nga asnjë historian, arkeolog, apo historian arti nga pjesa shqiptare, nëse ky libër hedh të vërteta, apo krijon mite të reja për Kalanë.

Rroga mesatare dhe papunësia në ish vendet e Jugosllavisë

Slovenët paguhen tre herë më shumë se maqedonasit

Rroga me e lartë mesatare e paguar në muajin maj në vendet e rajonit, sipas të dhënave zyrtare të EUROSTAT-it, është paguar në Slloveni në vlerë të përgjithshme prej 1050 euro, ndërsa rrogë më të ulët mesatare kanë marrë të punësuarit në Maqedoni në vlerë prej 372 euro ose 22.889 denarë. Njëkohësisht, rroga mestare në muajin maj në Kroaci ka shënuar vlerën 813 euro, në Mal të Zi 510 euro, në Bosnje 439 euro. Në Serbi - rroga mesatare e paguar në muajin maj ka shënuar vlerën prej 409, ndërsa në Kosovë - në institucionet publike është paguar në vlerën prej 429 euro

Koha **Zejnulla VESELI**

Shkup, 13 gusht - Nga gjashtë vendet e ish-Jugosllavisë, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova jo vetëm që kanë paga më të ulëta në ra-



jon, por njëherësh përbëjnë dhe numrin më të madh të papunëve. Këto janë të dhënat më të fundit të dala nga Agjencia e Statistikave të Komuniteteve Evropiane (EUROSTAT), sipas të cilës, rroga më e lartë mesatare e paguar në muajin maj në vendet e rajonit, sipas të dhënave zyrtare, është paguar në Slloveni në vlerë të përgjithshme prej 1050 euro, ndërsa rrogë më të ulët mesatare nga vendet e rajonit gjatë muajit maj kanë marrë të punësuarit në Maqedoni në vlerë prej 372 euro ose

22.889 denarë. Njëkohësisht, rroga mestare në muajin maj në Kroaci ka shënuar vlerën 813 euro, në Mal të Zi 510 euro, në Bosnje 439 euro. Në Serbi, rroga mesatare e paguar në muajin maj ka shënuar vlerën prej 409, ndërsa në Kosovë - rroga mesatare për punonjësit në institucionet publike në muajin maj është paguar në vlerën prej 429 euro, derisa në sektorin privat paga mesatare e paguar në muajin maj ka shifër prej 349 euro. Ndërkaq sa i përket rritjes së rrogës mesatare në

vendet e rajonit krahasuar me vitin e kaluar, rritje më të lartë ka pasur për punonjësit në Serbi dhe për periudhë një vjeçare - rroga mesatare është rritur për 39.93 euro, ndërsa në Slloveni rritja ka qenë 30.38 euro. Rritje më të ulët të rrogës mesatare gjatë vitit 2016 ka pasur për punonjësit e Bosnjës dhe ta për 11.71 euro, ndërsa rritje më të ulët të rrogave vitin e kaluar ka pasur Maqedonia dhe atë në vlerë prej 9 euro për periudhë njëvjeçare. Rrogë më të lartë mesatare gjatë viti 2016

kanë marrë punonjësit slovenë në vlerë prej 1020 euro, në Kroaci rroga mesatare ka arritur vlerën 749 euro, në Mal të Zi rroga mesatare në vitin 2016 ka qenë 503 euro, në Bosnje 428 euro, Kosovë 426 euro në sektorin publik, në Serbi 369 euro dhe rroga më e ulët mesatare është paguar në Maqedoni në vlerë prej 363 euro. Ndërkohë, rrogë më të ulët minimale në vendet e rajonit marrin punonjësit në Kosovë në vlerë prej 130 euro, ndërsa rroga më të larta mesatare paguan Sllovenia në vlerë prej 805 euro. Në Kroaci, rroga minimale kap vlerën prej 433 euro, Mal të Zi 288 euro, Serbi 250 euro dhe Maqedoni 231 euro. Njëherësh, sipas të dhënave të fundit të EUROSTAT-it, Kosova, Bosnja dhe Maqedonia kanë shkallë më të lartë të papunësisë. Numri i të papunëve në Kosovë në vitin 2016 ka qenë 28.7 për qind, në Bosnje 25.4 për qind, ndërsa në Maqedoni - numri i të papunëve kap shifrën prej 22.9 për qind. "Maqedonia, Kosova dhe Bosnja në fushën e punësimit qëndrojnë shumë keq me vendet e rajonit dhe pikër-

isht në këto shtetet e ish-Jugosllavisë ka ikje më të madhe jashtë vendit tek të rinjtë dhe qytetarët të arsimuar për shkak se me vite nuk arrijnë të gjejnë një vend pune", thuhet raportin e fundit të EUROSTAT-it. Në Mal të Zi, numri i të papunëve ka qenë 16.9 për qind, në Serbi numri i të papunëve në vitin 2016 ka shënuar shifër prej 13 për qind, në Kroaci gjatë viti 2016 si të papunë janë regjistruar 11.7 për qind dhe në Slloveni - të papunë janë të regjistruar vetëm 8 për qind. Ndryshe, përveç pagës mesatare mujore bruto në sektorin shtetëror - përllogaritjet edhe paga mesatare mujore bruto për një të punësuar. Kjo pagë mesatare llogaritjet si raporti i pagës dhe trajtimeve mujore me numrin e të punësuarve si në sektorin shtetëror dhe atë privat. Sipas sektorëve të ekonomisë, pagën mesatare mujore më të lartë e gjejmë në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit. Që prej vitit 2000 e deri në vitin 2013 ky sektor ka kryesuar nivelin më të lartë të pagës mesatare mujore për të punësuar.



Publikohet lista preliminare për Akademinë Ushtarake

Vetëm një shqiptar në AU, Maksuti qetëson

Edhe pse në listën e fundit të publikuar nga Akademia Ushtarake "Mihaillo Apostolloski" qëndron vetëm një kandidat shqiptar për vitin akademik 2017/18, zëvendësministri i Mbrojtjes, Bekim Maksuti siguron se përfaqësimi i drejtë dhe adekuat do të respektohet në përputhje me normën ligjore prej 25 për qind

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 13 gusht - Në listat e fundit të publikuara nga Akademia Ushtarake "Mihaillo Apostolloski", për rrjedhën e pranimin të kandidatëve të ri për vitin akademik 2017/18, qëndron vetëm një kandidat shqiptar. Mirëpo, sipas zëvendëskryeministrit në Ministrinë e Mbrojtjes, Bekim Maksuti, kjo fazë e pranimin të kandidatëve është pjesë e procesit të rregullt për ata kandidatë, të cilët paraprakisht i kanë kaluar të gjitha nivelet e provimit pranues pa probleme. Në kuadër të zhvillimeve të fundit në Akademinë Ushtarake, zëvendësministri Maksuti edhe njëherë thekson se qëndron pas deklaratave të dhëna më herët se përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i shqiptarëve në këtë konkurs do të respektohet në përputhje me normën ligjore prej 25 për qind.

"Një pjesë e kandidatëve përsëri do t'i nënshtrohen provimeve të caktuara për pranim në Akademinë Ushtarake. Brenda kësaj periudhe, shkeljet procedurale për konkursin e shpallur nga Akademia i ka vërtetuar edhe Ministria e Arsimit. Nga ana tjetër, jemi në pritje të konstatimit të një fakti të tillë edhe nga Komisioni i Antikorrupsionit, i cili për momentin gjendet në pushim kolektiv. Njëherësh, dua të sqaroj se fillimi i vitit akademik nuk e pengon ripërsëritjen e një pjese të konkursit, me të cilën ne do ta respektojmë parimin e përfaqësimit të drejtë të shqip-



BEKIM MAKSUTI

Një pjesë e kandidatëve përsëri do t'i nënshtrohen provimeve të caktuara për pranim në Akademinë Ushtarake. Brenda kësaj periudhe, shkeljet procedurale për konkursin e shpallur nga Akademia i ka vërtetuar edhe Ministria e Arsimit. Nga ana tjetër, jemi në pritje të konstatimit të një fakti të tillë edhe nga Komisioni i Antikorrupsionit, i cili për momentin gjendet në pushim kolektiv. Njëherësh, dua të sqaroj se fillimi i vitit akademik nuk e pengon ripërsëritjen e një pjese të konkursit, me të cilën ne do ta respektojmë parimin e përfaqësimit të drejtë të shqiptarëve në këtë akademi



tarëve në këtë akademi", thotë për KOHA zëvendësministri Maksuti. Njëkohësisht, ai për të satën herë me radhë apelon që kandidatët, të cilët do të aplikojnë në këto konkurse të jetë me nota të shkëlqyeshme, për arsye se gjatë periudhës së shkuar, është vërtetuar se kandidatët me nota mesatare të cilët pranohen në këtë Akademi, gjatë ciklit të studimeve katër vjeçare hasin në probleme në dhënien e provimeve. Ndërkohë, pas përfundimit të testeve në gjuhë angleze dhe në matematikë, gjegjësisht testimi për vlerësimin e përgatitjeve fizike që u realizuan në fundjavën e kaluar, në adresën e internetit Akademisë Ushtarake

është publikuar lista preliminare e rangimit të kandidatëve për pranim në akademi, e cila është zhvilluar në bazë të konkursit të hapur më 4 maj të këtij viti. Komisioni konkurrues pesë anëtarësh i kryesuar nga kolonel Toni Gjorgjiev dhe katër anëtar tjerë, kandidatit shqiptar Amar Nimet Memedi e kanë vendosur në krye të listës prej pesë kandidatëve të pranuar në këtë fazë preliminare. Ndërkohë, në Këshillin ligjor, i cili është pjesë e kësaj liste, Komisioni konkurrues ka theksuar se pesë kandidatët të pranuar në këtë fazë preliminare kanë të drejtë të ankesës, e cila brenda 24 orëve duhet të parashtrahet deri te zyra e Dekanatit të Akademisë

përmes Komisionit konkurrues. Ndryshe, pas ankesave të shumta të kandidatëve për pranim në Akademinë Ushtarake, në qershor të këtij viti Ministria e Mbrojtjes solli vendim që të përsëritet i gjithë konkursi për kandidatët të cilët masovikisht u refuzuan. Ministria e Mbrojtjes në këtë rast ua pranoi ankesat kandidatëve të rënë nga testi psikik, kurse Akademia i nxori emrat në ueb faqen e saj se të njëjtit duhet të paraqiten për së dyti. Mirëpo, kandidatët e refuzuar pasi janë paraqitur për testim, nuk janë pranuar nga mjeku përkatës i cili pa asnjë arsyetim nuk i ka pranuar kandidatët, dhe me këtë veprim nuk e ka përfillur vendimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Sipas kandidatëve, problemi me kontrollet psikiatrike qëndron te mjeku psikiatër, Petre Risteovski, i cili deri më sot ka qenë i pakapshëm për të sqaruar arsyet pse nuk e respekton vendimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Shkeljet dhe parregullsitë me këtë konkurs i ka pranuar edhe vetë Ministria e Mbrojtjes, Radmilla Shkerein-ska, e cila tha se për dallim nga vitet e mëhershme, këtë viti konkursi është shpallur shumë më herët, me çka ish përbërja e kësaj ministrie ua ka cenuar të drejtë e konkurruesit një pjesë të madhe të nxënësve.

Kronikë

Grabitje e armatosur në një market në Shkup

Persona të maskuar me kanosje me armë nga një market në Shkup kanë marrë një shumë të pakonfirmuar të parave nga qarkullimi ditor dhe janë larguar në drejtim të panjohur. Siç informon MPB, grabitja është kryer nga dy persona të maskuar dje rreth orës 22 në "ZUR market" në rrugën "Volgogradska" në Shkup. Policia ka marrë masa për gjetjen e personave.

Telefonatë e rremë për bombë në një bankë në Shkup

Një autor i panjohur përmes telefonit ka paraqitur alarm të rremë se ka një bombë në bankën në rrugën "Naroden front" në Shkup. Pas verifikimit të ekipit të antiterrorizmit nuk është gjetur mjet shpërthyes. Siç informojnë nga MPB-ja, të shtunën në mëngjes në orën 9:35 minuta një i punësuar në bankë ka denoncuar se dy herë në bankë ka telefonuar një person i panjohur, mashkull, i cili në gjuhën serbe ka thënë "dilni jashtë ka diçka rreth bankës", e më pas ka thënë "ka bombë". Ekipi i Antiterrorizmit ka dalë në vendin e ngjarjes, ku është bërë kontroll i potë i objektit të bankës dhe nuk është gjetur mjet shpërthyes. Punohet për pastrimin e plotë të rastit dhe gjetjen e personit që ka bërë denoncim të rremë.

Më shumë shi ka rënë në Kumanovë

Në 24 orët e fundit më shumë reshje shiu kanë rënë në Kumanovë, ku sipas matjeve të DPHM-së janë regjistruar 22 litra në një metër katror. Sasi më të madhe të reshjeve ka pasur edhe në Shkup-Zajčev Rid 19 litra, në Shkup-Petrovec 11, në Berovë 8, në Kriva Pallankë 7, në Vinicë 5, në Dibër 3, në Gjurište 2 dhe në Lazaropole 1 litër në një metër katror. Nga DPHM informojnë se moti sot do të jetë me vranësira të ndryshueshme dhe më i freskët me reshje të kohëpaskohshme lokale të shiut, veçanërisht në pjesën veriore të vendit. Në disa vende do të ketë kushte për vranësira jostabile me shi të dendur dhe bubullima. Vonë pasdite vranësira do të zvogëlohet dhe reshjet do të ndalojnë gjithandej. Do të fryjë erë mesatare deri në të përforcuar veriore. Temperatura maksimale do të jetë në interval prej 21 deri në 30 gradë. UV indeksi do të ketë vlerën 6. Prej nesër vijon periudhë e motit stabil dhe më të ngrohtë. Temperatura e ditës do të jetë nën rritje graduale, por do të mbahet në kuadër të mesatares për këtë periudhë të vitit.

Bashkëpunimi me policinë e Maqedonisë, shembull për policinë e tjera



Tiranë, 13 gusht - Drejtori i policisë shqiptare, Haki Çako deklaroi se bashkëpunimi ndërmjet policisë të Shqipërisë dhe Maqedonisë, duke përfshirë edhe policinë kufitare është i shkëlqyer dhe se mund të shërbejë si shembull për policinë e vendeve të tjera. Ai e ka bërë këtë vlerësim pas vizitës në vendkalimin kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë, në Qafë Thanë. Në këtë vizitë drejtori Çako nga afër është njoftuar me implementimin e masave për sezonin turistik, por para së gjithash

për përforcimin e kontrollit gjatë daljes nga vendi të qytetarëve të Shqipërisë me qëllim të eliminimit të dukurisë së numrit të madh të azilantëve shqiptarë në BE. "Bashkëpunimi me policinë e Maqedonisë është e përqendruar në parandalimin e krimit ndërkombëtar, krimit të organizuar të tregtisë joligjore të çfarëdo qoftë lloji. Bashkëpunimi ynë është i shkëlqyer dhe këtë policinë e vendeve të tjera mund ta përdorin si shembull", thotë drejtori i policisë së Shqipërisë, Haki Çako.



Drejtori i shkollës më të madhe në qytet, Ramadan Imeri, shprehet se nuk mund të gjej fjalë miradie për të falënderuar këtë grup humanitar, të cilët sanojnë korridoret e shkollës, si dhe rritin e ujësjellësit i dëmtuar tepër shumë. "Ne nuk mund ti sanojmë ngaqë mjetet mungojnë, por fal këtyre vëllezërve tanë, dhe kjo shkollë po fillon të marrë pamjen që duhet"

Koha **Vjollca SADIKU**

Dibër, 13 gusht - Aktivitetet humanitare të mërgimtarëve dibranë nga SHBA-të nuk kanë të ndalur. Grupi tanimë i njohur humanitar nga SHBA-ja, i cili ka edhe përfaqësuesit të tyre në vendlindje, pas sigurimit të tre shtëpive për familje të varfra në Dibër, aktualisht po realizon sanimin të korridoreve në shkollën më të madhe nëntëvjeçare "Penestia". Duke marrë parasysh se aktiviteti i tyre do të vazhdojë, disa mërgimtarë nga ky grup që erdhën nga SHBA-ja nga së afër panë gjendjen në këtë objekt arsimor. Ata, duke parë situatën teje të rëndë të objektit, paralajmëruan edhe vazhdimin e investimeve në drejtim të sanimit edhe të klasave.

Në Dibër vazhdojnë aktivitetet humanitare

Në vend të MASH-it, shkollën e sanojnë mërgimtarët!

Ky grup i humanistëve para disa kohësh bëri edhe sanimin e pjesëve sanitare dhe disa klasa, ndërsa tani vazhdojnë investimet me qëllim që të përmirësohet situata në fjalë. Udhëheqësit e këtij grupi humanitar i takuam pikërisht në objektin e shkollës "Penestia", ku tashmë kanë filluar punimet. Aktivisti dhe koordinatori Edmond Imeri na thotë se mërgimtarët dibranë që i takojnë këtij grupi, dhe i cili nga dita në ditë rritet në numër, duan që ta ndihmojnë vendlindjen e tyre. Ai thotë se dëshira e mërgimtarëve dibranë në Amerikë është që fëmijët të mësojnë në kushte të mira, "meqë nga ditët e para të shkollimit fillojnë edhe njohurit e para arsimore". "Shumë shpejt, përveç sanimit të korridoreve, do të sigurohen mjetet me të cilët do të fillojë sanimi edhe i pjesëve të tjera të shkollës. Ne si mërgimtarë kemi ndihmuar dhe do të ndihmojmë vëllezërit tanë dibranë.



Pjesa dërmuese e mërgimtarëve që janë në këtë grup humanitar janë dibranë mërgimtarë të cilit janë të klasës së mesme. Deri tani kemi siguruar disa shtëpi

për familje të pastrehë. Vetëm gjatë këtyre muajve siguroam tre shtëpi për këtë kategori të familjeve sociale. Është një gjest i madh tu sigurosh kulm

mbi kokë atyre që ai kulm u mungon", thotë Imeri. Humanizimi është prezent tek çdo dibranë, shton më tej ai, ndërsa shprehet se aktivitetet humanitare do të rriten dhe grupi tenton që të rris edhe numrin e humanistëve mes mërgimtarëve. Bekim Paçuku, po ashtu aktivisti i denjë i këtij grupi, thekson se ndihmat për Dibër nuk do të ndalen kurë. "Pas sigurimit të shtëpive për të pastrehët, tani sanohet objekti i shkollës. Është mëkat që fëmijët të shkollohen në këto kushte, të cilët nuk i plotësojnë asnjë standard themelor. Investimet duhet t'i bëjë Ministria, po ja që ajo nuk ndodhë. Kjo është diskriminim dhe prandaj ne si humanistë nga mërgimi ndajmë mjete për të sanuar shkollën", thotë Paçuku dhe shton se interesimi për ndihmë nga mërgimtarët është në nivel të lartë. Paçuku ka ftuar që grupit t'i bashkangjiten edhe mërgimtarët dibranë të Evropës, ndërsa shpreson

se së shpejti - në këtë shkollë do të bëhen investime edhe më të mëdha. Koordinatori i aktivitetëve në Dibër, Skënder Kërçishta, deklaroi se falë mërgimtarëve nga Amerika, deri tani janë bërë shumë vepra humanitare. "Ne në Dibër mirëpresim këto aktivitete dhe si koordinator lokal, do të vazhdojmë të punojmë pa ndërprerë", siguron Kërçishta dhe shton se humanizmi i këtij grupi deri tani ka dhanë shumë efekte.

Drejtori i shkollës më të madhe në qytet, Ramadan Imeri, shprehet se nuk mund të gjej fjalë miradie për të falënderuar këtë grup humanitar, të cilët sanojnë korridoret e shkollës, si dhe rritin e ujësjellësit i dëmtuar tepër shumë. "Ne nuk mund ti sanojmë ngaqë mjetet mungojnë, por fal këtyre vëllezërve tanë, dhe kjo shkollë po fillon të marrë pamjen që duhet". Imeri shton se ky grup edhe viteve të kaluar ka kontribuar në sanimin e disa kasave dhe shpreson se edhe në të ardhmen, do të vazhdojnë të kontribuojnë në rregullimin e klasave të tjera që janë tejet të dëmtuara. Përndryshe, sipas koordinatorëve të këtij grupi humanitar, përveç sanimit të shkollës, do të vazhdojnë me aktivitetet për sigurimin të shtëpive për të pastrehët, por do të realizojnë edhe aktivitete të tjera humanitare.

Çairi shënoi 105 vjetorin e Çlirimit të Shkupit

Shkup, 13 gusht - Me vendosjen e kurorës me lule para përmendores së Hasan Prishtinës dhe vizitës së mozaikut në Kompleksin Memorial "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" për të reflektuar rreth së kaluarës sonë të lavdishme dhe ruajtjes së idealeve kombëtare brez pas brezi, pasardhësit e kryengritësve të shquar dhe historianë të vendit shënuan dje 105 vjetorin e çlirimit të Shkupit. Krenar me veprën e lavdishme të paraardhësve të tyre, Mehmet Prishtina - pasardhës i Hasan Prishtinës, Gazmend Boletini - pasardhës i Isa Boletinit dhe Sylë Zhitia - vëllai i Afrim Zhitisë shikonin sot mozaikun e vendosur në

Sheshin "Skënderbeu" të Shkupit në të cilin me mjeshtëri të veçantë estetike e artistike është përshkruar rrugëtimi ynë kombëtar ndër shekujt e historisë dhe kujtonin kontributin e familjarëve të tyre që sot Shkupi të frymojë shqip, thuhet në kumtesën e Komunës së Çairit. "E shënojmë çlirimin e Shkupit, për mua ka një barrë të veçantë, njëkohësisht po bëhet edhe inaugurimi i memorialit i cili përfshin në kronologji të gjitha periudhave historike duke filluar nga Lidhja e Lezhës, Lidhja e Prizrenit, 28 Nëntori deri te lufta e lavdishme e UÇK-së", ka thënë Mehmet Prishtina. Ata vlerësojnë lartë punën

kombëtare që Komuna e Çairit dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup po bëjnë në vazhdimësi për të ruajtur thesarin historik e kulturor që na bashkon shpirtërisht kudo që të ndodhemi. Këtë ngjarje me peshë të madhe në faqet e historisë e nderuan historiani dhe drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup Skender Asani i cili në detaje shpjegoi kuptimin e mozaikut të vendosur në Sheshin "Skënderbeu" dhe punën që me përkushtim po realizohet në Shkup për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe historiani Nebi Dervishi.

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopihtes

Tel: ++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopihtë, 1054 Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopihte.gov.mk

nr. 28-41/17 e datës 09.08.2017

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelës ndërtimore PK 1182/3, KK Sonje e Epërme, Komuna e Sopihtes, me qëllim A1 - shtëpi banesore, sipas Certifikatës nga Akti i Përgjithshëm.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelës ndërtimore PK 1182/3, KK Sonje e Epërme, Komuna e Sopihtes, me qëllim A1 - shtëpi banesore, sipas Certifikatës nga Akti i Përgjithshëm.

Përfshirja planore dokument për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelës ndërtimore PK 1182/3, KK Sonje e Epërme, Komuna e Sopihtes, me qëllim A1 - shtëpi banesore, sipas Certifikatës nga Akti i Përgjithshëm është me sipërfaqe prej 576 m².

1. Prezantimi dhe anketë publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopihtes më datë 16.08.2017 në ora 13.00.
2. Anketa publike do të zgjasë deri më 23.08.2017, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për Planifikim hapësiror dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopihte
Stefçe Trpkovski

Publicitet

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI

www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 23-1041/19
10.08.2017 vit
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) nga Ligji për planifikim hapësiror dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 и 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ë R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik të përfshirë në hapësirën e Propozim ndryshimit dhe plotësimit të PDU-së për Bllok 3, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e :

PREZENTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Rreth Propozim ndryshimit dhe plotësimit të PDU-së për Bllok 3, KK Gostivar 2- Komuna e Gostivarit për periudhën e planit 2016-2021, sipërfaqja e përfshirjes (22.578 Ha), që kufizohet në mes rrugëve:

- Nga ana veriore me rrugën " APJ " ,
- Nga ana jugore me rrugën e re të projektuar " 14 " ,
- Nga ana lindore me bul " Vëllezërit Gjinoski " dhe
- Nga ana perëndimore me rrugën e re të projektuar " 4 " ,

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. 16.08.2017 (e mërkurë) në ora 12.00.

Propozim ndryshimi dhe plotësimit i PDU-së për Bllok 3, KK Gostivar 2 - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 11 ditë pune edhe atë nga 17.08.2017 vit deri më 31.08.2017 vit. çdo ditë pune prej orës 08.00-16.00.

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridik dhe fizik nga zona konkrete të përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrajnë vërejtje me shkrim në fletat anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e - urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Nevzat Bejta



Mërgimtarëve të Pollogut nuk u ofrohen kushte për investime

Përfitojnë vetëm bizneset e vogla, investimet mungojnë

Ekspertët ekonomik dhe bizneset theksojnë se kthimi i mërgimtarëve ka një rol të madh dhe të drejtpërdrejtë në ekonominë e vogla. Sipas tyre, të ardhurat nga diaspora kryesisht shpenzohen për konsum familjar, dasma, ahengje të ndryshme dhe në ndërtim përjashtime të vogla

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 13 gusht - Sikurse çdo vit, Tetova me rrethinë në këto muajt e nxehtë të verës ka mirëpritur bashkatdhetarët e saj të cilët veprojnë dhe punojnë në shtetet e Evropës Perëndimore. Vet ardhja e tyre për të pushuar në vendlindje tregon se ata ende vazhdojnë të ruajnë traditën e kthimit të tyre në vendlindje, për pushime dhe festa të ndryshme. Ardhja e mërgimtarëve është ndihmesë shumë e madhe për ekonominë tetovare, janë bizneset e vogla, por edhe të mëdha Tetovare ato që më së shumti dhe më së miri e ndjejnë ardhjen e tyre në vendlindje me rritjen më të madhe të qarkullimit ekonomik dhe volumit të punës. "Vetëm gjatë verës rritet puna, apo të hyrat ditore dhe kjo falë ardhjes së mërgimtarëve tanë në vendlindje se përndryshe - kur nuk është sezoni i verës, puna jonë është shumë më e vogël apo sa për të mbijetuar. Por edhe kjo zgjat shumë pak kohë, sepse edhe mërgimtarët viteve të fundit nuk qëndrojnë më shumë se dy apo tre javë në vendlindje, sepse nuk u ofrohet asgjë dhe ata ikin shumë shpejt. Sa më pak që ata vijnë në vendlindje, aq më shumë kjo vërehet në punën tonë. Për dallim nga e kaluara, kur mërgimtarët shpenzonin më shumë para, tash pothuajse janë përgjysmuar të hyrat tona në krahasim me kohën e para dhjetë apo njëzet viteve kur lulëzonte çdo biznes në Tetovë", thotë Halil Halimi, pronar i një lokali në Tetovë. Ekspertët



SELAJDIR IDRIZI

“Mërgimtarët viteve të fundit bëjnë investime apo i harxhojnë mjetet e tyre vetëm në çështje familjare, ahengje, dasma e kështu me radhë, mirëpo për fat të keq - investimet në hapjen e ndonjë biznesi janë gjithnjë e më pak. Para 15 viteve, ato biznese që janë hapur nga mërgimtarët tanë në vendlindje akoma janë biznese të fuqishme. Gjenerata tjetër tashmë që ka kaluar një kohë të gjatë në Perëndim shumë pak është e interesuar për të bërë ndonjë investim më të madh këtu



ekonomik dhe të bizneseve theksojnë se kthimi i mërgimtarëve ka një rol të madh dhe të drejtpërdrejtë në ekonominë e vogla. Sipas tyre, të ardhurat nga diaspora kryesisht shpenzohen për konsum familjar, dasma, ahengje të ndryshme, në ndërtim me ndonjë përjashtim. Për shkak të neglizhencës së shtetit ndaj diasporës, këtyre investitorëve potencial institucionet nuk ju mundësojnë kushte të volitshme për biznes. "Mërgimtarët viteve të fundit bëjnë investime apo i harxhojnë mjetet e tyre vetëm në çështje familjare, ahengje, dasma e kështu me radhë, mirëpo për fat të keq - investimet në hapjen e ndonjë biznesi janë gjith-

një e më pak. Para 15 viteve, ato biznese që janë hapur nga mërgimtarët tanë në vendlindje akoma janë biznese të fuqishme. Gjenerata tjetër tashmë që ka kaluar një kohë të gjatë në Perëndim shumë pak është e interesuar për të bërë ndonjë investim më të madh këtu", thotë Selajdir Idrizi, menaxher në Agjencinë "Esa". Ai më tej thotë se në këtë aspekt, shteti nuk ka bërë asgjë për t'ju mundësuar atyre që të bëjnë investime në Maqedoni, konkretisht në Tetovë. "Në këtë drejtim do të kisha thënë se shteti nuk ka bërë asgjë që mërgimtarët tanë, kapitalin e fituar jashtë, ta investojnë këtu, duke u gjetur lokacione dhe

duke iu dhënë lehtësi më të mëdha gjatë hapjes së biznesit e kështu me radhë, por në këtë drejtim nuk është punuar asgjë", thekson Idrizi. Ndryshe, mërgimtarët që jetojnë përkohësisht në vendet e ndryshme perëndimore, mbeten shtylla kryesore e ekonomisë familjare në Pollog, ndërsa vendi i tyre i lindjes në kompensim ju ofron mundësi vetëm për të shpenzuar para dhe asgjë më shumë, pohojnë njohës të rrethanave ekonomike. Për dallim nga vitet e kaluara, sipas qytetarëve të Tetovës, këtë vit ka një numër më të madh të mërgimtarëve, të cilët kanë ardhur për të kaluar pushimet në vendlindje. Kjo vërehet nëpër rrugët e qytetit, të cilat janë të stërngarkuara me vetura luksoze dhe fluks të madh të njerëzve. Krahas kësaj, pothuajse në asnjë nga komunitet e Pollogut nuk ka organizuar ndonjë eveniment me mërgimtarët e interesuar që të informohen për kushtet e hapjes së biznesit apo për të bërë ndonjë investim më serioz që do të mundësonte hapjen e vendeve të reja të punës dhe kjo ka bërë që shumë të rinj tashmë kohëve të fundit gjithnjë e më shumë të largohen në drejtim të Evropës për të siguruar një jetë më të mirë.

Shiu e shpëtoi Kondovën nga flakët

Shkup, 13 gusht - Të reshurat e shiut, të cilët filluan mëngjesin e 13 gushtit, ndikuan që në tërësi të shuhet zjarri, i cili gjatë vikendit të kaluara e kaploi fshatin Kondovë të rrethinës së Shkupit. Informacionet për djegien e një pjesë të shtëpive të fshatit i kanë demantuar Qendra për Menaxhim me Kriza, ekipet e të cilëve së bashku me banorët vendas dhe shërbimet e zjarrfikësve kanë ndihmuar në lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve. Përhapja e shpejtë e zjarrit përreth malit me pisha që e rrethon fshatin e Kondovës, sipas banorëve vendas, në masë të madhe është ndikuar nga erërat e shpejta. Lidhur me këtë rast, me komunikatë



zyrtare janë prononcuar edhe nga Qyteti i Shkupit, të cilët së bashku me 40 zjarrfikës dhe një numër të konsiderueshëm të automjeteve kundër zjarrit, bashkërisht me nëpunësit e

Ndërmarrjes Publike "Higjiena Komunale", gjatë gjithë natës së kaluar kanë qëndruar në fshatin Kondovë. Krahas fshatit Kondovë, në të gjithë territorin e Maqedonisë ekzis-

tojnë rreth 13 zjarre aktive, duke filluar nga Tetovë e Gostivari e gjithandëj nëpër Kërçovë, Prilep, Manastir e kështu me radhë. Flaket e zjarreve vazhdojnë të përhapen, përkundër ndalesave dhe apeleve të autoriteteve se prezenca nëpër pyjet dhe male do të sanksionohet nga 1 mijë deri në 2 mijë euro. Ndryshe, kjo sezon e zjarreve në vendin tonë është vlerësuar si më e kritike, nga vetë fakti se brenda një ditë janë regjistruar mbi 20 zjarre në lokacione të ndryshme të shtetit. Për këtë arsye në ndihmë të zjarrfikësve të Maqedonisë, gjatë periudhës së shkuar kanë ardhur edhe ekipet të zjarrfikësve nga Bullgaria dhe Turqia.

Kronikë

Vdes në rrugë 60 vjeçarja nga Tetova

Të premtën në orët e vona të pasdites Reparti i sëmundjeve interne pranë Spitalit Klinik të Tetovës, ka lajmëruar Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë se në këtë repart është sjellë pa shenja jete 60 vjeçarja me iniciale C.K nga Tetova. Pas kontrolleve dhe ekspertizës së kryer është vërtetuar se tanimë e ndjera duke lëvizur në këmbë në rrugën "Gjorçe Petrov" në një moment i është përkeqësuar gjendja shëndetësore dhe për pasojë ka rënë në trotuar. Nga ana e kalimtarëve të rastit fillimisht i është ofruar ndihmë, por e njëjta fatkeqësisht nuk ka dhënë shenja jete. Hetime në vendngjarje ka kryer prokurori publik, dhe një ekip nga sektori për punë të brendshme në Tetovë. Me urdhër të prokurorit publik trupi i të ndjerës është dorëzuar për obduksion.

Rrahje e përgjakshme në Tetovë

Natën mes të shtunës dhe të dielës në rrugën Prohor Pçinski ka ndodhur një rrahje mes personave F.B 26 vjeçar dhe një 14 vjeçari, që të dy nga Tetova nga njëra anë kurse në anën tjetër kanë qenë dy vëllezër edhe atë S.I 22 vjeçar dhe E.I 28 vjeçar po ashtu nga Tetova. Ata kanë shkëmbyer grushta ndërsa janë përdorur edhe shkopinj prej druri. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të gjithë pjesëmarrësit kanë marrë lëndime ndërsa vetëm 22 vjeçari E.I është mbajtur në Spital për shkak të lëndimeve më serioze. I njëjti sipas mjekëve është jashtë rrezikut për jetë. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe punohet për zbardhjen e plotë të rastit. Policia ka ftuar për bisedë të gjithë pjesëmarrës dhe më pas do të ketë edhe padi adekuate.

Aksident në rrugën Gostivar- Kërçovë

Të shtunën në mbrëmje në rrugën Gostivar-Kërçovë ka ndodhur një aksident trafiku në mes të veturës Shkoda Oktavia me targa të Shkupit e drejtuar nga S.S 35 vjeçar nga Shkupi dhe një motoçikletë Kawasaki pa targa e drejtuar nga V.Z 31 vjeçar nga Zhelina. Në aksident motoçiklisti ka marrë lëndime dhe është dërguar në Spitalin e Gostivarit ku I janë konstatuar lëndime trupore dhe më pas është lëshuar për mjekim shtëpiak. Është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.



Kerim LITA

Në pjesën e dytë të viteve pesëdhjeta të shekullit të kaluar nga ana e disa intelektualëve shqiptarë u kërkua që shqiptarët kudo që jetonin të kenë një gjuhë të përbashkët letrare. Së shpejti ky problem u shtrua edhe në organet e atëhershme partiake e shtetërore të RFPJ-së në përgjithësi e ato të Kosovës e Maqedonisë në veçanti. Këta të fundit ishin më të interesuar që ky problem të gjej zgjidhje sa më parë, për arsye se mbi 95% të trevave shqiptare në RFPJ-ë shtriheshin pikërisht në këto dy zona. Autoritetet e atëhershme kosovare e maqedonase kishin arritur marrëveshje për botime të përbashkëta të librave shkollorë në gjuhën shqipe si për ato të shkollave fillore tetëvjeçare, po ashtu edhe për shkollat e mesme, përkatësisht për gjimnazet dhe për shkollat normale. Gjatë këtij bashkëpunimi, në pah dolën dallimet midis dy palëve, në atë se në cilin dialekt duhet të botohen librat, në atë gegë, që praktikohet thajse në mbarë hapësirën shqiptare në RFPJ-ë, në përjashtim të disa fshatrave të Strugës, zonën e Prespës e të Manastirit, apo atë toskë, i cili tashmë regjimi diktatorial i Enver Hoxhës e kishte shpallur si gjuhë letrare në mbarë hapësirën e shtetit shqiptar. Në informatën që Komisioni për pakica nacionale të LSPPM-së (Lidhja Socialiste e Popullit Punues të Maqedonisë), ia dërgoi në shtator të vitit 1955, Komisionit amë të LSPPJ-ë në Beograd, lidhur me botimet e përbashkëta të librave shkollorë në gjuhën shqipe me Kosovën, ndër probleme tjera vihej në dukje edhe problemi i gjuhës. Në të ndër të tjerave shtrohej pyetja: "...a thua mësimin të ne duhet përpiluar në dialektin e kuptueshëm gegë, a thua pakica këtë dialekt duhet ta formoj e ndërtoj si gjuhë të veten letrare kombëtare, pa marrë parasysh atë se dialekti toskë në Shqipëri po formohet dhe konsiderohet si gjuhë letrare e kombit?". Gjithsesi, thuhej në vazhdim të dokumentit se si i tillë, në radhë të parë ky është problem i vetë kombit shqiptar, çështje për të cilën vetë shqiptarët janë kompetent, për ta zgjidhur gjuhën e tyre letrare, mirëpo sipas tyre çështja nuk qëndronte në atë se "përmes ndonjë qëndrimi nga anash, shqiptarëve në RFPJ-ë t'ua përcaktojnë se cilin dialekt ata do ta mbështesin etj.", por të "deklarohen në mënyrë parimore ndaj këtij problemi, që komunistët tanë të mos vijnë në pozita anti-historike, e me këtë edhe anti-nacionale në këndvështri-

Si e shihnin zgjidhjen e problemit të gjuhës letrare shqipe, Petro Janura, Murteza Peza dhe Krume Jakovski?



Autoritetet e atëhershme kosovare e maqedonase kishin arritur marrëveshje për botime të përbashkëta të librave shkollorë në gjuhën shqipe si për ato të shkollave fillore tetëvjeçare, po ashtu edhe për shkollat e mesme, përkatësisht për gjimnazet dhe për shkollat normale. Gjatë këtij bashkëpunimi, në pah dolën dallimet midis dy palëve, në atë se në cilin dialekt duhet të botohen librat, në atë gegë, që praktikohet thajse në mbarë hapësirën shqiptare në RFPJ-ë, në përjashtim të disa fshatrave të Strugës, zonën e Prespës e të Manastirit, apo atë toskë, i cili tashmë regjimi diktatorial i Enver Hoxhës e kishte shpallur si gjuhë letrare në mbarë hapësirën e shtetit shqiptar

min e zhvillimit natyror të gjuhës letrare shqipe...". Çështja e gjuhës letrare shqipe për shqiptarët në Kosovë dhe në Maqedoni, u shtrua sërish në vitin 1959. Këshilli Ekzekutiv i KQ i LKM-së, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 1959, pasi e shqyrtoi problemin e gjuhës letrare shqipe, solli konkluzionin me këtë përmbytje: "Çështja e gjuhës shqipe duhet të zgjidhet në mënyrë parimore. Këtu ka luhajtje midis gjuhës letrare shqiptare dhe gjuhës së Kosmetit. Kjo çështje do të duhet të shtrohet edhe para KQ të LKJ-së

dhe së bashku me shokët nga Kosmeti të zgjidhet. U shprehën mendime se nuk mund të shkohet në një gjuhë tjetër, përveçse gjuhës së shtetit amë". Paraprakisht, Komisioni për pakica nacionale të LSPPM-së, kishte angazhuar një grup ekspertësh, me detyrë të hulumtoj çështjen e gjuhës letrare për shqiptarët e RSF të Jugosllavisë. Komisioni në përbërje: Dr. Petro Janura, Murteza Peza dhe Krume Jakovski, pas një pune disamujore, Konferencës së LSPPM-së ia dorëzuan një studim shkencor prej 63 faqesh

me titull: "Problemi i gjuhës së vetme letrare të kombësisë shqiptare në Jugosllavi". Në pjesën e parë të studimit vihej në dukje përpjekja e kamotshme të kulturologëve shqiptarë, si: Pjetër Bogdani, Konstatin Kristoforidhi, Jeronim Deradës, vëllezërit Frashëri, Aleksandër Gjuvani etj., për "zgjidhjen e këtij problemi", mirëpo rrethanat "sociale, politike e kulturore" nuk kishin lejuar që ky problem të zgjidhet drejt "në interes të gjuhës dhe kulturës shqiptare". Në fund të studimit, bëjnë një përmbljedhje të shkurtër, përkatësisht


rezyme, të procesit të zhvillimit të gjuhës shqipe, duke propozuar që shqiptarët kudo që jetojnë të kenë një gjuhë të vetme letrare, e ajo sipas tyre duhej të ishte gjuha letrare që zbatohet në RP të Shqipërisë. Studimi bashkë me rezymenë gjenden në Arkivin e Maqedonisë, dhe për shkak të hapësirës, e pamë të arsyeshme që për lexuesit e gazetës shqiptare KOHA - Shkup, ta botojmë vetëm përmbljedhjen, përkatësisht rezymenë e studimit në fjalë.

*** "PROBLEMI I GJUHËS SË PËRBASHKËT LETRARE SHQIPE"

Zhvillimi kulturor e letrar si dhe zhvillimi i përgjithshëm të një populli si parakusht të domosdoshëm e kërkon edhe zhvillimin e gjuhës letrare i cili duhet të jetë i përbashkët për të gjithë ata të cilët shfrytëzohen me të. Që në kohët e hershme, punëtorëve kulturor të Shqipërisë u ka interesuar ky problem dhe kanë bërë disa hapa për zgjidhjen e saj. Mirëpo, rrethanat sociale, politike e kulturore nuk kanë lejuar që ky problem të zgjidhet drejt në interes të gjuhës e të kulturës shqiptare. Përpjekjet nga Pjetër Bogdani në vitin 1685, të Dhimitër Kamadres në vitet 1864-65

dhe të Konstatin Kristoforidhi deri në vitin 1882 (me përkthimet e tij në të dy dialektet kryesore të gjuhës shqipe) të Jeronim De Radës, të vëllezërve Frashëri dhe të Komisionit Letrar në Shkodër - janë kryer përpjekjet e para serioze të cilat mbështeten mbi bazën shkencore. Në vitin 1917 u paraqitën disa hipoteza edhe atë: të Aleksandër Gjuvanit, hipoteza shkodrane, hipoteza kosovare e tjerë.

Problemi i gjuhës së përbashkët letrare shqipe nuk u zgjodh në tërësi, për arsye se shkencëtarët gjuhësor, vazhdimisht janë angazhuar, në radhë të parë, ta zgjidhin çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe për të cilën janë paraqitur hipoteza të ndryshme të cilat historikisht dhe gjuhësisht ishin kontradiktore, për arsye se ky problem nuk shihej objektivist në dritën e realitetit historik, filologjik e lingvistik. Kjo u kushtëzua nga ajo se shqiptarët konsideroheshin për Pellazgë. Mirëpo, kjo hipotezë është në kundërtënie të plotë me faktin historik dhe si e tillë ra përgjithmonë. Më pas u paraqit hipoteza, se shqiptarët kanë prejardhje nga Ilirët. Me këtë hipotezë u dakorduan pjesa më e madhe e lingvistëve e historianëve, për arsye se mbështetet në shumë fakte historike e gojore. Nisur nga kjo del se gjuha shqipe është gjuhë e vërtetë pos-iliriane. Më vonë paraqitet edhe hipoteza se gjuha shqipe është gjuhë thrake me ndikim ilire, kështu që sot mbisundon hipoteza se gjuha shqipe përbën simbiozën iliro-thrake, që nënkupton gjuhë e cila buron nga kjo simbiozë dhe si e tillë është me prejardhje iliro-thrake. Konsiderojmë, se ky problem i prejardhjes së gjuhës shqipe u përmyll me atë kur u dëshmuar, përgjithmonë se gjuha shqipe i takon familjes më të madhe të gjuhëve indoevropiane. Përveç kësaj, zgjidhja e problemit të gjuhës së përbashkët letrare shqipe u pengua veçmas me atë, që kjo gjuhë, krahas dy dialekteve si kryesorët - gegërishtja dhe toskërishtja, ka edhe një sërë nëndialektesh dhe të folje e nënfolje të shumta lokale me partikularizma të shumta kështu që të gjitha së bashku e kushtëzuan vonesën e realizimit të gjuhës së përbashkët letrare për mbarë shqiptarët. Edhe pse struktura



e gjuhës shqipe nga arsyet e këtyre nëndialekteve e të folmeve lokale me patrikularizmat e tyre, si duket jo të gjithë shqiptarët mund ta kuptojnë, ajo është gjuhë shumë e unifikuar, dhe koloriti i cili rrjedh nga këto të folme dhe nga patrikularizmat e të njëjtave, nuk u pengojnë shqiptarëve për t'u kuptuar midis veti pa ndonjë vështirësi të madhe. Kjo aq më tepër se morfologjia, duke mos i marr parasysh disa përjashtime, përkufizohet dhe unifikohet gradualisht. Fakti se ekzistojnë dallime fonetike midis këtyre dialekteve e nëndialekteve, nuk paraqet pengesë e cila nuk do të mund të përballohet, për arsye se edhe këto dallime nuk janë të larguara diametralisht. Dallimi kryesor është në atë që gjatë shprehjes dikund përdoret e folmja hundore. Mirëpo, gjatë shkrimit edhe këto dallime po unifikohen. Për sa më sipër, nuk do të kishte pengesa të mëdha për ata persona të cilët kanë kaluar përmes shkollave tetëvjeçare, ndërsa kjo pengesë do të paraqitej te njerëzit e pa-shkolluar. Mirëpo, sërish nuk është e tillë që të mos mundën të kuptohen midis veti.

Faktori tjetër, i cili e ka ngadalësuar zhvillimin e gjuhës së përbashkët letrare janë, me keqardhje, mosmarrëveshjet dhe debatet midis intelektualëve e shkrimtarëve, të cilët janë përpjekur vazhdimisht që me fanatizëm të shkruajnë në dialektin e vendlindjes së tyre. Kështu u paraqitën vepra me të folmen lokale nga vendlindja e disa intelektualëve. Kjo krijimtari letrare shkakton dëm të madh ndaj vetë zhvillimit të gjuhës shqipe. Sa për regjistrim: disa shkrimtarë gegë nuk kanë shkruar në dialektin e pastër të gegërishtes, por kanë shkruar në nëndialektin e Shkodrës, Tiranës, Durrësit ose në atë të Elbasanit, Kosovës e të Dibrës. Për këtë arsye dialekti toskë është më i unifikuar, ndërsa ai gegë ka një sërë nënfolje e partikularizma.

Për vonesën e këtyre të zgjidhjes së problemit të gjuhës së përbashkët letrare ekzistojnë arsye objektive e subjektive. Konsiderojmë se arsyet objektive janë zvogëluar në prag të përfundimit të qeverisjes osmane kur filluan të hapen shkolla shqipe, mirëpo më shumë përbëjnë faktorë subjektiv të cilat gjenden në oportunitetin e shkrimtarëve dhe intelektualëve gegë të cilët janë mbyllur hermetikisht në dialektin dhe nëndialektet e tyre. Përkundër kësaj nuk mund të thuhet se nuk janë bërë përpjekje për realizimin e një gjuhe letrare të përbashkët nga ana e gegëve. Përpjekje të tilla pati te Luigj Gurakuqi, Migjeni etj., mirëpo ato përpjekje nuk ndihmuan për t'u formuluar një gjuhë e përbashkët letrare edhe pse shkrimtarët toskë kanë pranuar shumë forma të gegërishtes. Edhe pse tash më shkrimtarët



shqiptarë bënë përpjekje, megjithatë ata nuk mund të fajësohen, për arsye se faktori kryesor qëndronte në regjimet në Shqipëri të cilat nga interesat e tyre i zyrtarizonin kohë pas kohe njërin dialekt apo tjetrin duke mos e marrë për bazë intersejin e bazës. (Ky konkluzion më së shumti vlen për regjimin komunist e diktatorial të Enver Hoxhës, ku tash më është e qartë se ndikoi drejtpërdrejt që sot gjuha e unifikuar shqipe mbi 90% mbështete në dialektin toskë - Q. L.).

Ky problem pas çlirimit u bë më akute për t'u zgjidhur, në radhë të parë për fshatarët dhe punëtorët të cilët përmes kurseve të ndryshme aftësoheshin dhe zhvilloheshin gjithanshëm. Sot kur arsimi po zgjerohet me shkollim tetëvjeçar të detyrueshëm dhe kur punëtorëve u jepet mundësia të dëgjojnë ligjëratat nëpër fakultetet tona si kusht kryesor shtrihet çështja e unifikimit të gjuhës letrare shqipe edhe atë si problem themelor shoqëror.

Në Shqipëri, ky problem pas çlirimit filloi të studiohet - mësohet nga viti 1952 e këndej. Nga viti 1956 në përdorim u morr dialekti toskë për tërë territorin e Shqipërisë. Kjo rrodhi për arsye se dialekti toskë nuk ka shumë nëndialekte e që nuk pati dallime mes tyre. (E vërtetat është, se këtë dialekt e përdorte diktatori Enver Hoxha si dhe shumica e bashkëpunëtorëve të tij. -



Q. L.). Për sa më sipër dialekti toskë është më universal dhe është i përafërt me të dy dialektet kryesorë, për arsye se diftongi /ua/ përdoret në imperfektiv dhe në futurë, për shembull: punonja, do të punoj. Pastaj drejtshkrimi toskë është më universal se ai gegë. Prandaj gjuha shqipe sot shkruhet mbi bazën e drejtshkrimit të këtij dialekti. Ky drejtshkrim është pranuar edhe për drejtshkrim letrar në Jugosllavi për popullsinë shqiptare. Zgjidhja e kësaj për pranimin e këtij drejtshkrimi ndihmoi edhe në zgjidhjen e gjuhës letrare në Shqipëri. Ajo kontribuoi të mënjanohet

anarkia në gjuhën letrare e cila ekzistonte deri në kohë të fundit edhe në Shqipëri. Me mënjanimin e kësaj anarkie e të laramanisë drejtshkrimore, u shtrua problemi për unifikimin e gjuhës letrare, kështu që nuk ishte e vështirë zgjidhja e saj. Sot ata kanë gjuhë të përbashkët letrare e cila nuk është ajo e Naim Frashërit por ajo toske e F. Nolit me premisa të gegërishtes. Që do të thotë se është bërë një kompromis në shumë pika të përbashkëta, e sidomos në përdorimin e zanores "ë".

Një ndër kushtet për t'u pranuar dialekti toskë si letrare është në atë se

në këtë dialekt ka literaturë më të zhvilluar. Ky dialekt është përdorur nga shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë dhe nga pjesa më e madhe e shkrimtarëve nga Shqipëria. Pastaj, rilindja kulturore e letrare të këtij dialekti përfshinë hapësirë më të madhe nga territori i Shqipërisë (Mirëpo pjesa dërmuese e trevave shqiptare nën pushtimin e RSFJ-së e përdornin dialektin e gegërishtes, në përjashtim të katër fshatrave të zonës së Strugës (Ladorishtë, Frangovë, Kallishtë dhe Zagërçan), si dhe të vendbanimeve shqiptare të zonës së Prespës e të Manastirit, të cilët përdornin dialektin e toskërishtes - Q. L.). Gjithashtu edhe përpjekjet më serioze për hartimin e abetares së parë, kanë prejardhje nga ky dialekt. Përveç kësaj, duhet të kihet parasysh se, dialekti toskë është më figurativ se sa ai gegë dhe ka fjalor më të mirë nga fusha e bujqësisë dhe ekonomisë.

Te ne në Jugosllavi nuk është realizuar problemi i unifikimit të gjuhës. Kjo ka ardhë nga arsyet se pas çlirimit përnjëherë u zhvillua rilindja kulturore te ne në të gjitha zonat e edhe atë kryesisht në nëndialektin kosovar edhe atë për të gjitha zonat në RFPJ-ë ku jetojnë shqiptarët (QAKM-së, RPM dhe Republika Popullore e Malit të Zi).

Nëse i bëjmë një vështrim kësaj gjuhe do të shohim se ai nuk është i unifikuar në të gjitha zonat porse zhvillohet sipas dialekteve. Shqiptarët në Prizren kanë nëndialektin e tyre, gjithashtu edhe ata të Kosmetit: më tej nëndialekti kumanovarë, preshevarë dhe dibranë. Të gjitha këto nëndialekte bazohen te dialekti gegë. Vetëm zona e Prespës dhe e Manastirit me disa fshatra të Strugës, flasin vetëm në dialektin toskë.

Nga kjo shihet se ekzistojnë dallime të veçanta të gjuhës së shqiptarëve nga Kosmeti dhe të atyre nga RS e Maqedonisë. Gjithashtu duket se ekzistojnë dallime të mëdha midis këtyre dy dialekteve që të mund të zgjidhet problemi i gjuhës së përbashkët edhe për shqiptarët në RFPJ-ë ashtu siç


është zgjidhur në Shqipëri.

Ne propozojmë që edhe shqiptarët në Jugosllavi ta përdorin një gjuhë letrare të përbashkët - ai i cili përdoret në Shqipëri. Për një propozim të tillë kemi sqarime të shumta në analizë si dhe nga kjo shkëputje të asaj analize. Kryesisht për shkak asaj se në Shqipëri disa shkrimtarë gegë edhe pse shkruajnë në atë dialekt sërish 90% kanë premisa toskërishte ose thënë më saktësisht është gjuhë e përbashkët letrare e cila sot përdoret në Shqipëri.

Propozojmë që gjuha letrare në Shqipëri të vendoset edhe në territorin tonë, për arsye se thuajse të gjithë intelektualët tanë ose thënë më drejtë do të duhej ta njohin për arsye se janë shfrytëzuar me atë gjuhë. Në dialektin toskë janë publikuar në disa botime libra të ndryshme nga vlera artistike (për shembull veprat e Shekspir, Shilerit, Gorkit, Blashko Ibanez, Sterjo Spase etj.). gjithashtu edhe librat tona kanë materie të shkrimit nga anët e ndryshme të shkrimtarëve si për shembull: Edgar Allan Po, Omer Kajami, Servantes, Dikens, Llav Tollstoj, pastaj pjesë nga shkrimtarët shqiptarë të cilët mësohen në shkollat tona në Jugosllavi si: Muhamet Çami, Hasan Zuko Kamberi, Kristoforidhi, Gavril Dara, Pipi, De Rada, Serembe, Naim Frashëri, Çajupi, Asdreni, Ali Asllani, Fan Noli etj. Pra numri më i madh i veprave të shkrimtarëve të cilat vepra mësohen në shkollat tona janë të shkruara në dialektin toskë, përkatësisht në atë gjuhë letrare.

Nisur nga kjo intelektualët e ri shqiptarë në Jugosllavi jo vetëm se e njohin gjuhën toskërishte letrare, por ata janë të formuar si të tillë. Intelektualët me të mund shumë lehtë të shfrytëzohen në shkruarjen e veprave të tyre si shkrimtar, punëtor të arsimit nëpër shkolla, gazetarë nëpër gazeta, radio, zyre dhe atje ku është e domosdoshme.

Duke propozuar që gjuha letrare shqipe të futet edhe për shqiptarët në Jugosllavi, e kemi parasysh faktin se drejtshkrimi i cili sot përdoret në librat dhe shkollat shqiptare, si dhe në radio-emisionet bazohet në atë laramani që ekzistonte më herët. Nëse do të futet gjuha e përbashkët letrare do të ishte e një dobie shumë të madhe në radhë të parë për zhvillimin e vetë gjuhës, e pastaj për nxënësit sepse ai cili sot përdoret në shkollë nga ana e nxënësve dhe nga pjesë e madhe e punëtorëve të arsimit e intelektualëve, nuk është as letrare e as nëndialekti kosovar por nëndialekt me partikularizma lokale. Gjuha letrare nuk lejon të ketë lokalizma kur për to nuk ka nevojë. Është koha që të gjithë shqiptarët në Jugosllavi të shfrytëzohen me gjuhën letrare - pa laramani. Në këtë kuptim përbëhet edhe ky propozim".



Racional - iracional

Kreu koreano-verior i shtetit ka një strategji që e ndjek me këmbëngulje. Sinjalet kontradiktore nga Uashingtoni ai i interpreton si kërcënim. Kjo e vështirëson zgjidhjen e konfliktit edhe më shumë

Peter STURM

Për Kim Jong-un është shkruar shumë, me të drejtë rrallëherë është shkruar vërtetë diçka me dashamirësi për të. Por në situatën aktuale, që mund të shndërrohet në një krizë, një meritë mund t'ia vesh në dukje kreut koreano-verior të shtetit: Kim Jong-un po vepron jo pa arsye. Duket se ai ka një strategji. E këtë e ndjek me këmbëngulje të madhe, ngjashëm si edhe i ati Kim Jong-il dhe gjyshi i tij Kim Il-Sung. Por ndryshe nga dy të mëparshmit, me sa duket Kim Jong-un ndjen presion akut kohor. Kjo sigurisht ka të bëjë me ndryshimin e qeverisë në Uashington. Qeveria Trump ka deklaruar, se strategjia e Obamas "strategjia e durimit" në raport me Korenë e Veriut ka marrë fund.

Që qysh nga janari vazhdimisht vijnë sinjalet kontradiktore nga Uashingtoni, këtë Kim Jong-un me gjasë nuk e interpreton ashtu siç është në të vërtetë, pra si një tollovi në qeverisje. Ai mendon, se gjithçka që thuhet publikisht është e verifikuar deri në detajet më të vogla. Parë nga kjo perspektivë tollovia e palës tjetër i duket atij si kërcënuese, sepse një situatë e tillë (me gjasë qëllimisht) e turbullon kundërshtarit e mundshëm. Ndaj Kim Jong-un vëren një "hapësirë dobësie" për veten. Arsyeja më e rëndësishme për këtë është, që ai vetëm në aspektin propagandistik mund të matet në të njëjtin nivel me SHBA-në.

Në aspektin ushtarak kjo nuk qëndron. E këtë nuk e ndryshojnë as dy apo një sërë prova raketash atomike që ka ndërmarrë ai. Kim do që ta mbyllë teknikisht sa më shpejt të jetë e mundur programin e armëve atomike, sepse vetëm kështu e imagjinojnë ai veten të sigurt prej ndonjë sulmi.

Një pyetje tjetër është, nëse mund të zgjidhet konflikti vërtetë me këshillat e mira p.sh. të Kinës, që SHBA-ja duhet të nisë dialogun me Phenianin? Nëse ka një konstante në tridhjetë vjetët e jetës së Kim Jong-unit, atëherë kjo është, që mos i beso askujt nga bota e jashtme, madje as një cope letre. Ndaj ndonjëse teorikisht është e mundur marrëveshja me Korenë e Veriut, nuk është i mundur një çarmatim total bërthamor i gadishullit korean.

Por është pothuajse e pamundur, që të besosh, se Kim Jong-un do t'u përmbahej rregullave të një marrëveshjeje të tillë. Pra racionaliteti i udhëheqësit koreano-verior nuk arrin deri në këtë nivel.

(DW)

Qasja e re e Gjermanisë ndaj politikës së fuqive të mëdha ka evoluar në mënyrë të vazhdueshme dhe në përgjigje të ngjarjeve, në dukje të palidhura. Por edhe nëse Gjermania nuk po ndjek një master plan, pikat e forta të saj i kanë mundur që të shfrytëzojë fuqinë e vet ekonomike, të përdorë institucionet dhe buxhetet e BE si një shumëzues force, dhe të ndërtojë koalicione ndërkombëtare, në ndjekje të qëllimeve strategjike



Mark LEONARD

Javën e kaluar, Ministri i Jashtëm gjerman Sigmar Gabriel ndërpreu pushimet në Detin e Veriut për t'iu përgjigjur burgimit nga Turqia, të një aktivisti gjerman të të drejtave të njeriut. Gabrieli i paralajmëroi turistët gjermanë për rrezikun e vizitimit të Turqisë dhe i këshilloi kompanitë gjermane, të mendonin dy herë përpara se të investonin në një vend, ku angazhimi i autoriteteve për sundimin e ligjit është gjithnjë e më i dyshimtë. Kjo përbën një politikë të re gjermane ndaj Turqisë dhe rekonfirmon më tej statusin e Gjermanisë, si një fuqi e madhe ekonomike. Deklarata e Gabriel shkaktoi tronditje në qeverinë turke, sepse ajo kujtonte reagimin e Presidentit rus Vladimir Putin, pas rrëzimit të një avioni luftarak prej Turqisë, në vitin 2015. Sanksionet që Rusia imponoi i kushtuan ekonomisë tashmë në telashe të Turqisë rreth 15 miliardë dollarë, dhe në fund e detyruan Presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan që të kërkonte falje. Përgjigja agresive e Putinit nuk erdhi si be-fasi. Në të kundërt, vendimi i Gjermanisë për t'u përgjigjur në mënyrë të ngjashme, shënon një ndryshim të fortë, nga stili i saj diplomatik përgjithësisht më i zbutur. Diplomati gjerman në pension, Volker Stanzel më tha se veprimi më i fundit i Gabriel është në përputhje me personalitetin e tij dhe prirjen për llogaritje politike. Në pritje të zgjedhjeve parlamentare në Gjermani në shtator, Gabriel e di se Partia e tij Social Demokrate (SPD) nuk ka asgjë për të humbur duke iu kundërvënë Erdoganit, i cili ka armiqësuar gjermanët me personalitetin e tij autoritar, prirjet islamike dhe aludimet e shpenguar mbi Holokaustin.

Stanzel gjithashtu vë në dukje se Gabriel, i cili



Gjermania, fuqia e kuletës

ndikohet po aq nga mediat, sa edhe nga diplomatët e tjerë, dëshiron të krijojë një stil diplomacie të shekullit njëzet e një, më të hapur për publikun. Dhe, për shkak se posti i tij i mëparshëm qeveritar ishte në Ministrinë për Çështje Ekonomike dhe Energjetikë, është e natyrshe që ai do të përdorte presionin ekonomik, si një masë të parë. Megjithatë, pozicioni global në ndryshim i Gjermanisë i paraprin Gabrielit, i cili është një i ardhur rishtaz në ministrinë e jashtme. Gjatë krizës së euros, Gjermania përdori mjete ekonomike për qëllime ekonomike në Evropë. Por në politikë e saj ndaj Rusisë, Turqisë, Kinës dhe Shteteve të Bashkuara, Gjermania gjithnjë e më shumë po përdor forcën e saj ekonomike, për të çuar përpara qëllimet e saj të mëdha strategjike. Pasi Putini aneksoi Krimenë në mars të vitit 2014, përgjigja e Perëndimit nuk u udhëhoq nga SHBA, por nga Gjermania, e cila drejtoi diplomacinë ndaj Rusisë dhe Ukrainës, për të mos lejuar shkallëzimin e konfliktit. Gjermania më pas bindi pjesën tjetër të Bashkimit Evropian, që të binte dakord për sanksione të ashpra të paprecedenta kundër Rusisë, për të penguar agresionin e mëtejshëm.

Gjermania e ka mbajtur këtë front të bashkuar evropian për tre vjet, duke sfiduar të gjitha pritshmëritë. Dhe tani që skandalet e lidhura me Rusinë kanë pllakosur në administratën e Presidentit të SHBA, Donald Trump, evropianët po shohin gjithnjë e më shumë nga Gjermania, që ajo të vijojë udhëheqjen në këtë çështje. Gjermania gjithashtu negocoi një marrëveshje me Turqinë për të zvogëluar prurjen e refugjatëve nga Lindja e Mesme drejt Evropës, duke riformuluar praktikisht marrëdhëniet BE-Turqi. Në vend që të ruajë sajësën, që Turqia është ende një kandidat i besueshëm për pranimin në BE, Gjermania

ka krijuar një marrëdhënie më realiste strategjike dypalëshe. Evropa ende mund të punojë me Turqinë për të avancuar interesat e përbashkëta, por gjithashtu mund të shprehë kundërshtime, ndaj autoritarizmit në rritje të Erdoganit. Natyrisht, gatishmëria e kancelares gjermane Angela Merkel për t'u përballur me Trump-in, mund të jetë ndryshimi më i habitshëm i politikës së jashtme. Menjëherë pas takimit me Trump-in në samitin e G7 në Sicili këtë maj, ajo mbajti një fjalim ku i bëri thirrje Evropës "ta marrim fatin tonë në duart tona".

Qoftë edhe vetëm kjo, shënon një largim nga disa dekada diplomaci gjermane. Deri tani, ftohja në marrëdhëniet gjermano-amerikane ka qenë kryesisht retorike. Por Merkel po mbështet gjithashtu pozitën gjeopolitike të Gjermanisë, duke diversifikuar partneritetet e saj globale, veçanërisht me Kinën. Sipas Stanzel, i cili më parë ka shërbyer si ambasador i Gjermanisë në Pekin, "Merkeli nuk ka iluzione për Kinën, por e sheh atë si një partner për klimën, tregtinë dhe politikën e rendit". Qasja e re e Gjermanisë ndaj politikës së fuqive të mëdha ka evoluar në mënyrë të vazhdueshme dhe në përgjigje të ngjarjeve, në dukje të palidhura. Por edhe nëse Gjermania nuk po ndjek një master plan, pikat e forta të saj i kanë mundur që të shfrytëzojë fuqinë e vet ekonomike, të përdorë institucionet dhe buxhetet e BE si një shumëzues force, dhe të ndërtojë koalicione ndërkombëtare, në ndjekje të qëllimeve strategjike. Për më tepër, diplomacia në ndryshim e Gjermanisë përfaqëson një vazhdim të procesit të "normalizimit", që filloi me ribashkimin gjerman në vitin 1989, i shtrirë në debatet kryesore në lidhje me përdorimin e forcës ushtarake dhe rëndësinë e marrëdhënieve të Gjermanisë me SHBA, Rusinë

dhe fuqitë e tjera evropiane. E gjithë kjo sugjeron që Gjermania, më në fund mund të shpëtojë nga dy "komplekse", që e kanë kufizuar gjatë mendimin e saj strategjik. I pari është kompleksi i saj psikohistorik, i cili i detyron udhëheqësit gjermanë të përkulen prapa, për t'u dhënë të huajve siguri, në lidhje me synimet e tyre. Kjo shpjegon pse Gjermania ka këmbëngulur që "të kontribuojë, jo të udhëheqë" ose "të udhëheqë nga mesi", dhe tani përfaqon idenë e "udhëheqjes shërbyese".

Kompleksi i dytë ka të bëjë me qëndrimin ushtarak të vendit. Gjermania ende shpenzon një shifër modeste prej 1.2% të PBB-së së saj për mbrojtjen, dhe debatet e saj të brendshme rreth pushtetit kanë tendencë të nxiten nga shqetësimet rreth buxheteve ushtarake, vendosjeve të trupave dhe ndërhyrjeve të huaja. Në të njëjtën kohë, konsensusi brenda establishmentit gjerman të sigurisë, rreth përdorimit të forcës po ndryshon. Gjermania po ndërton lidhje ushtarake dypalëshe me vende, nga Norvegjia dhe Holanda, në Japoni.

Ajo gjithashtu ka filluar të marrë një rol më aktiv në teatrot e ndryshme të operacioneve, duke vendosur trupa në Afganistan dhe Mali dhe duke ofruar mbështetje për luftëtarët kurdë në Siri dhe Irak. Dhe ajo ka bërë një përpjekje, së bashku me Francën, për të krijuar një fond mbrojtjeje të Bashkimit Evropian. Këto janë të gjitha zhvillime të rëndësishme. Por ato nuk janë askund aq të rëndësishme, sa vendimi i Gjermanisë për të ngritur fuqinë e saj të madhe ekonomike, në skenën botërore. Përgjigja më e fundit e Gabriel për Turqinë është një hap në atë drejtim. Pse të dërgosh trupa jashtë vendit, kur mund të kesh një impakt më të madh, duke mbajtur në shtëpi turistë dhe kompani të klasit botëror?

HARIS FAKIÇ, SKAUT DHE DREJTOR SPORTIV I SKËNDERBEUT



“Ne me Shkumbinin njihemi prej kohës kur unë isha kadetë te Slloga, ndërsa ai afrua nga Dibra për tu shkolluar në Shkup, pasi është nga Dibra dhe në të njëjtën kohë ai u afrua te Slloga. Aty lindi shoqëria jonë, edhe pse realisht më pas kontaktet mes nesh ishin të rralla. Kur e kuptoi ai se unë po e braktis futbollin, më dha një ide që të fillojmë këtë biznes. Pra, ai ishte personi i cili më zgjati dorën dhe më dha një mundësi që të jem partneri i tij. Ashtu filloi gjithçka, pra unë të jem përzgjedhësi i futbollistëve (skaut) kurse ai është menaxher. Kështu filloi gjithçka dhe akoma vazhdojmë të jemi bashkë në këtë profesion”, pohon Fakiç

ndjenjë e mirë duke marr para-sysh se klubi nga Çairi ishte një klub i madh. Pastaj vit pas viti unë luajta për kadetët, dhe pas paraqitjeve të mirë kalova tek juniorët, ndërkohë që me 16 vite e gjysmë debutova për ekipin e parë.

KOHA: Më pas gjatë karrierës tënde ke luajtur edhe për klubet vendore si Cementarnica, Bregalnica, Metalurgu dhe Shkëndija, si dhe ato ndërkombëtare OFK Beograd dhe FC Popa nga Finlanda. Derisa, ke qenë edhe pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë deri 21-vjeç.

FAKIÇ: Siç thash për Slloga J. debutova me 16 vite e gjysmë, ndërsa bashkë me mua ka qenë edhe Gashi Ramadani. Kjo ishte një mrekulli për mua duke e ditur Slloga kihte një bagazh të madh me tituj të fituar dhe një gjeneratë e artë e e udhëhequr nga Nexhmedin Memedi, Nebi Mustafi, Ollxhaj Bajram, Argjend Beqiri, Esad Çollakoviç, vëllezërit Beganoviç. Këtu u pa se kam talent dhe parashikimet ishin se duhet të jem një futbollist i cili mund të arrijë të bën një karrierë të mirë në futboll. Nga Slloga u largova për të luajtur gati dy sezone në Azi në disa ekipe, për tu rikthyer më pas te Slloga për të luajtur në ekipin e parë. Gjatë kësaj kohe isha edhe pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë deri 21-vjeç duke bërë paraqitje të mira. Si rezultat i kësaj u transferova te skuadra e OFK Beograd, ku luajta për dy sezone, që më pas një edicion të shkurtër e kalova te skuadra ruse Rostov, ndërkohë që pas Rosisë u riktheva në Maqedoni, por te skuadra e Cementarnicës, e cila aso kohe ishte anëtare e elitës së futbollit vendor. Pas një sezoni të mirë të ky klub, u transferova në Finlandë te anëtari i divizionit të parë FC Popa që më pas përsëri u riktheva në Maqedoni, te Metalurgu. Këtu pësova një lëndim të rëndë që më detyroi të mendoj edhe ndërprerjen e karrierës i futbollist. Isha 25-26 vjeç, por pas një kohe vazhdova me stërvitje dhe klubi i fundit i cili shprehi interesim për mua ishte KF Shkëndija. Por, pasi kuptova se vërtetë nuk mundem të vazhdoj shkaku i lëndimit dhe përgatitjes jo të mirë fizike, vendosa të ndërprisë karrierën.

KOHA: Kur e përfundove karrierën si futbollist dhe a ishte vështirë të sjellësh një vendim të tillë?

FAKIÇ: Sigurisht se ka qenë rëndë që një futbollist pavarësisht se a është 26-vjeç apo 32-vjeç të largohet nga futboll. Mirëpo, unë isha i detyruar sepse lëndimi im ishte në një formë pak si të them më të rëndë dhe trajtimi për rikuperim të cilin e kisha unë, duhej të pa-uzojë një vit. Kisha lënduar muskujt e barkut, dhe ndezja ishte në një fazë shumë e lartë ku duhej të pushojë një vit pa e prekur topin. Duke marr para-sysh se karriera ime aso kohe nuk ishte në një drejtim të mirë dhe luajta për kushte shumë jo aq të mira në Maqedoni, vlerësova se më mirë është të merrem me diçka tjetër ose me futboll. Ky ishte momenti kur unë vendosa që me 26-vjeç si futbollist i Metalurgut të ndërprisë karrierën si futbollist.

KOHA: U largove nga fushat e gjelbra, por jo edhe nga futbollin. Vendose të ushtronit detyrën e menaxherit/skautit. Si erdhi deri te kjo dhe se vendoset për këtë profesion?

FAKIÇ: Për fatin tim të mirë,

Fati si futbollist ia ktheu shpinën, por jo edhe puna si skaut dhe drejtor sportiv

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 13 gusht – Edhe pse i ri, vetëm 35-vjeç Haris Fakiç është bërë një emër i njohur në botën e futbollit, sportin më të popullarizuar në botë. Nëse në karrierën e tij si futbollist nuk kishite fat për shkak të lëndimit, ai u tregua dhe po tregohet shumë i suksesshëm si skaut (përzgjedhja e futbollistëve të talentuar) ku bashkë me menaxherin më të suksesshëm ndoshta shqiptar pas Fali Ramadani, Shkumbin Qormemeti po bëjnë nam në shitjen e futbollistëve në klube të njohura evropiane në mesin e tyre edhe futbollist shqiptar. Derisa, si rezultat i punës së suksesshme, shkupjani Fakiç nga viti 2015 është emëruar si drejtor i skuadrës më të mirë shqiptare Skënderbeu, ku në debutimin e tij të parë arriti të

shpallet kampion dhe njëkohësisht të bëhen klubi i parë shqiptar, i cili ka luajtur në grupet e Liga Evropës. Përkundër këtyre sukseseve të mëdha, Fakiç është një djalë modest ku sukseset nuk e kanë ndryshuar shumë, ndërsa këtë e dëshmon edhe në intervistën për gazetën KOHA, ku nuk i fsheh ata të cilët i kanë ndihmuar në rrugëtimin e tij deri te një skaut i suksesshëm. Gjithashtu Fakiç flet edhe për karrierën si futbollist dhe arsyet për ndërprerjen e hershme të karrierës si futbollist

KOHA: Kur lindi pasioni yt për futbollin dhe kur e kuptove që e ardhmja do i përkiste këtij sporti?

FAKIÇ: Për dallim prej të tjerëve unë jam më ndryshe se futbollistët tjerë të cilët filluan të merren me futboll, pasi unë me

futboll jam marr më tepër në rrugë. Derisa, profesionalisht si pionier kam filluar në moshën 13-vjeçare, që normalisht është vonë për një talent, por unë isha i talentuar dhe kjo o vërtetua pastaj edhe me ecurinë e karrierës sime. Por, nuk ishte edhe gabim, pasi kisha fituar një pjekuri, pasi me 13-vjeç u fut direkt në konkurrencën te pionierët. Përsëris pra, pasioni për futbollin lindi në rrugë me shokët e lagjes, në turnirët në shkolla që mbaheshin dhe më pas me shokët e lagjes vendosëm të regjistrohemi te KF ‘Ballkan’, pasi aso kohe më tepër shokë kisha të nacionalitetit maqedonas dhe ata më rekomanduan të regjistrohemi te ky klub.

KOHA: Karrierën domethënë e fillove te KF ‘Ballkan’, por jo gjatë pasi u

shpërngulët te KF Slloga Jugomagnat tani FC Shkupi. A ju kujtohet kjo periudhë?

FAKIÇ: Hapat e parë i fillova te KF ‘Ballkan’, i cili aso kohe ishte konkurrent shumë i madh në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë i KF Slloga Jugomagnat – tani FC Shkupi. Fillova shumë mirë, më kujtohet se pas një kampionati të cilin e zhvillova, isha golashënuesi më i mirë. Pas kësaj kryetari i atëherëshëm i Sllogës (Shkupit) Rafet Muminoviç më kishte parë në një ndeshje të pionierëve pikërisht ndaj Sllogës ku unë shënova hat-trik. Pas kësaj babai im i ndërpre më tha se e ka kontaktuar kryetari Muminoviç dhe i ka thënë se djali yt duhet transferohet te Slloga (Shkupi) si dhe do t’ia plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme. Kjo edhe ndodhi unë kalova në radhët e Sllogës që për mu ishte një



• Me kryetarin e Skenderbeut - Ardian Takaj

në atë kohë më kontaktoi partneri im i sotëm Shkumbin Qormemeti, i cili jeton në Vjen, dhe më propozoi këtë rol, që unë të jem ndihmësi i tij, sepse ideja e tij ishte që të fillon këtë biznes por ishte në kërkim të një partneri, për të ndihmuar, pasi edhe ai sapo kishte filluar me këtë biznes. Ne me Shkumbinin njihemi prej kohës kur unë isha kadetë te Slloga, ndërsa ai afrua nga Dibra për tu shkolluar në Shkup, pasi është nga Dibra dhe në të njëjtën kohë ai u afrua te Slloga. Aty lindi shoqëria jonë, edhe pse realisht më pas kontaktet mes nesh ishin të rralla. Kur e kuptoi ai se unë po e braktis futbollin, më dha një ide që të fillojmë këtë biznes. Pra, ai ishte personi i cili më zgjati dorën dhe më dha një mundësi që të jem partneri i tij. Ashtu filloi gjithçka, pra unë të jem përzgjedhësi i futbollistëve (skaut) kurse ai është menaxher. Kështu filloi gjithçka dhe akoma vazhdojmë të jemi bashkë në këtë profesion.

KOHA: Cilat vende përfshijnë fushë-veprimtarinë tuaj?

FAKIÇ: Skautingu im për agjencinë tonë 'SSM Agency' me qendër në Shkup, punon në shumë vende, Evropë dhe Botë. Them botë sepse në funksionojmë edhe në shtetet si Rusi, Kazakistan, pastaj kemi lidhje të futemi edhe në tregun e Kinës. Gjithashtu kemi pasur edhe kontakte me SHBA për të qenë pjesë edhe të një transferimi në këtë shtet. Më tepër funksionojmë në Evropë në disa shtete si Zvicra, Belgjika, Austria, pastaj kemi futbollist edhe në shtetet ballkanike si Kroacia, Sllovenia, normalisht edhe Maqedoni, Kosovë e Shqipëri. Personalisht unë me



• Me Shkumbin Qormemetin

skautingu jam i përfshirë më shumë në Ballkan, duke marr parasysh edhe funksionin tim që e kam te skuadra e Skënderbeut nga Shqipëria si drejtor sportiv, prandaj jam pak sa i limituar sepse duhet të jem afër klubit.

KOHA: Sa lojtarë keni arritur të transferoni deri më tani?

FAKIÇ: Nuk janë pak, por përafërsisht meqenëse duhet të them një numër, shkon diku mes 40 dhe 60 futbollistët. Nuk mundem të jap numër të saktë, pasi në këtë biznes ka një transferim të cilin e bën komplet ti prej fillimit deri në fund, por ka edhe transferime 50-50, ku një tjetër agjent ka në pronë lojtarin, kurse ne e kemi shitur atë. Nga lojtarët që i kemi transferuar në klube të ndryshme do ti kisha veçuar, Bekim Balajn në Terek Grozni, njëjtë edhe Odise Roshin dhe Bernard Berishën, tre lojtar të agjencisë sonë, 50-50 jemi të përfshirë në transferimin e Bastos nga Angola, i cili nga Rostov e kemi shitur te Lacio, Azdren Llulaku në Astana, Taulant Seferi në Jang Bojs,

“ Është e vërtetë se Nirnbergu ka qenë i interesuar për shërbimet e mia. Atë kohë menaxheri i cili e transferoi Nderim Nexhipin në Herta Berlin, Fali Ramadani ishte menaxheri i cili e bëri lëvizjen time nga Slloga te OFK Beograd. Para se të shkoj në OFK Beograd, ai më tha se Nirnbergu është i interesuar për mua. Në fakt para se të iki te klubi serb, unë e dija se do të shkoj te Nirnbergu, por në momentet e fundit menaxheri Ramadani më tha se do të bëjmë një lëvizje tjetër dhe se do të shkoj në një sezon të luaj në OFK Beograd dhe më pas për një çmim më të madh do të shkoj te Nirnbergu ose në ndonjë ekip tjetër në Bundesligë. Mirëpo, për fatin tim të keq kjo nuk u realizua. Ndoshta do të kishte qenë më mirë të shkoja direkt në Gjermani, por kështu deshi fati dhe nuk doli ashtu siç e kishte paramenduar menaxheri Fali Ramadani

“ Pas lëndimit tentova të rikthehem duke u transferuar te KF Shkëndija, por duke parë se nuk mundesha të luaj me këtë problematike dhe duke dashur që të jem korrekt me drejtuesit e klubit nga Tetova, u thash se nuk jam i përgatitur fizikisht edhe pse ajo nuk ishte e evidente në pamje të jashtme, por unë e ndjeja se në vazhdimësi përsëri probleme të vjetra dhe kuptova se duhej të pushojë prapë. Kështu që vendosa të largohem nga Shkëndija pa luajtur asnjë ndeshje zyrtare

Dejan Sharac te Lacio dhe shumë të tjerë.

KOHA: Nga viti 2015 jeni drejtor sportiv i Skënderbeut nga Korça. A mund të na tregosh se si erdhi deri te kjo?

FAKIÇ: Kjo erdhi pasi një bashkëpunimi me Skënderbeun dhe presidentin Adrian Takaj. Para se të emërohem si drejtor sportiv, klubit Skënderbeu i ofruam disa lojtarë sepse e pamë se ky klub ka potencial për të arritur rezultate të larta. Ata aso kohe ishin katër vite kampion dhe pretendonin grupet e Liga Evropës dhe ky ishte objektivi kryesor i tyre. Duke parë punën tonë të cilin e bënim ne, Takaj më ofroi një bashkëpunim dhe rolin e drejtorit sportiv, pasi kishin nevojë për një menaxher me të madh dhe më cilësor për të arritur këtë qëllim. Pra të vazhdohet me titujt dhe njëkohësisht të kualifikohemi në grupet e Liga Evropës. Për fatin tonë të përbashkët pasi unë u emërova si drejtor sportiv, ne u shpallëm kampion dhe u futëm në grupet e Liga Evropës dhe filloi gjithçka mbarë për neve dhe



• Me familjen

bashkëpunimi ynë u tregua si një marrëveshje shumë produktive dhe deri në ditën e sotme, ne po funksionojmë me sukses dhe menaxhimi im po sjell rezultate pozitive.

KOHA: Dhe për dy vite në Korçë, sa je i kënaqur me punën tuaj?

FAKIÇ: Normalisht se jam shumë i kënaqur, në rend të parë nga klubi ku jam unë, nga respekti të cilin e kam në Shqipëri, opinionin sportdashës dhe presidenti Takaj, pastaj jam i kënaqur me punën të cilin po e arrij ta bëj të klubi. Besoj se edhe në klub janë të kënaqur nga puna ime. Kemi një bashkëpunim shumë cilësor, bashkëpunimi i cili u vërtetua si diçka që vlen. Në fakt kontrata ime përfundon këtë vit pas ndeshjeve evropiane dhe më pas do të ulemi për mundësinë e vazhdimit të bashkëpunimit tonë te Skënderbeu. Duke e ditur se po rrjedhin gjërat, mendoj se jemi pranë vazhdimit të bashkëpunimit, një dëshirë e imja por edhe e drejtuesve të klubit.

KOHA: Nuk ka dyshim se në Shqipëri vlerësoheni për punën që po e bëni te Skënderbeu. Si qëndrojnë punët në Maqedoni?

FAKIÇ: Të them të drejtën nuk e kam menduar këtë deri më tani sepse nuk e kam menduar se sa më respekton opinionin sportdashës në Maqedoni, pasi e di se sa më kanë respektuar para se të largohem nga atje. Nuk e kam e përjetuar një respekt të veçantë pa marr parasysh se kam luajtur në shumë klube dhe i njoh të gjithë që merren me futboll, por tani kanë ndryshuar gjërat dhe mendoj se opinionin e din se kemi bërë një punë të madhe në Shqipëri. Kam shumë miq në futboll dhe klube me të cilat bashkëpunojmë, sidomos me KF Rabotnički dhe kryetarin e saj Dragan Popovski. Ne kemi futbollist shqiptar që luajnë atje dhe kjo ka sjell sukses pasi ata rregullisht shesin lojtar dhe luajnë në Evropë.

KOHA: Jeni i njohur shumë edhe në Kosovë. Cili është opinionin juaj për futbollin kosovar dhe a ka talent në këtë shtet?

FAKIÇ: Skuadra jonë Skënderbeu pothuajse gjysma është e përbërë me lojtar nga Kosova. Çdoherë kam thënë se Kosova ka shumë talent, ndoshta më shumë prej gjithë shteteve në Ballkan. Ne kemi bashkëpunuar me lojtar kosovar, ndërsa në këto momente kemi shumë

lojtar të agjencisë tonë dhe një ditë edhe Kosovën si përfaqësuese e pret një e ardhme e mirë.

KOHA: Profesionin që e ushtron ka bërë që të njohësh shumë emra të njohur të futbollit. A mund të na tregosh disa nga emrat e njohur me të cilët keni bashkëpunim?

FAKIÇ: Me pjesën e shqiptarëve njihem me shumë emra të njohur si Besnik Hasi, Igli Taren, Lorik Canën pastaj edhe me drejtor të ndryshëm sportiv nga vene të ndryshme. Me Igli Taren është një histori tjetër. Ai është një person i cili na ka ndihmuar shumë në punën tonë dhe një drejtor sportiv shumë i suksesshëm në Serie A dhe te skuadra e Lacios. Ne jemi miq privat dhe na ka dhënë shumë këshilla në lidhje me profesionin tonë, një lidhje dhjetëvjeçare e cila sot e kësaj dite po zgjat.

KOHA: Duke marr parasysh se me përkatësi etnike je boshnjak, kemi pasur mundësi t'ju dëgjojmë dhe shohim nëpër emisione të ndryshme në Shqipëri dhe Maqedoni ku gjuhën shqipe e flisni shumë mirë?

FAKIÇ: Ju falënderit për këtë vlerësim. Për fatin tim të mirë unë jam lindur në një lagje ku shumica kanë qenë shqiptar dhe ku unë jam rritur me shqiptarë. Duke dëgjuar gjuhën në rend të parë, e kam njoftuar gjuhën nga afër, por nuk e kam folur, pasi për të kuptuar është diçka tjetër dhe të flasësh është diçka tjetër.

Në fillim ta kuptoj dhe kjo ishte pjesa më e rëndësishme për të ardhur deri te momenti që unë ta filloj edhe ta mësoj. Pastaj mund të them se 'fajtor' për të mësuar gjuhën shqipe për 40 për qind kanë qenë dy bashkëlojtarët e mi te Popa në Finlandë, Nuri Mustafi dhe Bilall Velian. Atje ishim bashkë në një banesë dhe ata flisnin me mua shqip dhe me kalimin e kohës e mësova më shumë. Pas kthimit nga Finlanda kam përvetësuar gjuhën duke fol me shokët e mi sidomos me Shkumbinin dhe në fund pjesën më të mirë ku e përvetësova gjuhën shqipe është shkruarja ime te Skënderbeu.

KOHA: Kush është në jetën private Haris Fakiç?

FAKIÇ: Në jetën private jam një person shumë i thjeshtë dhe natyral dhe një shok shumë i madh. Jam i martuar dhe kam dy djem, njëri 5 vjeç dhe tjetri 2 vjeç. Falënderoj Zotin për këtë dhuratë, pasi kjo pjesë ma ka ndryshuar jetën.

Nga Kuaresma te Kondogbia, vetëm njëri i ka shpëtuar mallkimit të numrit 7

Padyshim një nga pengjet më të mëdhenj të historisë së viteve të fundit të Interit: braziliani Kutinjo, aktualisht te Liverpooli, për të cilin Barcelona është gati të paguajë 100 milionë euro, ka qëndruar tek Inter për tre vite. Ai e ka mbajtur numrin 7 vetëm për një sezon, atë të fundit. Në Milano tregoi vetëm një pjesë të vogël të talentit të tij, por shpërthimi i vërtetë ka ardhur disa vite më pas, në Angli



Geoffrey Kondogbia është vetëm i fundit i një liste të gjatë lojtarësh që, pas largimit të Luis Figo, kanë mbajtur fanellën me numrin 7 të Inter duke mos dhënë atë që pritej. Në fakt, që nga lamtumira e ish-madrilenit, numri 7 ka qenë një mallkim i vërtetë. Këta janë të gjithë ata që e kanë mbajtur, nga Kuaresma te Kondogbia.

“El Trivela”

Rikardo Kuaresma ka qenë trashëgimtari i parë i fanellës me numrin 7 pas katër viteve të kaluara mbi shpatullat e Luis Figo. I mbërritur në Milano me shumë pritshmëri, ai ka realizuar vetëm 1 gol në 32 ndeshje me zikaltrit. I kërkuar me ngulm nga Hozze Murinjo, i ka kushtuar klubit milanez pothuajse 25 milionë euro. Do të mbahet mend vetëm për

goditjen e tij me të jashtmen “trivela”.

“Pazzo”

Pas viti zhgënjës të Kuaresma, numri 7 ka përfunduar mbi shpatullat e Pacinit. I transferuar në Milano në janarin e 2011-ës ka zbritur në fushë për herë të parë në ndeshjen Inter-Palermo, në të cilën ka qenë protagonist i përmbysjes zikaltër me dy gola dhe një penallti të fituar, që çoi e goli i fitores 3-2 të realizuar nga Eto'o. Sigurisht ka qenë njëri nga më të mirët e kësaj liste, me 16 gola në 50 ndeshje.

Pengu

Padyshim një nga pengjet më të mëdhenj të historisë së viteve të fundit të Interit: braziliani Kutinjo, aktualisht te Liv-

erpuoli, për të cilin Barcelona është gati të paguajë 100 milionë euro, ka qëndruar tek Inter për tre vite. Ai e ka mbajtur numrin 7 vetëm për një sezon, atë të fundit. Në Milano tregoi vetëm një pjesë të vogël të talentit të tij, por shpërthimi i vërtetë ka ardhur disa vite më pas, në Angli.

“El Galgo”

Pas largimit të braziliani, numri 7 i kaloi Ezekiel Skelotto, i marrë nga Atalanta në ditën e fundit të merkatos së dimrit të 2013-të. Pas vetëm tri javësh nga ndeshja e debutimi, argjentinas realizoi golin e barazimit 1-1 në derbin kundër Milan.

Një kujtim i paharrueshëm (i shoqëruar me një tatuazh), për të dhe për tifozët.

Benzema i ri

Ka qenë akoma më anonime eksperiencia e Ishak Belfodil me zikaltrit, i cili ka qëndruar në Milano vetëm një vit, duke realizuar vetëm një gol, në tetë ndeshje, në Kupën e Italisë kundër Trapanit. Algjeriani, i cili ka shkuar tek Inter bashkë me Ikardin dhe me etiketën “Benzema i ri”. Nuk ka dhënë atë që pritej, ndryshe nga kapiteni aktual i klubit milanez.

“Këngëtari”

I parafundit që ka veshur këtë fanellë ka qenë Pablo Daniel Osvaldo, që e mbajti për një vit të vetëm. Me zikaltrit koleksionoj në total 19 ndeshje dhe 7 gola, por arsyeja kryesore e lamtumirës së tij ka qenë shërbimi që pati me Mauro Ikardi në “Juventus Stadium”, me rastin e ndeshjes kundër Juventus. Nga ajo ditë ndodhen disa gjëra që çuan në prishjen e marrëdhënies me klubin dhe në prishjen e kontratës. Tani ka braktisur futbollin dhe këndon në një grup rrok.

Kondogbia

Kemi mbërritur te Kondogbia, mbajtësi aktual i numrit 7, por duket se do të jetë kështu vetëm për pak kohë: edhe mesfushori francez po bëhet protagonist i episodeve të pakënaqshëm, siç ka qenë mungesa e pajustificuar në stërvitjen e skuadrës, me trajnerin Luciano Spalletti që nuk e ka grumbulluar për miqësoren me Betis. Nga 2015, viti kur shkoi tek Inter, ka luajtur 50 ndeshje, duke dhuruar paraqitje zhgënjëse. Pas fërkimeve me De Boer dhe braktisjes së stërvitjeve, numri 7 është gati të ndërrojë pronar.

Shkurt

Çells në panik, largohet Hazard

Frikë për një largim të mundshëm të Eden Hazard. Te Chelsea i tremben një lamtumire të sulmuesit belg në këtë merkato. Në pamundësi për të firmosur me Kylian Mbatpe, i cili është pranë kalimit te PSZH, Reali i Madridit për të përforcuar sulmin po mendon pikërisht për Hazard i cili për tu transferuar tek “Los Blancos” është gati të largohet nga Blutë e Londrës.

Arda shumë pranë largimit nga Barcelona

Arda Turan është duke kaluar ditët e tij të fundit te Barcelona. Kjo është mënyra e vetme për të interpretuar përjashtimin e tij nga kontingjenti prej 18 futbollistësh të grumbulluar nga trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde, për “Klasiken” ndaj Real Madrid, e cila u luajt të dielën. Ndërkaq, Gallatasaraj po vazhdon të këmbëngulë për të rikthyer në Stamboll mesfushorin turk. Por klubi verdhekuq nuk kërkon të shpenzojë me shumë se 10 milionë euro për kartonin e Arda Turan. Vetë futbollisti po mendon seriozisht të lërë La Ligën dhe më konkretisht Barcelonën për të luajtur sërish në Super ligën e Turqisë me Gallatasarajin.

Shumë skuadra pas El Haddadit

Shumë skuadra interesohen për Munir El Haddadin por Barcelona ende nuk i po i gjen një destinacion sulmuesit të talentuar. 21-vjeçari nuk bën pjesë në planet e trajnerit Ernesto Valverde dhe pas luajtjes për një sezon në formë huazimi te Valencia do të largohet sërish nga Barca. Roma interesohet për Munir por ndërkohë ka edhe klube të tjera që lëvizin për të marrë shërbimet e sulmuesit siç janë, Lioni, Marseja, Ajaksi, Lille dhe Leganes.

Vieto në vend të Soldados

Villareali mendon për rikthimin e Luçiano Viettos i cili konsiderohet si alternativa ideale për të zëvendësuar Roberto Soldadon i cili u largua për të Fenerbahçes gjatë kësaj merkatoje. Nëndetësja e verdhë po ndjek me vëmendje edhe Lukas Perezin e Arsenalit megjithatë dëshira e parë e drejtuesve të Villarealit për sulmin është pikërisht Luçiano Vietto.

Milani nxiton për Kaliniçin

Kaliniç është gjithmonë e më pranë skuadrës AC Milan. Java do të jetë vendimtare për të ardhmen e futbollistit, me Milanin të gatshëm për të nxitur sulmin deciziv. Nga ana tjetër, Fiorentina përgatitet për të besuar te Simeone. Duhet theksuar kontaktet e vazhdueshme mes dy klubeve për të gjetur marrëveshjen definitive, që duhet të realizohet mbi 25 milionë euro. Kaliniç, nga ana e tij ka pezulluar tratativat me skuadrën e Everton në Premier Ligë, pikërisht sepse dëshiron vetëm Milan. Një ndjesi reciproke, me Milan që përgatitet ta veshë sulmuesin me ngjyrat kuqezi.

Llorente ende nuk ka vendosur të ardhmen

Fernando Llorente po rikuperohet nga dëmtimi ndërkohë që ende nuk ka vendosur për të ardhmen e tij. Sulmuesi spanjoll aktualisht është pjesë e Svansi në Premier Ligën angleze, por gjasat janë që ish bomber i Juventusit të largohet nga klubi uellsian. Megjithatë të Svansi as që e mendojnë largimin e Llorentes me trajnerin Paul Klement që deklaroi se shpreson shumë që sulmuesi ibërik të qëndrojë në skuadër.

Paulinjo zëvendësuesi i Neymarit

Barcelona deri tani nuk ka gjetur dot një pasues për Neymarin, por për mesfushën duket se është mbyllur marrëveshja e shumëpritur. Siç njofton “Daily Mail”, katalanasit do të blejnë brazilianin Paulinjo! Mesfushori aktualisht luan te Guangzhou Evergrande në Kinë dhe Barcelona ka më shumë se një muaj që negocion për të siguruar shërbimet e tij. Nënkampeonët e Spanjës do të paguajnë klauzolën e tij të largimit, 40 milionë euro, pas refuzimit që kanë marrë më parë për rreth 15 milionë euro më pak. Paulinjo do të ishte afrimi i tretë i verës në “Camp Nou” pas sulmuesit Gerard Deulofeu dhe mbrojtësit Nelson Semedo. Mediat spanjolle theksojnë se sot nuk bëhet fjalë që të kemi ndonjë zyrtarizim, por ndoshta në fillimin e javës tjetër.



Shënon Ramsej, vdes një person i njohur

Mallkimi i Aaron Ramsejt në rastet e golave të tij ka sjell një viktimitë të re. Lojtari mbrëmjen e kaluar arriti të shënojë një gol kundër Leicester Sitit në fitoren e Arsenalit, 4-3. Dhe si shpesh herë tjetër ku mesfushori ka arritur të shënojë, një njeri publik ka humbur jetën. Këtë herë fatmirësisht nuk ka prekur ndonjë të ri në moshë por ka shkuar tek më i vjetri. Bëhet fjalë për Israel Kristal, i cili ishte njeriu më i moshuar në botë por që sot nuk është



më. Ai vdiq në moshën 113-vjeçare. Kjo sigurisht nuk ka ndodhur si pasojë e golit të Ramsejt, por mesfushori



duhet të ndërgjegjësohet pak nga pasojat e golave të tij. Pasi sa herë që ai shënon njerëzit e famshëm “dridhen”.

Zinedin Zidan te Reali edhe tre vjet

Jam shumë i lumtur

Tek Reali i Madridit nuk është vetëm Isko që do të rinovojë kontratën pasi tashmë edhe rinovimi me tre vjet i teknikut Zinedin Zidan është zyrtar. Lajmin e konfirmoi vet trajneri Zidan në konferencën për shtyp përpara “El Clasicos” se parë të Super Kupës së Spanjës, e cila u zhvillua të dielën në mbrëmje. “Jam shumë i lumtur për besimin që më është dhënë, jam i lumtur edhe që kemi bërë një punë të mirë duke arritur objektivat tanë, të cilët mbeten të njëjtët edhe në këtë sezon. Do të luftojmë për të fituar çdo

titull, edhe pse gjithnjë ka ulje dhe ngritje, duhet ta shfrytëzojmë këtë për të vijuar sukseset tona. Gjithsesi, pavarësisht rinovimit tim për tre sezonet e ardhshme diçka është e sigurt, se unë dhe Reali nuk do të diskutojmë kurë”, deklaroi Zidan. Ndryshe, paga e trajnerit francez do të dyfishohet, nga 4,35 milionë në gati 8 milionë euro në vit. Por për këtë do të duhet të përmbushë objektivat e vendosur nga klubi, për realizimin e të cilave, ai dhe lojtarët do të marrin shpërblime të dyfishta. Klubi e vlerëson maksi-



malisht punën e Zidan. Ai ka fituar 6 tituj deri më tani, dy trofe të “Champions Leagues”, dy Super kupa te Evropës, një titull te La Ligas dhe trofeun në Botërorin për Klube. Sukseset këto të arritura në vetëm 20 muaj, ndërkohë francezi klasifikohet edhe si një nga katër trajnerët me më shumë trofe të fituar në historinë 115 vjeçare të klubit të Realit.



Natyra, ushqimi dhe mikpritja shqiptare janë mbresëlënëse

Jo vetëm zona bregdetare, por edhe pjesa tjetër e Shqipërisë është shumë e pëlqyer nga turistët e huaj. Transporti mbetet ende sfidë për turistët

Shqipëria mbetet një nga destinacionet e preferuara për turistët nga Gjermania. Të rinjtë nga Gjermania kanë nisur ta zgjedhin Shqipërinë për të kaluar pushimet verore e për të shijuar veçoritë që ofron ky vend. Shqipëria është një vend, ku pushuesit gjermanë gjejnë një larmi atraksionesh turistike, që dallojnë nga ato të vendeve të tjera evropiane. "Udhëtimi me minibusët nëpër ato rrugë gjarpëruese ishte për mua një përvojë mjaft e veçantë", thotë Moritz, student nga Këlni. Ai për DW veçoi, se është mjaft i kënaqur me pushimin e tij në Shqipëri dhe se nuk ka pasur ndonjë përvojë negative, pavarësisht se mjetet e transportit në Shqipëri ai e sheh si sfidë për pushuesit e huaj. Christin nga Eseni e ka vizituar Shqipërinë para 2 vitesh në muajin e shtator, kur fluksi i turistëve është më i vogël në krahasim me muajt e verës. Ajo për DW thotë: "Hera e parë me makinë në Tiranë ishte e vështirë, por ia dola mbanë të përshtatem edhe pse rregullat e trafikut nuk respektoheshin". Çështja e trafikut ka habitur edhe Michaelin nga Boni, i cili thotë: "Në Evropën Qendrore nuk kam parë ndonjëherë një ngarje të tillë të makinës në rrethrotullimet e trafikut si në Shqipëri. Në Tiranë vlenin rregulla të veçanta sa i përket kësaj".

ATRAKSIONET KULTURORE DHE SPORTIVE, NJË ARSYE MË TEPËR PËR TË VIZITUAR SHQIPËRINË

Pushuesit nga Evropa janë të mahnitur nga historia dhe kultura shqiptare. Kruja, Berati, Apollonia dhe muzeu kombëtar në Tiranë janë pika të preferuara turistike. Xiengong në intervistë për DW shpreh: "Unë do t'juja sugjeroja pushimin në Shqipëri të gjithë atyre që janë të interesuar për shumëllojshmëri kulturore si dhe për historinë evropiane". Prezenca e më tepër religjioneve që e karakterizon Shqipërinë u veçua si vlerë nga të intervistuarit. Tirana si kryeqytet është shumë tërheqëse për pushuesit gjermanë. Ata veçojnë, se në këtë qytet u ka rënë sy organizimi i festave e koncerteve dhe se si popull shqiptarët kanë karakter festiv. Christin më tej thekson se si lagje, përshlyje të veçantë i ka lënë Blloku në Tiranë me të gjitha pub-et si dhe të rinjtë që ka takuar përreth.

KUZHINA SHQIPTARE, E LEVERDISHME NË ÇMIM DHE E PAKRAHASUESHME NË SHIJE

Në Shqipëri, kohëve të fundit vërehen mjaft ndryshime pozitive sa i përket përgatitjes së ushqimit, gjë që e bën Shqipërinë një vend edhe më të pëlqyer për turistët e huaj. Sipas Bobb, i cili e ka vizituar Tiranën para dy vitesh, kuzhina shqiptare është në nivel të asaj italiane dhe spanjolle. Të gjithë të intervistuarit nga DW janë treguar mjaft të kënaqur sa i përket ushqimit në Shqipëri duke shprehur gjithashtu habinë për çmimet, që janë dukshëm më lirë se në shumë vende të tjera të Evropës. Ushqimet e detit mbeten më të preferuarat, ndër të tjera. Turistët gjermanë shprehën një admirim kundrejt mikpritjes shqiptare. Të gjithë theksojnë kujdesin që bëjnë shqiptarët për t'u ofruar një nivel të lartë komoditeti pushuesve. "Unë jam pozitivisht i habitur nga fakti që, në Shqipëri, edhe në lokalim më të vogël ofronin lidhje në internet, gjë që nuk e gjen as edhe këtu në Gjermani", thotë Bobb për DW.





Serbia nuk bëhet anëtare e NATO-s

Ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Aleksandar Vulin, i ka thënë ministrit të mbrojtjes së Rusisë, Sergei Shoigu, se pozicioni parimor i Serbisë është se edhe më tutje do të mbetet ushtarakisht neutrale, ka raportuar mbrëmë Televizioni shtetëror i Serbisë - RTS. Vulin, që gjendet në vizitë dyditëshe në Rusi, ka biseduar me kolegun rus për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe të industrisë ushtarake, në një bazë të armatës afër Moskës. "Derisa Vuçiq të jetë komandant suprem i ushtrisë dhe president i Republikës së Serbisë, e unë ministër i mbrojtjes, Serbia nuk do të jetë anëtare e NATO-s, e asnjë aleancë ushtarake, sikur që nuk do të imponojmë sanksione ndaj Federatës Ruse", tha Vulin. Më tutje, ai ka theksuar se aeroplanët luftarakë rusë të tipit MIG, arrijnë në Serbi sipas planit, deri në fund të këtij viti.

Të hënën (sot), për të katërtën herë radhazi pritet të mbahet vazhdimi i seancës konstitutive të Kuvendit, nga kryesuesi i seancës, deputeti Adem Mikullovc



Edhe një tentim i Kuvendit

Seancat e kaluara dështuan pasi që deputetët e koalicionit fitues të përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe NISMA për Kosovën, që njihet me shkurtësën PAN, nuk ishin të pranishëm në sallën e Kuvendit për të propozuar kandidatin për kreun e Kuvendit.

Përfaqësuesit e koalicionit PAN kanë paralajmëruar se nuk do të marrin pjesë as në seancën e radhës, pasi kanë kërkuar konsultime shtesë. Pal Lekaj, nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, thotë për Radion Evropë e Lirë, se kryesuesi i seancës konsultive deputeti Adem Mikullovc është duke bërë gabime, pasi që, siç shprehet ai, më shumë është duke e ndjekur politikën e Vetëvendosjes, sesa të unifikimit të spektrit politik. "Ne e kemi bërë të qartë se pa takime konsultive, pa takime të gjithë spektrit politik dhe grupeve parlamentare, nuk do të marrim pjesë në seancë", deklaroi Lekaj. Drejtuesit e partive politike që janë pjesë e këtij koalicioni, Kadri Veseli (PDK), Ramush Haradinaj (AAK), Fatmir Limaj (NISMA) kanë zhvilluar të shtunën një takim me Ukë Rugovën, vëllanë e deputetes Teuta Rugova.

Zyrtarët e partive politike thonë thënë për Radion Evropë e Lirë, se takimi është mbajtur për të thelluar vazhdimin e bashkëpunimit dhe, siç

thënë ata, është biseduar për formimin sa më shpejt të institucioneve të Kosovës. "Familja Rugova i ka kuptuar drejt dhe mirë proceset që po zhvillohen në Kosovë dhe në këtë drejtim, si familje emblematike, e ka dhënë gjithë kontributin për zhblokimin e situatës dhe në suaza të kësaj, janë edhe takimet e tilla", thekson Lekaj. I nominuar për kryeministër nga koalicioni PAN, Ramush Haradinaj, ka deklaruar në një intervistë për Radion Evropë e Lirë, se gjatë 10 ditëve të ardhshme pritet që të konstituohet Kuvendi i Kosovës dhe më pas të formohet edhe Qeveria e re e Kosovës. "Tani jemi në tendencë ose në përpjekje që ta rikthejmë seancën. Seanca rikthehet pas dakordimit të partive politike, por nuk mund të kthehet njëanshëm. Dhe, mendoj se duhet të shfrytëzohen konsultat për dakordim për seancë. Ka terren, pra 10 ditë nga sot, ka terren për mbajtjen e seancës, por nxitimi edhe thirrja e seancës njëanshëm nuk është zgjidhje", ka deklaruar Haradinaj. Nga ana tjetër, edhe i nominuar nga koalicioni PAN për kryetar të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se institucionet e Kosovës do të formohen shpejt. Veseli ka deklaruar të shtunën për mediet në Prizren se Kosova, brenda 10 ditëve, do t'i ketë institucionet e reja. Veseli ka pohuar se Kosova shpejt do të kthejë Kuvendin dhe Qeverinë e re dhe sipas

tij, i mandatarit për kryeministër nga koalicioni PAN, Ramush Haradinaj, është në fazën përfundimtare të konsultimeve me partitë politike. Nga ana tjetër, Shkodran Hoti, zyrtar për media në Lëvizjen Vetëvendosje thotë për Radion Evropë e Lirë se mospjesëmarrja e PAN-it në seancë, siç shprehet ai, "është përgënjeshtër i asaj që deklaroi në seancë për numrat dhe vërtetimin i asaj që e thoshim ne". "PAN-i po mundohet ta zvarritë konstituimin e Kuvendit, sepse nuk i ka numrat e mjaftueshëm, as për kryeparlamentar, e as për kryeministër.

Duke qenë në panik, ajo që po do PAN-i, është blerja e kohës me kërkesa për takime konsultive e blykime të seancës, dhe rrjedhimisht po shkaktojnë bllokadë institucionale", thotë Hoti. Kurse, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, aktualisht kryeministër në detyrë, në një postim të llogaritur në Facebook, shkruan se koalicioni i LDK-së nuk është duke e bllokuar krijimin e institucioneve, porse situatën po e mban peng koalicioni i PDK-së. "Të gjithë ata që kanë iluzione se me zhagitje të proceseve, para apo pas zgjedhjeve lokale, do të ndryshojnë qëndrimin e LDK-së, mashtrohen kot! Në asnjë rrethanë nuk bëjmë koalicion me PDK-në për qeverisje qendrore. Sa i përket Vetëvendosjes, do të

kërkojmë që t'i qartësojë qëndrimet për shumë akuza, sulme dhe veprime të dhunshme, por edhe çështjet programore. Në ditët në vijim do t'i adresojmë çështjet specifike", shkruan Mustafa. Koalicioni PAN po synon që t'i ketë 61 vota e më tepër, si për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, ashtu edhe për Qeverinë e re. Por, deri më tash ky koalicion nuk ka dështuar se ka numër të mjaftueshëm votash. Sipas Kushtetutës, "Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit". Në këtë rast, Partisë Demokratike të Kosovës i takon ta propozojë kandidatin për të parin e Kuvendit të Kosovës.

Kadri Veseli, i cili është kryetari PDK-së, për Lëvizjen Vetëvendosje është kandidat i papranueshëm dhe siç janë deklaruar përfaqësues nga ky subjekt, nuk do ta votojnë në asnjë rast. Pa zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, nuk do të mund të vazhdohet me asnjë procedurë tjetër rreth formimit të institucioneve. Në rast të zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit, më pas fillon faza prej 15 ditëve për formimin e Qeverisë. Në bazë të rezultativitetit të zgjedhjeve, kjo e drejtë i takon koalicionit PAN (PDK, AAK dhe Nisma) si fitues i zgjedhjeve. Për formimin e Qeverisë janë të nevojshme të paktën 61 vota të deputetëve.

Tri komunitet shqiptarë në Serbi prijnë me numër të papunëve

Tri komunitet e Luginës së Preshevës, mbesin me papunësinë më të lartë në Serbi. Thuajse të gjitha institucionet e nivelit lokal anashkalohen nga ato të niveleve rajonale dhe republikane, raporton televizioni publik. Në Entin për Punësim, thonë se në shumicën e rasteve as konkurset për vende të punës nuk i dërgohen fare këtij institucioni. Ndërkohë, në institucionet publike në tri komunitet shqiptarë, mund të hasësh në të punësuar që vijnë nga Vranja, Vladiçki Hanit, Surdulica, Leskoci e madje edhe nga Nishi e Kraleva. Shembuj të anashkalimit të shqiptarëve në vende të ndryshme punës ka shumë, e që vlerësohen si shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Përfaqësimi proporcional krahas numrit të përqindjes së përkatësisë nacionale nëpër të gjitha institucionet lokale, rajonale e republikane, ka qenë kërkesë e kamotshme e shqiptarëve.

Anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL mund të dështojë

Kjo është tentativa e dytë e Kosovës për të qenë pjesë mekanizimit më të madh policor, në tentativa të tjera Kosova ka arritur të krijoj bashkëpunime rajonale e ndërkombëtare me mekanizma të tjerë policor

Kosova do ketë një betejë të rëndë, por edhe të rëndësishme gjatë shtatorit në asamblenë e përgjithshme të mekanizimit më të madh

policor në botë INTERPOL. Aplikim i Kosovës së bashku me shtete si Ishujt Solomon dhe Palestina mund të rrezikojnë me dështim në anëtarësim. Sipas Kushtetutës së INTERPOLIT shtetet që aplikojnë për tu bërë anëtarë duhet të marrin -tat e votave e shteteve anëtare. Megjithatë, ekspertët paralajmërojnë se Kosova sërish mund të dështojë në përpjekjen e saj për anëtarësim gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme. Sipas Plator Avdiut nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) paralelisht me votimin për

Kosovën do të votohet edhe për anëtarësimin e Ishujve Solomon dhe Palestinës. Kjo, sipas tij, mund ta komplikojë këtë proces. Ai pret edhe pengesa nga Serbia, prandaj vlerëson se është i domosdoshëm një lobim i fuqishëm nga institucionet kosovare për të siguruar mbështetjen e nevojshme. Burim Ramadani nga Qendra Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC) nuk ka dilema rreth faktit se Policia e Kosovës i përm-bushë kushtet për anëtarësim. "Policia e Kosovës dhe institucionet tjera në aspektin profesional, ligjor dhe procedural i

plotësojnë në saktësi kërkesat bazike për anëtarësim në INTERPOL", thotë Ramadani. Pas shpalljes së pavarësisë së vendit drejtues të policisë e ata të MPB-së në vazhdimësi kanë përmendur anëtarësimin në INTERPOL si njërin nga sfidat më të mëdha të organeve të rendit. Bazuar në një marrëveshje të mëhershme komunikimi i policisë me INTERPOLIN kryhet duke shfrytëzuar kanale të misionit të UNMIK-ut ndër-sa procedurat e tejzgjaturra të këtij komunikimi kanë bërë që raste të mëdha të zvarriten. INTERPOL kërkon dhjetëra

persona nga Kosova në bazë të flet arresteve të Policisë së Kosovës megjithatë vendi ka dështuar të sjellë para drejtësisë një varg të dënuesish përfshirë ish kryetarin e Kaçanikut Xhabir Zharkun. Rreze Hoxha, nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike thotë se anëtarësimi i mundshëm i Kosovës do të avancojë edhe zbatimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut (sidomos të drejtës për jetë), luftimi i krimit do të bëhej në mënyrë më të efektshme, etj. "Anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL do të ndikonte direkt në uljen e shkeljes

së të drejtave të njeriut duke zvogëluar rastet e trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit të drogës, trafikimit të armëve dhe krimit të organizuar. Krime këto të cilat ndikojnë në shkeljen e të drejtave themelore të njeriut dhe në zhvillimin e jetës së qytetarëve të Kosovës dhe të rajonit", tha Hoxha për KALLXO.com. Kjo është tentativa e dytë e Kosovës për të qenë pjesë mekanizimit më të madh policor, në tentativa të tjera Kosova ka arritur të krijoj bashkëpunime rajonale e ndërkombëtare me mekanizma të tjerë policor.



Kina paralajmëron SHBA-në në konfliktin me Korenë e Veriut



Presidenti kinez, Xi ka kërkuar në një telefonatë me presidentin amerikan, Trump ulje të toneve në grindjen atomike me Korenë e Veriut. Ndërsa kancelarja Merkel nuk sheh zgjidhje të konfliktit me mjete ushtarake

Donald Trump duhet të mënjanohet "fjalët dhe veprat", që çojnë në një gjendje të tensionuar, paralajmëroi presidenti kinez, Xi Jinping presidentin amerikan. Sipas të dhënave të televizionit kinez, Xi nuk i bëri thirrje vetëm SHBA-së për vetëpërmbytje, por të gjitha palëve që të "ushtrojnë vetëpërmbytje" dhe të "vazhdojnë rrugën e dialogut dhe të një zgjidhjeje politike". Gjithashtu presidenti kinez ka theksuar, se është në interesin e përbashkët të Kinës dhe SHBA-së çarmatimi

atomik i Gadishullit Korean dhe sigurimi i paqes dhe stabilitetit në rajon. Së fundmi SHBA dhe Koreja e Veriut kanë ashpërsuar tonet. Donald Trump kërcënoi këtë javë Korenë e Veriut se SHBA do të reagojnë me "zjarr, zemërim" ndaj provokimeve të tjera. Ndërsa të premtën nga Pheniani u tha se SHBA duhet të llogarisin me "një dështim të turpshëm", nëse do të këmbëngulin ende "me aventurën ekstreme ushtarake" si edhe rrugën e sanksioneve dhe presionit. Trump është shprehur se Kim do të "pendohej" nëse do të sulmonte SHBA-në. "Shpresoj, që ata ta kuptojnë

këtë që them në tërësinë e saj, bashkë me pasojat. Dhe këtë që them e mendoj kështu." Por fjalëve të ashpra nuk u përgjigjen hapa konkretë. Sipas raportimeve të mediave nuk ka shenja për një lëvizje të trupave amerikane, aeroplanmbajtëseve apo avionëve luftarakë. Nuk ka po ashtu asnjë shenjë, se 150.000 ushtarët amerikanë të stacionuar në Korenë e Jugut po strehohen në vende të sigurta. Shtëpia e Bardhë bëri vetëm të ditur, se njësitë luftarake amerikane janë të "gatshme" të mbrojnë Guamin. Në të njëjtën kohë Japonia po përgatitet ndaj një sulmi të Ko-

resë së Veriut. Një sistem mbrojtës raketor, sipas raportimit të televizionit NHK po instalohet ndërkohë në disa qytete në perëndim të vendit. Në pamjet televizive shihen automjete të ushtrisë me pajisjet përkatëse. Ndërkohë politikanë nga e gjithë bota i kanë bërë thirrje për përmbytje SHBA-së. Kancelarja gjermane, Angela Merkel bëri thirrje që të përforcohen përpjekjet në kuadër të Këshillit të Sigurimit për një zgjidhje paqësore të konfliktit dhe përmes bashkëpunimit me Kinën. Merkel nuk e sheh zgjidhjen e këtij konflikti tek mjetet ushtarake.

KOREJA VERIORE BËN GATI 3.5 MILIONË VULLNETARË PËR USHTRI

Koreja Veriore ka bërë të ditur se pothuajse 3.5 milionë punëtorë, anëtarë të partisë dhe rezervistë në mënyrë vullnetare janë paraqitur t'i bashkëngjiten ushtrisë në luftë kundër SHBA-ve. Siç thuhet, ata janë paraqitur në mënyrë që t'i bëjnë rezistencë sanksioneve të reja të Kombeve të Bashkuara. Gazeta zyrtare verikoreane "Rodong Sinmun" shkruan se vullnetarët janë paraqitur pasi që agjencia e lajmeve KCNA të hënën dha kumtesën në të cilën dënohen sanksionet e reja të OKB-së si përgjigje ndaj testeve raketore të Pjong-jangut.



Burgoset pasi refuzon ta kryejë shërbimin ushtarak

"Kur isha e vogël, ëndërroja që kur të rritem të bëhem pilote ushtarake e IDF", thotë 19 vjeçarja, Noa Gur Golan. Sido që të jetë, ajo tash është e burgosur në Burgun Ushtarak 396 pranë Haifa. Ajo trajtohet si tradhtarë dhe qyqare, për shkak që refuzoi që ta kryente shërbimin ushtarak në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Izraelit - aty ku dikur kishte ëndërruar, shkruan Independent. Noa nuk lejohet të pranojë telefonata ndërkombëtare. Ndërsa në Izrael ka shumë të ri e të reja që e kryejnë këtë shërbim dhe që ndjehen të lumtur për këtë. Sa i përket qëndrimit në burg nuk dihet se deri kur mund të qëndrojë ajo aty e mbyllur.



Polemika për Kodin e veshjes së "Saudi Arabian Airlines"

Kompania e fluturimeve në Arabinë Saudite ka hapur polemika pasi publikoi kodin e saj të veshjes që u kërkon femrave që të mos ekspozojnë krahët dhe këmbët. Veshjet që nuk lejohen në "Arabian Airlines" janë ato që "mund të shkaktojnë parahati te pasagjerët e tjerë", ku përfshihen veshjet e ngushta. Përsa i përket meshkujve, nuk pranohen pantallonat e shkurtra në avion. Kjo kompani fluturimi ndalon gjithashtu edhe transportimin dhe konsumimin e alkoolit, si dhe zbrit nga avioni ata pasagjerë që mbajnë erë të keqe, që nuk vjen si pasojë e ndonjë sëmundjeje apo handikapi.

Merkel nis garën e radhës

Angela Merkel filloi zyrtarisht fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 24 shtatorit, e ftuar në bastionin socialdemokratëve Dortmund. Ky ishte takimi i parë elektorale i kancelares. 50 të tilla janë planifikuar

Edhe gjashtë javë e gjermanët votojnë për parlamentin e ri. Ka ardhur koha që edhe kryetarja e partisë kristiandemokrate CDU - kancelarja e Gjermanisë të fillojë zyrtarisht fushatën zgjedhore. Për të startuar fushatën, ajo zgjodhi pikërisht hollin e Vestfalenit në Dortmund, që njihet si bastion i so-

cialdemokratëve. 800 vetë kishin ardhur për të dëgjuar kancelaren që lëvdoi sukseset e partisë së saj - luftimin e papunësisë, përgjysmimin e numrit të njerëzve pa punë dhe bëri të ditur planin e punësimit të plotë deri në vitin 2025. Ky premtim gjendet edhe në programin e unionit. 50 takime elek-



torale tilla janë planifikuar. Merkel nuk harroi të prekte edhe skandalin e dizelit. "Pjesë të caktuara të industrisë së automobilëve kanë humbur shumë nga besimi i dhënë", tha kryetarja e

CDU-së. Merkel kërkoi më shumë angazhim për zhvillimin e teknologjive të reja. Por ajo nuk e pranoi propozimin e socialdemokratëve për të futur një kuotë të automjeteve elektrikë, duke theksuar se nuk beson se ky propozim është i mirë-menduar. Merkel i bëri thirrje kristian-demokratëve të bëjnë një fushatë zgjedhore aktive. "Ne duhet t'i bëjmë njerëzit për vete, duhet të luftojmë, duhet të angazhohemi për çështjet tona. Ajo foli për një "ndjesi të veçantë të momentit aktual." Nga njëra anë Gjer-

mania i ka punët mirë, nga ana tjetër shumë njerëz ndjejnë pasiguri. Ndërkohë socialdemokratët kanë ashpërsuar tonet kundrejt kancelares. "Koha e ruajtjes së kancelares ka marrë fund", tha kreu i grupit parlamentar socialdemokrat, Thomas Opperman. Ai kritikoi, se prej vitesh Merkel gëzon sukseset e reformave ekonomike të iniciuara nga kancelari Schröder. Por megjithë sulmet e socialdemokratëve, partitë e Unionit kryesojnë dukshëm sondazhet para socialdemokratëve. (DW)



Kryelartë, por në të njëjtën kohë i rezervuar, ambicioz dhe në të njëjtën kohë një diplomat shumë i zoti, Sulejmani e udhëhoqi perandorinë otomane në majën e madhështisë së saj, duke e bërë Evropën të dridhet përballë ushtrive të tij...

Rosa MARIA QUADRI

Princ dhe Zot i Konstelacionit të Lumtur, Cezar i Madhërishtëm, Vula e Fitores, Hija e të Gjithëpushetshmit: për t'u bërë të gjithë këto, Sulejmani (1494-1566), në 30 shtator të vitit 1520 hipi mbi një varkë me rema të quajtur gulet dhe u ul rëndë mes jastëkëve të kadifenjtë, strofrave të mëndafshhtë dhe disa eunukëve të bardhë që rrinin në këmbë përpara tij. Në moshën 17 vjeç ishte Guvernorator i një province të madhe dhe në moshën 26 vjeç, kur vdiq i ati, Selimi I, Sulejmani u bë Sulltan i otomanëve. Ditën e tretë të ceremonisë së kurorëzimit të tij doli para popullit me një veshje të florinjte, të mbushur me perla dhe diamante dhe në kokë mbante një çallmë shumë të madhe, të zbukuruar me një seri pendësh çafkash, që simbolizojn pjesët e ndryshme të botës që i ishin nënshtruar Sulltanit. Tek këmbët e krevatit, Sulejmani kish kërkuar që të skalitej një prej motove të tij të preferuara: "Nëse princi nuk shkon personalisht në luftë dhe nuk përballon me rrezikun, është e sigurt se pjesa më e madhe e sipërmarrjeve të tij nuk do të jenë të suksesshme".

Në fakt, Sulltani i udhëhoqi personalisht fushatat ushtarake dhe vëzhgimi i tij shtrihej përtej kufijve të perandorisë, që u rrit në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e viteve.

Në Evropë njihet si "Sulejmani i Madhërishtëm", për popullin e tij ishte "Sulejman Kanuni", Ligjvënësi, duke qenë se veprimtaria e tij politike ishte e mbushur me përpjekje për të integruar ligjin e shenjtë tradicional, shari'an, me një lesgjilacion të quajtur kanun, që kish për qëllim të rregullonte çdo aspekt të jetës së shtetit. Nga një oborr i kushtueshëm dhe shumë i organizuar, Sulltani qeverisi një perandori e cila shtrihej në shumë troje të Perëndimit dhe përfshinte popuj shumë të ndryshëm mes tyre; Sulejmani u mor veçanërisht me jeniçerët, një korpus këmbësorie, mes më të famshmeve dhe të fuqishmeve të ushtrisë otomane, të cilëve u vendosi plaçkën e luftës si të vetmen formë pagese. Falë këtyre burrave, të cilët disa herë u bënë vendimtarë për fatet e perandorisë, ai pushtoi Beogradin dhe Rodin, pushtoi Buda-

SULEJMANI I MADHËRISHËM

Talenti, intrigat, mizoria...



pestin dhe rrethoi Vienën, luftoi venecianët në Korfuz dhe arriti fitore në fushatat ushtarake në Hungari dhe Persi, duke i bërë të dridhen të gjithë krerët e kurorëzuar të Evropës dhe të gjithë basenit të Mesdheut. Gjatë fushatës së tij të tetë në Perëndim, në Evropë, kundër Maksimilianit II të Habsburgëve, në natën mes 5 dhe 6 shtatorit 1566, Sulltani i Madhërishtëm, ndërkohë që pushtonte në çadrën e tij, ndërroi jetë dhe u kthye në atdhe i balsamuar.

Në anë të varrit u vendos kordha e tij, me majën e drejtuar nga armiku, si dëshmi e vdekjes në luftë. U la pasardhësve, të parit birit të tij Selimit II, një perandori që asnjë prej sulltanëve të mëvonshëm nuk diti ta mbajë, fuqia, begatia dhe pasuria e të cilës nuk do të arrihej më kurrë. Për të qeverisur një perandori kaq të madhe dhe shumëetnike ishin të nevojshme dhunti të spikatura politike dhe administrative, por jo vetëm: Sulejmani e themeloi qeverisjen e tij mbi tolerancën dhe respektin e popullive të ndryshme, që konvergjuan nën pushtetin e tij. Ka hyrë në histori si një prej Princërve më të mëdhenj, që për nga karakteri dhe bëmat do të

kishte lënë të shtangur një pjesë të madhe të brezave të ardhshëm.

SULLTANI I SULLTANËVE

Sulejmani jetoi një rini në të cilën lanë gjurmë rreptësia dhe studimet. Që fëmijë u dërgua në pallatet mbretërore të Kostandinopojës, ku u stërvit për përdorimin e armëve dhe mësoi shkencat, historinë, gjuhët, letërsinë dhe teologjinë me një përpikmëri tipike të turqve. Arsimiti i tij, që do ta kishte shumë të dobishëm në të ardhmen, u ndikua edhe nga prania e disa "tutorëve" me origjinë të krishterë, të cilët një ditë do të bëheshin vezirët, pashallarët, gjeneralët dhe guvernatorët e tij. Pikërisht në vitet e fëmijërisë, Sulejmani njohu dhe u afeksionua pas Pargali Ibrahimit, një skllav që do të bëhej këshilltari i tij më i besuar sapo të hipte në fron. Me një staturë mesatare dhe gjymtyrë me përmasa të rregullta, Sulejmani ishte brun në çehre, me ballin e gjerë dhe sytë e zinj pakëz të dalë nga orbita, vetulla të trasha, hundën si shkabë, buzët e holla dhe mustaqet e pjerrëta. Në vitet e fundit të jetës, kur nisi të dobësohej nga moshë dhe sëmundjet, nisi të vuajë nga indropizia, fryrja

e këmbëve, mungesa e oreksit dhe gjendjet e të fikëtit. Personaliteti i pasur dhe shumëformësh, sjellja kryelartë dhe e rezervuar, inteligjenca e gjallërishtme dhe reflektive në të njëjtën kohë, e bënin Sulejmanin një njeri më shumë të prirur për meditim dhe gjykim, se sa i përfundimeve të shpejtë, me karakter krenar dhe të vendosur, por jo mizor, nga momenti që teprimet atërore dhe mungesa e rivaliteteve familjarë e kishin bërë shpirtin e tij më shumë të prirur nga dashuria për drejtësinë, se sa nga prepotenca. Nevoja e madhe njerëzore për dashurinë e familjes e bëri që të dojë fort Mustafanë, djalin e tij të parë, Ibrahimin, mikun e përhershëm, por edhe krahun e djathtë dhe një prej kryevezirëve të tij, si dhe Roselanën, e preferuara e harem-it që u bë gruaja e tij: ndjenjat e tij për ta ishin të verbra dhe që të tre ushtruan një ndikim shumë të fortë në jetën e Sulejmanit.

Ndonëse ishte një politikan shumë i zoti, Sulejmanit i mungonin shija dhe talenti tipik oriental i intrigës. Ishte një shtetar që dinte të fuste shumë mirë në thes armiqtë, dinte të shfaqej i pazbutshëm dhe i paepur përballë mizistrave dhe vartësve që e

gënjenin apo e zhgënjenin, por besonte verbërisht ata që i kishte të shtrenjtë. Dashuria dhe besimi i pakushtëzuar për Roselanën, ajo që më shumë se kushdo tjetër diti të përfitojë prej dobësive të tij, e shtyu të bëjë gabime tragjike. Sulejmani ishte një despot absolut dhe për veprimet e tij përgjigjej vetëm para ligjeve të Kur'anit. Përgjatë gjithë mbretërimit të tij të gjatë, që zgjati 46 vite, veprimet e tij ishin - me ndonjë përjashtim të rrallë - të mençur, të matur dhe të frymëzuar nga një kriter tolerance. Mirënjohja e tij nuk mungonte pothuaj asnjëherë për të shpërblyer ata që i shërbenin me devotshmëri. Një ushtar besnik, i Madhërishtëm dinte të vendoste disiplinë në të gjithë trupat e tij, edhe në momentet e tërheqjes, dhe demonstronte se zotëronte dhuntitë gjeniale jo vetëm në fushëbetë, por edhe në shprehjet e tryezën e bisedimeve. Ishte një studiues këmbëngulës i bëmave të Aleksandrit të Madh dhe mbante një ditar të fushatave të tij ushtarake. Pasioni për matematikën lihej pas vetëm prej interesit për historinë. Një politikan i zgjuar dhe i mprehtë, Sulltani kishte një shije tipike orientale për salltanetet dhe efektet dramatikë. Në fakt, gjatë ceremonive, Sulejmani ishte një figurë me shkëlqim të pabesueshëm dhe pas tetëmbëdhjetë ditëve festime me rastin e rreth prerjes së bijve të tij, në qershor 1530, u nis të flitë për një perandor me pushtet të jashtëzakonshëm dhe një pasuri të pallogaritshme. Në të gjithë Evropën nisi të jehojë emri i atij që dukej se e meritonte vërtetë titullin i Madhërishtëm.

NJË PERANDORI E RILINDJES

Në shekullin XVI, Kostandinopojë ishte tashmë një kryeqytet kozmopolit dhe i vetmi që kishte një hapje të madhe ndaj botës. Në kohën e Sulejmanit, Perandoria otomane shumë e centralizuar dhe e pandarë, ishte e vetmja perandori ndërkombëtare pa të ngjashme.

Rilindja evropiane, që kishte përfituar prej prurjeve kulturore të njerëzve të ditur që kishin ardhur në Itali nga Kostandinopojë, në kërkim të strehimit para dhe pas pushtimit të qytetit në vitin 1453 nga Muhamedi II, ndikoi shumë tek Sulltani, i cili vuri në zbatim reforma të rëndësishme dhe promovoi artet e

bukura. Në fakt, ai nuk ishte vetëm ushtar dhe administrator, por edhe një njeri i kulturës: Sulejmani reformoi sistemin feudal të Perandorisë, bëri të jetojnë në harmoni 20 etni të ndryshme, themeloi shkollat dhe u shpërndau të mira klasës së ulemve, atyre që ishin të zotë në shkencat fetare të botës myslimane. Reformoi dhe përmirësoi administratën civile dhe ushtarake, duke këmbëngulur shumë në detyrimin e paanshmërisë kundrejt të gjithë klasave sociale, dëboi ose dënoi me vdekje të gjithë funksionarët e vegjël dhe të mëdhenj që ishin të korruptuar dhe vendosi taksa të lehta.

Duke qenë se ishte anakoolist ndaloj verën, por jo kafenë, e cila u fut në Kostandinopojë në 1554, duke qenë se në shitorët e shumta që lindën në qytet ai shihte "shkollat" të dobishme për përhapjen e kulturës si dhe për një praktikim më civil të marrëdhënieve qytetare, ku njerëz të ditur, oratorë, ushtarë dhe ekspertë të politikës mund të gjenin frymëzim. Me Sulejmanin, Porta e Lartë, ose qeveria otomane, hyri për herë të parë në marrëdhënie të rregullta diplomatike me shtetet e tjerë. Shumë artistë, edhe të huaj, eksperimentuan patronazhin e sulltanit. Gjatë mbretërimit të tij pati një lulëzim të madh të fushës së artit dhe shkrimtarët e kohës hodhën bazat për krijimin e një letërsie kombëtare; Stambolli u bë qendra intelektuale e Islamit. Veprave të mrekullueshme të Arkitekt Sinanit, Sulejmani u shtoi ribërjen e ujësjellësve dhe rrugëve si dhe veprave të tjera publike. Në të gjithë perandorinë, nuk kishte qytet që ai të mos e kishte zbukuruar në mënyrë të konsiderueshme. Sulejmani fliste arabisht dhe persisht, kuptonte italisht dhe i kushtonte shumë kohë leximit. Ishte vecanërisht i dashuruar pas novelave perse dhe legjendave të Aleksandrit të Madh, të rrëfyera nga poeti pers Nizami. Po këshqitë dhe zotëronte dije të mira të astronomisë dhe ashtu si kundërshtari i tij, Karli V, ishte i apasionuar pas orëve dhe artit të matjes së kohës. Falë impulsit të tij, shkëlqimi dhe prestigji i perandorisë së tij do të zgjaste në kohë. (Storica)

(Autorja është historiane dhe studiuese në Universitetin e Napolit)





Pavarësisht të gjithë lulëzimit kulturor që bënte të dallohej Aleksandria e Kleopatrës, nuk kemi as edhe një autor egjiptian që të ketë transmetuar tek pasardhësit këndvështrimin e mbretëreshës. Atëherë mbi çfarë mund të bazohen veprat e Shekspirit, të Xhorxh Bernard Shout apo interpretimi i Elisabetë Tejlorit që na kanë përcjellë një imazh kaq të gjallë të Kleopatrës? Mbi të gjitha tek autorët e propagandës romake, pra tek ai fraksion që kishte mposhtur mbretëreshën dhe që kishin të gjithë arsyet e botës për të vënë theksin në rolin dhe perversionet e gruas që kish qenë armikja e tyre

KLEOPATRA, magjia dhe tragjedia e mbretëreshës



Kleopatra VII, padyshim një prej grave më të famshme të të gjithë kohërave, u përjetësua në histori dhe në imagjinatën tonë në vepra teatrale, libra, filma. Kudo shfaqet me entuziazmin e saj dialektik dhe një magji të pakohë. Emri i mbretëreshës egjiptiane bën kaq jehonë, sa që është zgjedhur për një asteroid, një lojë, një anije, një krater, një grup muzikor, një cigare... Pavarësisht këtij interesi, nga Kleopatra na mbetet maksimumi një dëshmi direkte, një fjalë e vetme e shkruar në Aleksandri në vitin 33 para Krishtit, kur ajo apo një prej shkruarëve të saj mbyllnin një dekret ministerial me fjalën greke gienesthoi "kështu qoftë". Pra janë më shumë se dy mijë vite që bëjmë të lëvizë dhe flasë mbretëreshën egjiptiane me veprime dhe fjalë jo të sajat. Figura e Kleopatrës na është përcjellë nga rrëfimet e autorëve klasikë, që gjithsesi janë në kontradiktë të plotë në lidhje me këtë: Appiano nuk merret shumë me detajet, Giuseppe nuk respektin kronologjinë, Dionis injoron saktësinë për të favorizuar retorikën, Nicola Damasceno është një renegat i njohur (kaloi nga Aleksandria në oborrin e Herodit, mbreti që në momentin e fundit kishte tradhëtuar Antonin dhe mbretëreshën egjiptiane). Pavarësisht të gjithë lulëzimit kulturor që bënte të dallohej Aleksandria e Kleopatrës, nuk kemi as edhe një autor egjiptian që të ketë transmetuar tek pasardhësit këndvështrimin e mbretëreshës. Atëherë mbi çfarë mund të bazohen veprat e Shekspirit, të Xhorxh Bernard Shout apo interpretimi i Elisabetë Tejlorit që na kanë përcjellë një imazh kaq të gjallë të Kleopatrës? Mbi të gjitha tek autorët e propagandës romake, pra tek ai fraksion që kishte

mposhtur mbretëreshën dhe që kishin të gjithë arsyet e botës për të vënë theksin në rolin dhe perversionet e gruas që kish qenë armikja e tyre. Nuk ka dakordësi as për disa të dhëna biografike bazë, si identiteti i nënës së Kleopatrës, sa kohë ka kaluar ajo në Romë dhe sa herë është pritë në Urbe; nuk dimë nëse ajo dhe Antoni janë martuar (e sigurt është që ligji romak nuk pranonte martesë me të huaj, pra për Romën Kleopatra ishte vetëm një konkubinë), çfarë ndodhi me saktësi në betejën e Asios, ajo që shenjoi fatin e mbretëreshës, përveç se atë të Mark Antonit.

Në fund, nuk dimë me siguri se si vdiq: një mënyrë kaq e dhimbshme dhe pak efikase si shtrëngimi i gjarprit duket të jetë një sajesë, edhe sepse Kleopatra kishte në dispozicion helme më të sigurt, që nuk do të rrezikonte të dështonin. Pra, veprat sublimë të artit që kanë për protagonistë Kleopatrën janë bazuar gjerësisht në fantazinë apo krijimin, dhe shumë pak në kronikën e kohës.

NJË MBRETËRESHË NË HISTORI

Megjithatë, ekzistojnë disa të dhëna të sigurta që mundësojnë inkuadrimin e figurës historike të Kleopatrës. Lindi në vitin 69 p.e.s. e dyta e tre bijave

dhe motra e madhe e dy vëllezërve të tjerë, me secilin prej të cilëve do të lidhej për një periudhë të shkurtër kohe në martesë. Nuk ishte egjiptiane, por i përmiste aristokracisë së familjes greko-maqedonase të Ptolemejeve, që e kish origjinën që tek Aleksandri i Madh dhe që mbante titullin e faraonit prej dhjetë brezash. Mes Ptolemejeve, vrasjet dhe martesat brenda gjakut ishin në rend të ditës (një zakon ky shumë në modë, në atë kohë, edhe në dinasti të tjera), dhe Kleopatra u përfshi edhe ajo në këto drama. Bota aleksandrine, ndryshe nga ajo romake, besonte shumë në aftësitë e grave, kështu që nuk duhet të habitemi që Auleti, babai i Kleopatrës i kish dhënë një arsimit shumë të mirë, duke i vënë në shërbim eruditët më të mirë dhe studiuesit më të zotë të kohës, të cilët vërdallësisht në bibliotekën madhështore dhe muzeut të Aleksandrisë. Kleopatra u mësua dhe u përgatit për të qeverisur dhe fliste rrjedhshëm disa gjuhë, gjë që i mundësonte që t'u drejtohej pa ndërmjetës përfaqësuesve me peshë të shteteve të Mesdheut, përveç se shtetasve të saj, të origjinave të ndryshme.

Duket se manierat e mbretëreshës shkaktonin një magjepsje të pasqorë dhe nëse lajmi për bukurinë e saj lindi më vonë, që

në krye të herës burimet transmetojnë imazhin e një mbretëreshë që joshte me hijeshinë e fjalëve, zërin e butë dhe aftësinë retorike, me aftësinë për të argëtuar dhe kënaqur mysafirët, për të organizuar festa dhe mesha me efekt mbinatyrorë që linin gjithmonë pa mend të pranishmit. Në mënyrë të veçantë, sipas Plutarkut, tingëllon e paharrueshme mbërritja e saj në Tarso për të takuar Mark Antonin: "Ishte shtrirë në një tendë të larë me flori, e zbukuruar si Afërditat që i shohim vetëm në piktura, dhe një trupë skllëvërish, që ngjanin me perëndinë Amor të Iyer, ishin rreshtuar në të dy krahët dhe i bënë fresk. Në po të njëjtën mënyrë edhe vajzat shoqëruese të saj, të veshur si Narcisi dhe Hijeshia, i qëndronin rrotull. Parfume të mrekullueshëm shpërndaheshin në brigje gjatë kalimit të anijes". Zërat për mbërritjen e saj u përhapën me shpejtësi, ndërkohë që dërgonte për t'i thënë Mark Antonit se "Venusi kishte ardhur me një shkëlqim të rrallë, për t'u bashkuar me Dionisin, për të mirën e Azisë".

NJË FORCË HYJNORË

Të paktën në Egjipt, identifikimi i mbretëreshës me një hyjni nuk ishte aspak një gjë magjepsë-

se; mbi të gjitha nëse bëhej fjalë për Isidën, perëndesha e mëmësisë dhe pjellorisë, shpikëse e alfabetit, ajo që kishte ndarë Tokën nga qielli, që bënte të mbizotëronte rregulli dhe jo kaosi. Iside ishte një perëndeshë e butë dhe inkurajuese, por edhe zonjë e luftës, e rrufeve, e detit; kuronte të sëmurët dhe ringjallte të vdekurit, udhëhiqte marrëdhëniet e dashurisë dhe rregullonte shtatzënitë. Ishte toka mëmë e përsosur, kompetente nga pak në gjithçka, shpërndarëse e dijes dhe ushqimit. Në të vërtetë, mbretërimi i Kleopatrës u dallua pikërisht për administrimin shumë të mirë, aq sa, ndryshe nga sa kishte ndodhur më parë, nuk pati protesta të mëdha as në Egjiptin e poshtëm. Mbretëresha solli prosperitet në Egjipt, zhvlerësonte dhe hidhte monedha të reja në momentin e duhur, iu përkushtua administrimit të mbretërisë dhe, në kohë të zive të bukës boshatiste hambarët mbretërorë për të ushqyer shtetasit e saj.

E PASUR, E DITUR, JOSHËSE

Ishte në përgjithësi një sovranë shumë e dashur, që dallohej mbi të gjitha për mprehtësinë dhe zotësinë politike edhe në aneksimin e territoreve të rinj falë një politike të jashtëme të realizuar kundërt Romës: askush në botën e Mesdheut nuk barazohej me të për nga pasuria. Nën mbretërimin e saj kufijtë e Egjiptit u shtynë sërish duke u barazuar me ata që e kishin bërë të madh këtë vend shekuj më herët. Atëherë, përse na është përcjellë jo imazhi i një sovranje të vëmendshme dhe të aftë, por ai i një libertineje lakmitare?

Arsyet nuk mungojnë, dhe ndoshta duhet të lexojmë në këtë dritë rrëfimet që janë përcjellë prej romakëve dhe që janë filtruar prej propagandës perandorake. Mbi të gjitha, në kohën e Kleopatrës Roma shihte me dyshim Lindjen, duke asociuar ato toka ekzotike me rreziqet e butësisë, luksit të shfrenuar, perversionit, pretendimeve mbretërore dhe hyjnore.

Nuk duhet harruar që Ptolemejtë ishin greko-maqedonas, përveç se zotër të Egjiptit dhe Republika, që ende nuk ishte bërë një perandori, i frikësohej të paktën në publikë rafinimit dhe zakoneve orientale. Nuk dihet me saktësi nëse Kleopatra është dashuruar vërtetë me Jul Ceza-

rin apo me Mark Antonin, por e sigurt është që i bëri të realizonin atë që donte ajo. Nga këndvështrimi i romakëve, një gjë e tillë mund të shpjegohej vetëm me mashtrimin, joshjen me hile dhe magjinë; ndërëz kaq trima duhej të ishin ndrydhur vetëm përmes magjisë dhe mashtrimit. Oktaviani, pasi u mposhtën Antoni dhe Kleopatra, për të bërë të rritet edhe më shumë lavdia e tij nuk hezitoi që t'i atribuonte mbretëreshës egjiptiane imazhin e një gruaje lakmitare, të pabesë, gjakatare, të etur për pushtet dhe për të shtënë në duar Romën (një ide me shumë gjasa e pabazë, por që u përhap nga Augusti i ardhshëm për t'i kundërvënë romakët).

NJË RREZIK PËR ROMËN

Frika se mos i hiqte fronin e Egjiptit e shtyu Oktavianin që të ekzekutonte Cezarionin, biri i Kleopatrës dhe Jul Cezarit, ndërkohë që bijtë egjiptianë të Mark Antonit, më pak të rrezikshëm, patën fat më të mirë. Gjatë kohës së gjatë që qëndroi në pushtet, Oktavian Augusti pati të gjithë kohën për të vazhduar propagandën e nisur gjatë duelit me Mark Antonin: shkatërroi statujat e Kleopatrës dhe riskroi lajmet e shkruar për sovranin e dinastisë Ptolemeike.

Deri kur Asio, ku Antoni dhe Oktavianin qëndruan të ngecur për muaj e muaj të tërë u shfaq si beteja e të gjithë betejave dhe një sukses shumë i madh për Oktavianin, dhe Kleopatra duhej të shfaqej një mbretëreshë e marrë dhe keqdashëse që synonte shkatërrimin e Romës...

Pavarësisht gjithçkaje, dymijë vite informacione të këqij dhe shpikje artistike nuk mund të fshihin aftësitë e mëdha strategjike dhe menaxhuese të Kleopatrës. Një grua që padyshim ishte e madhe: zonjë e vetvetes, e mprehtë, energjike, shumë e pasur, ambicioze, e pathyeshme deri në fund.

Në fund arriti t'i shpëtojë mbikëqyrjes së Oktavianit dhe të vendosë vetë për vdekjen e saj, duke shmangur marshimin e lidhur me zinxhirë nëpër rrugët e Romës, siç i kish ndodhur vite më herët motrës së saj. Pushteti i kësaj gruaje është asociuar gjithmonë me një joshje të shfrenuar, më shumë se sa me aftësitë e saj politike: një grua e fuqishme dhe një grua që shkaktonte frikë. (bota.al)





Raportet janë bërë kundër llogarive që bëjnë komente të pakëndshme, kryesisht në video të bëra nga adoleshentët dhe fëmijët e rinj. Komente të kënaqshme të videove janë shpesh seksualisht të qarta



Barcelona prodhon smartphone zyrtar, ky është çmimi i tij



Klubi i Barcelonës ka bërë diçka shumë interesante. Katalunasit kanë vendosur ta lansojnë në treg smartphonin zyrtar. Ai është i përbërë prej ari 18 karatësh, transmetojnë mediat spanjolle. Gjithçka në telefon, duke u nisur nga ngjyra, gjuha e ikonat, janë katalunase. Ai ka një snapdragon 600 chipset, bashkë me 4 GB ram dhe 64 GB memorie. Telefoni ka dy kamera, një përpara dhe një në pjesën e epërme, me një sensor IMMP39. Çmimi i telefonit është rreth 520 dollarë.



Golf 8 do t'ju lë pa fjalë, ja kur del në treg

Modeli i ri do të del në qarkullim në kohën e njëjtë kur do të prezantohen edhe veturat e Volkswagen-it me motor elektrik në panairin e Frankfurtit në vitin 2019. "Prioriteti ynë është Golfi. Edhe pse vëmendja e medieve është drejtuar kah automobila elek-

trikë, jemi të bindur sa Golfi do të mbetet prodhimi ynë kyç në periudhën e ardhshme", ka thënë Herbert Diess, drejtori ekzekutiv i Volkswagen-it. "Golf 8" do të jetë mjaft e ngjashme me "VW GTI Vision", një koncept ky që ka një pamje me të vërtetë mahnitëse.



Dështon mekanizmi i YouTube për mbrojtjen e fëmijëve



Mekanizmi i mbrojtjes së fëmijëve në YouTube po shkatërrohet, sipas disa prej vëzhguesve vullnetarë të kompanisë. Shqetësimi se personat që kërkojnë të abuzojnë me fëmijët e vegjël duke përdorur mediat sociale është gjithmonë në rritje - dhe YouTube është i vetëdijshëm për këtë. Faqja e shpërndarjes së videove ka një rrjet të veçantë vullnetarësh, të quajtur 'Flamujt e besuar', të cilët ndihmojnë në identifikimin e posteve dhe komenteve shqetësuese në rrjet. Por ky grup është shprehur për BBC Trending se kompania ka një numër të madh raportesh të pa shqyrtuara prej disa muajsh dhe se kompania i përgjigjet vetëm një pjesë të vogël të ankesave nga publiku rreth rrezikimit të fëmijëve dhe

të dyshuarve për ngacmimin e fëmijëve. Një vullnetar thotë se ai përgatiti më shumë se 9,000 raporte në dhjetor 2016 - dhe se asnjë prej tyre nuk është kontrolluar nga kompania. Madje, këta vullnetarë kanë dyshime në lidhje me efektivitetin e faqes ku raportohen abuzimet publike në YouTube. Gjatë një periudhe prej 60 ditësh, ata e përdorën atë për të shënuar qindra llogari që potencialisht shkelin udhëzimet e faqes. Megjithatë, nga gjithsej 526 raporte, ata morën vetëm 15 përgjigje dhe vullnetarët thonë se sondazhi tregon një problem të madh me mungesën e mbrojtjes së fëmijëve në vend. Raportet janë bërë kundër llogarive që bëjnë komente të pakëndshme, kryesisht në video të bëra nga

adoleshentët dhe fëmijët e rinj. Komente të kënaqshme të videove janë shpesh seksualisht të qarta. Disa inkurajojnë të rinjtë të bëjnë video me pak rroba ose aspak, të flasin për trupin e tyre ose thjesht të flasin për tema seksuale. Disa kërkojnë që fëmijët të kalojnë në aplikacione private për një komunikim më pak publik. Në një deklaratë, Zyra e Brendshme në Mbretërinë e Bashkuar tha për BBC: "Është jetike që qeveria dhe kompanitë të punojnë së bashku për të trajtuar çështjen e sigurisë në internet. Por të gjithë së bashku duhet të bëjmë më shumë dhe është e rëndësishme që kompanitë e internetit të marrin shumë seriozisht përgjegjësitë në këtë fushë".


Google Play do zhvlerësojë aplikacionet me probleme

Google bëri të ditur sot disa ndryshime në Play Store. Aplikacionet që punojnë më së miri, që do të thotë kanë më pak eksperiencë bllokimi dhe ato që nuk të harxhojnë baterinë, do të renditen më lart se aplikacionet me bugs dhe probleme të tjera. Objektivi i këtij algoritmi të përditësuar vlerësimi është të sigurojë se aplikacionet më të mira promovohen, duke rritur përdorimin e tyre, thotë kompania. Shtyrsa për këtë ndryshim erdhi pasi Google kuptoi se gjysma e vlerësimeve me një yll në Google Play Store ishte pikërisht për problemet me qëndrueshmërinë e aplikacionit. Aplikacione që nuk punonin mirë me përdorues frutstues, që shpesh kthehen të rishikimet për tu ankuar. Me kalimin e kohës një numër vlerësimesh të këqija dhe vlerësim të ulët në yje ndikon në vendin e aplikacionit në renditje dhe rezultatet e kërkimit. Ky përditësim i algoritmit të vlerësimit do të detyrojë zhvilluesit me aplikacione me probleme, që ti adresojnë këto çështje ose do të penalizohen.

Ky është aplikacioni që ju ruan internetin e telefonit

Nëse keni mësuar se MB tuaja kanë humbur çuditërisht, atëherë Facebook mund të jetë një përgjegjës kryesorë. Fotot me rezolucion të lartë dhe videot që luhen vetë mund të djegin pakon tuaj të internetit në pak minuta. Sigurisht mund të ndaloni luajtjen automatike të videove duke naviguar në More (tre vijat horizontale në skajin e djathtë lart) > Help and Settings > App Settings > Autoplay. Megjithatë ekziston një mënyrë më e mirë për të

kursyer dhe ajo është Data Saver. Cili është funksioni i Data Saver? Data Saver jo vetëm që ndalon luajtjen automatike të videove, por gjithashtu redukton rezolucionin e çdo imazhi që shfaqet në News Feed. Për ta aktivizuar duhet të drejtoheni tek opsioni More. Shfletoni gjersa të gjeni Data Saver. Në ndërfaqen e radhës që do të shfaqet klikoni On. Pasi ta keni aktivizuar do të merrni një opsion të ri i cili u kërkon çaktivizimin e saj kur jeni në Wi-Fi.





Vitaminat, mineralet dhe antioksiduesit që përftojmë nga misrat e pjekur



Misri, një produkt me shumë vlera që mund ta përdorni në gjitha vaktet e ditës suaj, pasi ka një përmbajtje të lartë në karbohidrate dhe shumë fibra, njësoj si buka ose ndryshe si gruri. Shikoni se sa shumë vlera përmban:

1. Është një burim i pasur i vitaminave A, B, E, thiamine dhe niasin, acid pantotenik dhe është burim shumë i mirë i mikroelementeve dhe ka një përmbajtje shumë të lartë në fibra!

2. Misri gjithashtu siguron një pjesë të madhe të vlerave ditore në acid folik, një vitaminë shumë e rëndësishme që luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e duhur të fetusit në shtatzëninë përgjatë tremujorit të parë.

3. Gjithashtu misri përmban një vlerë shumë të lartë antioksiduesish duke ndihmuar në sëmundjet tumorale - në parandalimin e Alzheimer, - ndihmon në uljen e inflamacionit (edeme) - dhe përmban Beta-Criptoksanthin, një substancë që hynë në familjen e karotenoideve dhe është një antioksidues shumë i fuqishëm, i cili na mbron nga tumori i mushkërive, por jo vetëm - përmban lutein dhe zeaksanthin, dy substanca që mbrojnë syrin nga degjenerimi makular, shkaku kryesor i humbjes së vizionit tek të moshuarit. Shikoni format e ndryshme që mund të përdoret!

Në hulumtimet për përmirësimin e trajtimit ndaj llojeve të ndryshme të kancerit, studime të ndryshme kanë treguar se natyra na dhuron substanca të forta kundër kancerit. Gjëja më e mirë në gjithë këtë është se nuk kanë efekte të dëmshme anësore

Ekzistojnë fara të ndryshme kundër kancerit, që mund ta parandalojnë atë, ose të ndihmojnë në trajtimin gjatë kimioterapisë, por se nuk duhet të përdoren si zëvendësim për trajtimin. Në hulumtimet për përmirësimin e trajtimit ndaj llojeve të ndryshme të kancerit, studime të ndryshme kanë treguar se natyra na dhuron substanca të forta kundër kancerit. Gjëja më e mirë në gjithë këtë është se nuk kanë efekte të dëmshme anësore.

Disa nga opsionet natyrale, që forcojnë sistemin imun dhe luftojnë kancerin dhe përhapjen e tij, janë katër lloje të farave.

FARAT E MOLLËVE. Shumë ekspertë farat e mollëve i klasifikojnë si farat më të fuqishme kundër kancerit. Sikurse edhe në shumë raste të tjera, organizata të caktuara nuk dëshirojnë t'i publikojnë dhe të kuptohet, pasi që dëshirojnë të zhvillojnë ilaçe sintetike për të pasur fitime të mëdha. Këto fara është vërtetuar se parandalojnë rritjen e qelizave malinje në disa lloje të ndryshme të kancerit, përfshirë kancerin e zorrëve, të mushkërive, prostatës, gjirit, stomakut.

FARAT E RRUSHIT. Ekstraktet nga farat e rrushit janë burim i pasur për antioksidues, flavonoidë dhe substancën aktive të njohur si

Katër llojet e farave më të fuqishme kundër kancerit



MISHI I PULËS SHKAKTON KANCER?

Më në fund FDA ka konfirmuar prezencën e arsenikut një agjent i cili shkakton kancer, në mishin e pulës që është shitur në SHBA. Me sa duket ky element i rrezikshëm është përfshirë në ushqimin e pulave. Kërkimi që FDA bëri doli në përfundimin laboratorik se arseniku ishte në përbërje të ushqimit që pulat hanin duke u absorbuar kështu në mishin e tyre dhe duke përfunduar në trupin e njeriut. Gjithashtu u zbulua se për rreth 5 dekada njerëzit kanë konsumuar mish pule me arsenik. Por me gjithë hezitimin e FDA për t'u prononcuar mbi këtë çështje, produktet e mishit të pulës Roksarson do të tërhiqen nga të gjitha supermarketet.

"B2G2". Kjo substancë mund të ndihmojë në luftimin e qelizave të kancerit. Në të kaluarën, substancat bioaktive të pranishme në rrush është besuar se sulmojnë grupe të caktuara të qelizave të kancerit, por se tani është vërtetuar se substanca "B2G2" e bën një gjë të tillë. Kjo substancë re-


dukton rritjen e tumoreve malinje deri në 67 për qind.

FARAT E LIRIT. Falë përbërësve të saj, që i posedojnë, farat e lirit po ashtu mund të përfshihen në listën e farave, që luftojnë kancerin. Është vërtetuar se luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjir-

it, përderisa veprojnë edhe si fitoestrogjene. Ky përbërës, i cili është popullarizuar rreth një vit më parë, është i aftë në promovimin e apoptozës në qelizat e tumoreve, përderisa parandalon edhe metastazën. Po ashtu farat e lirit janë burim i aminoacideve omega 3, që veprojnë kundër kancerit dhe sëmundjeve të tjera kronike.

BËRTHAMA E PJESHKËS. Pjeshkat janë të pasura me një sasi të madhe me vitamina B17, i cili ka efekt kundër kancerit në trup.

Kjo vitaminë është e shkëlqyeshme jo vetëm në parandalimin e kancerit, por se mund të jetë me shumë veti shëruese për ata pacientë, që tashmë vuajnë nga kanceri. Për ta përdorur, vetëm e thyeni bërthamën me çekiq. Më pas e hani farën, që ka një formë të bajames.



Video-lojërat ju bëjnë më të fokusuar në punë

Duke luajtur video lojëra për vetëm pesë minuta bën që njerëzit e stresuar të ndihen më të fokusuar në punë, sugjeron hulumtimi i ri. Ndërsa relaksimi, ndihmon njerëzit të ndihen më pak negativ dhe të pikëlluar, ulur në heshtje i bën ata të ndjehen të çliruar nga puna dhe prandaj shkakton shqetësim, një studim gjetur. Autori i studimit Michael Rupp nga Universiteti Florida, ka rekomanduar se njerëzit duhet

shpesh të planifikojnë pushime të shkurtra për të bërë kohë për aktivitete të këndshme dhe të kënaqshme duke cituar video-lojërat të cilat mund të ndihmojnë të mbushni bateritë tuaja. Shenjat që mund të theksojeni dhe të bieni keq në sy gjatë orarit të punës, përfshijnë ndjenjën jashtë kontrollit, duke e pasur të vështirë të flisni me shefin tuaj dhe ndjenja e të mos pasur mbështetje.

U pickua nga një insekt, gruaja humb këmbët dhe një dorë

Një grua në Këln të Gjermanisë humbi të dyja këmbët dhe krahun e majtë pasi u pickua nga një insekt, ndërkohë që po nxirrte mbeturinat jashtë. Ngjarja ndodhi në mes të muajit Mars, por lajmi është bërë i ditur vetëm këtë javë, shkruan Russia Today. Sonja Kujas 43 vjeçe sapo kishte nisur ditën e punës në një kom-

pani ku punonte si pas-truese, kur u pickua në krah nga një insekt. "Dallova menjëherë një gungë.

Më pas nisa të kisha marrje mendsh, ftohtë e dhimbje. Koleget e mia morën menjëherë ambulancën", tha Kujas. Gruaja u shtrua në spital, por pas një ekzaminimi, mjekët e çuan atë në

shtëpi. Megjithatë gjendja e saj vijoi të përkeqësohej dhe gruaja u dërgua sërish në spital, ku ra në gjendje koma. Pickimi i insektit çoi në infeksion të rëndë në gjak. Bashkëshorti i saj Andy tregoi sesi gjymtyrët e saj po vdisnin dhe po bëheshin të zeza.

Në fund, jeta e gruas u shpëtua, por ajo humbi

dy këmbët dhe krahun e majtë.

Infeksionet janë një komplikacion i rrallë në rastet e pickimit nga insektet, por gruaja, e cila tashmë lëviz vetëm me karrige me rrota, kërkon që të paralajmërojë njerëzit që të mos lenë pasdore qoftë pickimin më të vogël, pasi mund të jetë tepër i rrezikshëm.





Luksi në Dubai s'ka fund

Mrekullitë në Dubai nuk kanë të ndalur. Së fundmi është projektuar ndërtimi i një fshati të tërë me vila nënujore, të cilët do të ofrojnë një pamje magjepsëse nën ujë të Gjirit Persik. Vilat do të ofrojnë një eksperiencë të pazakontë për pushuesit. Ato do të kenë një çmim nga 2.15 milionë paund deri në 2.50, të vendosura në formë zemre pranë ishullit St Petersburg. Pamja e ofruar do të jetë mbresëlënëse me botën nënujore tejet të pasur.



DASHI (20/III-20/IV)



Do të keni një periudhë të ngarkuar me punë. Largoni "pluhurin" e mërzitjes që të shkaktojë gjërat përreth dhe bëni një fillim të ri. Mos iu trembni çmimit, pasi çdo gjë që vlen, edhe kushton. Mendohu saktë se çfarë kërkon nga jeta dhe fati do të ta falë, mjafton të dish ta kërkosht.

DEMI (21/IV-20/V)



Dëshira dhe pasioni do të përqafohen së bashku, për t'ju ofruar lumturi dhe mirëkuptim në lidhjen tuaj këtë muaj. Do të ndiheni shumë me fat për personin që keni në krah. Për ata që nuk e kanë ende një lidhje, parashikohen njohje, të cilat mund të shndërrohen në një histori të bukur.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Këto ditë do të jetë të mbarë për ju. Do të ndërmerri iniciativa të reja, të cilat parashikohen të jenë të frytshme dhe të përfundojnë me sukses. Do ta ndjeni veten të stresuar, por kjo nuk krahasohet me lehtësimin që do të merrni, pasi të shikoni rezultatet e përpjekjeve tuaja.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Këto ditë do të organizoni në mënyrë perfekte rrjedhën e jetës tuaj. Udhëtimet do të jenë tepër të mbara. Do të përfshihen në udhëtime me shoqërinë, në qendër të vëmendjes së të cilës do të jeni pikërisht ju. Do të ndiheni shumë të veçantë, dhe jo më kot.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Përditshmëria juaj do të jetë shumë e ngjeshur. Shfrytëzoni ardhjen e fatit drejt jush, për të realizuar qëllimet tuaja. Do të ndiheni në qendër të vëmendjes dhe do të jepni maksimumin edhe në lidhje. Por këshillohet të bëni kujdes me fjalët tuaja, të cilat shpesh mund të jenë të ekzagjeruara.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Karriera dhe çështjet ekonomike do të monopolizojnë interesimin tuënd. Ndhima e miqve do të të shërbejë, pasi do të të ndihmojë të dalësh nga lëmshi, në të cilin të kanë përfshirë sjelljet e pakujdesshme. Do të shikoni një ndikim pozitiv edhe në lidhjen tuaj, e cila për pak rrezikoi të pësonte krizë.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Do të ndieni një mërzitje të përgjithshme, e cila do të përfshijë jetën tuaj. Por nuk do t'ju largohet gjithashtu edhe stresi në punë. Duhet të bëni "ushtrime kuraje", pasi mungesa e sigurisë ju troket në portë. Nuk përjashtohet ndeshja me një situatë jo të mirë në karrierën tuaj.

AKREPI (22/X-21/XII)



Do të keni ditë të vështira në profesion, ku do ta gjeni veten të ngatërruar në një situatë të vështirë. Edhe pse aftësitë tuaja nuk janë për t'u vënë në diskutim, do të ndihet nevoja e një personi tjetër, i cili, edhe pse mund të mos jetë shumë i dëshirueshëm për ju, do të jetë një ndihmë e madhe.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Jeni të etur për famë dhe sukses dhe e gjithë vëmendja juaj është e përqendruar në arritjet profesionale, me rezultat të lini pas dore jetën tuaj sentimentale. Mund të jetë kjo një periudhë e justifikuar, pasi mund të keni ngarkesë të madhe në çështjet e punës.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Ngjarje dhe situata jo të favorshme do të sjellin pesimizëm gjatë këtyre ditëve. Mos u mbyllni në vetvete, por shikoni mundësi për t'u argëtuar, edhe pse do të jetë e vështirë me stresin që do t'ju përfshijë. Kah fundi i këtij muaji do të shikoni që gjërat do të ndryshojnë ndjeshëm.

UJORI (20/I-19/II)




Fokusi këto ditë është në interesat tuaja, në edukimin, aventurat dhe ndoshta edhe disa udhëtime. Ndryshimi i rutinës suaj është ajo që keni nevojë këto kohë. Ndjeni një dëshirë të madhe për ta ndryshuar rrënjësisht situatën në jetën tuaj.

PESHQIT (20/II-19/III)



Paraqitet një periudhë e mirë, përse i përket profesionit që, mesa duket, është i vetmi shqetësim dhe preokupimi juaj këtë periudhë. Yjet ju këshillojnë të merrni më tepër me veten tuaj dhe me ato çka ndjeni. Merrni në konsideratë ofertat që ju vijnë, për të kaluar momente të paharrueshme.

| Mensur Mamuti | INICIATIVA | FILM ME AKTORIN NË FOTO | NË FORMË TË VEZES | TENISTI AMERIKAN, PIT | AKTORJA AMERIKANE MARGARET | TEMPO | | | | | | | | |
|---|----------------------|--------------------------|------------------------------------|-----------------------|----------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------|---|--------------------------------|-----------------------|------------------------------------|--|--|
| NGIHET | | | | | | | | | | | | | | |
| ISH BASKETBOLL AMERIKAN, MEXHIK XHONSON | | | | | | FILM ME AKTORIN NË FOTO | | | | | | | | |
| PORTJERI NË ZENDELI | | | | | ZH PAKETË | | | | | | | | | |
| PYLL | | | | NUMRI LUDOLFIT | SHAHIST ARGJENTINAS (SHQ) | | | | | | | | | |
| ADNAN JANUZAJ | | | PRODH. ZVIC. I MODELEVE TË TRENAVE | | | | | | | | | | | |
| KOHA | QYTET NË ETIOPI | | | | | | | | | | | | | |
| BENZINË (HUAJ) | SPORT NË AKULL (SH) | | | | | | | | | | | | | |
| JO E SAKTË | | | | | | | | | | | | | | |
| G | | | | | ZERO | | AKTORI AMERIKAN NË FOTO | ANGSTREM | ISH PRESIDENTI I SHQIPERISE I CILI AKTORIT NË FOTO I DHA MEDALJE MIRENJOHJEJE | GYP NËPËR TË CILIN KALON GJAKU | HISTORIANI ROMAK, TIT | KAFSHA MË E THJESHTË, NË EQELIZORE | | |
| QYTET NË RUSI | | | | | OPERA E SHTRAUST OXSIGJEN | | | | | | | | | |
| KËNGËTARJA JONË IKONOMI | | | | | | | | PRIJË NGA NJE ANE | | | | | | |
| NDUE UKAJ | | | FOSFOR | | QË U TAKON ÇAMEVE | | | | | | | | | |
| FILM ME AKTORIN NË FOTO | | | | | | | | | | ILIR BERISHA | | | | |
| SHKRONJA E FUNDIT | | BOKSIERI KOSOVAR, MURIQI | | | | | | RADIUM | | | SHKRONJA E PARE | | | |
| SPANJË | | SI ANEKDOTË | | | | | | AR (FRENGJ) | | | PJESË E TRUPIT, KREJ | | | |
| QYTET NË ITALI | | | | | | | | | | | | | | |
| KOHA | VEHJE NOTI PER FEMRA | | | | | | | | QYTET NË SHQIPERI | | | | | |
| SHENJA PER ZBRITJE | METËR | | | | | | | | AUSTRI | | | | | |
| | | | | | | | GADISHULL NË TAILANDE | | | | | | | |



ZGJIDHJET: NGOPET, IRVIN, SUAT, ZH, MAL, PL, AJ, HAG, ASEKO, PETROL, GABIM, O, TULA, ARABELA, IKONOMI, ANIM, NU, P, E ÇAMËVE, ARBITRAZH, IB, ZH, ELVIR, RA, A, E, ANEKDOTIK, TODI, AGRONOM, BIKINI, PUKA, MINUS, RAILAJ.

Sudoku

shumë i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 7 | | 6 | | 4 | | |
| | 4 | 6 | | | | 8 | 7 | |
| 2 | 3 | | | | 4 | | 9 | 6 |
| | | | | 1 | | | | |
| | | | 9 | | 2 | | | |
| 4 | | | | 5 | | | | 7 |
| 9 | 7 | | 4 | | | | 6 | 5 |
| | 5 | 4 | | | | 9 | 2 | |
| | | 8 | | 3 | | 7 | | |

shumë i vështirë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | | | 2 | | 1 | | | 3 |
| | 5 | | | 7 | | | | 9 |
| 3 | | | 9 | | 6 | | | 2 |
| 4 | | 8 | | | | 9 | | 6 |
| | 7 | | | | | | 8 | |
| 6 | | 9 | | | | 7 | | 5 |
| 1 | | | 5 | | 9 | | | 7 |
| | 9 | | | 2 | | | 3 | |
| 7 | | | 1 | | 8 | | | 9 |

Shumë i lehtë: 897163452, 146295873, 235784196, 582317649, 763942581, 419856237, 971428365, 354671928, 628539714. Shumë i vështirë: 987251463, 256374198, 314986572, 438715926, 571692384, 629843715, 162539847, 895427631, 743168259.



Shihni shumë ëndrra të këqija, kjo është arsyeja


Për shkak të stresit vuan edhe sistemi jonë imunitar, çrregullohet puna e hormoneve, lodhen muskujt dhe rraskapitet organizmi që shpesh shfaqet edhe me sëmundje. Sa i përket trurit, stresi kronik di të shkaktojë humbjen e kujtesës dhe shfaqjen e ëndrrave të këqija. Ekspertët thonë se truri, i cili është i ngarkuar

me mendime të rënda të cilat nuk di si t'i përpujë, ndihmën e gjen në ankthin e natës. Ëndrrat e këqija janë një formë e mirë për të tejkaluar momentet stresuese, të cilat në këtë mënyrë bëhen më pak të rrezikshme për shëndet. Sipas shkencëtarëve amerikanë, ëndrrat duhet të konsiderohen si psikoterapi. Në to mund të

gjejmë shkaktarët e mundshëm të nervozës sonë dhe sugjerimet se si t'i tejkalojmë ato. Nëse gjatë gjumit jeni të frikësuar ose të turpëruar, mendoni pse ndodh kjo. Pastaj, pyetuni se çfarë ua shkakton ndjenjat e njëjta edhe kur jeni zgjuar. Për shembull, ndoshta mund ta kuptoni se keni thënë ose keni bërë diçka jo të mirë në punë,

ose keni nevojë që t'i kërkon dikujt falje ose të jeni më të kujdesëm në të ardhmen... Në rast se ëndrrat e këqija ua çrregullojnë gjumin normal, paraqiten thuajse çdo natë ose janë shumë shqetësuese, atëherë duhet të kërkon ndihmën e psikologut ose psikiatrit, të cilët do t'u ndihmojnë t'i rregulloni mendimet.

Gratë e përdorin trurin më shumë se burrat



Është ndër stereotipet më të popullarizuara, që gratë i mendojnë gjërat më shumë se burrat. E tani studimi më i madh i realizuar ndonjëherë me skanimet e trurit, ka gjetur prova që mbështesin këtë teori. Analizimi i të dhënave nga më shumë se 45 mijë studime, ka treguar që truri i grave është dukshëm më aktiv krahasuar me atë të burrave. Hulumtuesit nga Amen Clinics në Kalifornia, kanë thënë që qarkullimi i gjakut nëpër disa pjesë të trurit tek gratë është shumë më i lartë, kështu duke rritur mundësitë për fokus dhe empati gjithashtu edhe për ankth. Këto të gjetura mund të ndihmojnë edhe me gjetjen e shkaqeve se pse disa çrregullime të trurit janë më të shpeshta tek gratë.

Ja kush është kombi më përtac në Evropë

Një hulumtim i kryer nga kompania Ladbrokes tregon se 78 për qind e bullgarëve nuk ushtrojnë asnjëherë, shkruan "Daily Mail". Nga ana tjetër, më aktivët janë suedezët, në mesin e të cilëve ushtrimeve "i ikin" vetëm 9 për qind e tyre. "Pasi që bullgarët janë njëri nga popujt më të trashë dhe më përtacë në Evropë, ndoshta nuk çudit fakti se ata janë pak të turpshëm sa i përket aktiviteteve fizike", ka thënë Jessica Bridge nga Ladbrokes. Pas Bull-



garisë në listë renditen Malta me 75%, Portugalia 64%, Rumania 60%, Italia 60%, Greqia 59%, Qipro 54%, Polonia 52%, Lituania 46%, Spanja 44%, Hungaria 44%, Franca 42%, Sllovakia 41%, Letonia 39%, Estonia 36%, Britania e Madhe 35%, Çekia 35%, Irlanda 34%, Belgjika 31%, Kroacia 29%, Holanda 29%, Gjermania 29%, Luksemburgu 29%, Austria 27%, Sllovenia 22%, Finlanda 15%, Danimarka 14% dhe Suedia 9%.

KALENDARI HISTORIK 14 GUSHT

- 1385 - Portugezët mundin Kastilianët në Alxhubarota.
- 1551 - Trupat turke nën komandën e Dërgutit okupojnë Tripolin.
- 1585 - Mbretëresha Elizabeta I refuzon sovranitetin e Holandës.
- 1743 - Ushtria prusiane okupon Saksenin.
- 1762 - Flota angleze okupon Havanën.
- 1782 - Surinami ndalon shitjen e robërshave nëna pa foshnjat e tyre.
- 1790 - Suedia dhe Rusia nënshkruajnë Traktatin e Vereles për paqe.
- 1824 - Gjenerali Lafayette kthehet në SHBA.
- 1825 - Mbreti holandez Willem I dëbon studentët e huaj.
- 1893 - Franca paraqet regjistrimin e makinave me motor.
- 1912 - 2,500 marinë amerikanë pushtojnë Nikaraguan: SHBA qëndrojnë aty deri në vitin 1925.
- 1917 - Kina i shpall luftë Gjermanisë dhe Austrisë.
- 1920 - Një Antantë e vogël formohet nga Çekosllovakia dhe Jugosllavia.
- 1937 - Kina i shpall luftë Japonisë.
- 1947 - Pakistani fiton pavarësinë nga Britania.

A E DINI SE...



Yjet neutrone janë kaq të dendur, sa që një lugë çaji do të peshojë më shumë se të gjithë njerëzit mbi Tokë.

A e dini se një në çdo 2000 foshnje lind me një dhëmb. Në shumë raste, mjekët janë të detyruar t'i heqin dhëmbët të porsalindurve për shkak të problemeve që bebet i kanë gjatë ushqyerjes me gjí.



Vetën 10 për qind e të gjitha qenieve njerëzore të lindura në këtë botë, janë gjallë në këtë moment.

BARSOLETA



POLICI DJEG FAQET

Një polic iku një dite në punë me të dyja faqet e djegura. Shoku e pyet:

- Ku e ke djegur këtë faqe? - dhe ai i tha:
- Isha duke hekuros kur ra zilja e telefonit, dhe unë vura në vesh hekurin e hekurosjes pa dashje.
- Po faqen tjetër? - e pyeti përsëri shoku.
- Pasi dogja faqen e pare mora në telefon ambulancën...

THËNIA E DITËS

Gënjeshtër ka bërë gjysmën e rrugës rreth e qark botës, kur e vërteta sapo është nisur. (Uinston Çurçill)

